

Koha

www.koha.mk

**Kövesi dhe
alarmi për
Evropën**
Fq.15



E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XIII · Numri 3596 · e enjte, 28 shkurt 2019

-2°C | 14°C

15 DEN

EDITORIAL

**A është e
mundur
ferma
familjare?**



Një proverb e vjetër polake thotë nëse fshatari është i varfër, edhe shoqëria është e varfër. Nëse ndjekim historinë e shteteve në rajon, dhe shuarjen graduale të më shumë ekonomive familjare bujqësore në Maqedoni mund të vërejmë se nga viti në vit, jo vetëm që humbet me të madhe interesimi i të rinjve... Fq.2

RAJON

**Veprimet e
opozitës nuk
kanë miratim
ndërkombëtar**

Fq.14

GLOBI

**Erdogan
tregtarët
i quan
"terroristë të
ushqimit"**

Fq.15



PAS TRAGJEDISË SË LLASKARCËS

ÇFARË MËSIMESH NXORI SHTETI?



"Duhet të punojmë që të formohet një qendër e përbashkët për thirrje urgjente, jo vetëm për qytetin e Shkupit por për gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, që të mund të gjitha ekipet që janë në terren të jenë në shërbim të qytetarëve", thonë nga Qendra e Shëndetit-Shkup, nën ombrellën e së cilës është Ndihma e Shpejtë. Më shumë se dhjetë vite nuk ka të dhëna të sakta se sa pika të zeza ka në rrugët e Maqedonisë së Veriut dhe ku saktë ato ndodhen Fq.6-7

Hekurudha në vendnumëro

Shkup, 27 shkurt - Komunikacioni hekurudhor në Maqedoni shënon rënie të dukshme. Për shkak objektivë, por edhe subjektivë se vjen e më pak trena qarkullojnë nga Shkupi, por edhe në drejtim të kryeqendrës së Maqedonisë së veriut. Linjat ndërkombëtare nga Shkupi vozisin vetëm deri në Prishtinë, ndërsa deri në Beograd dhe Selanik qarkullojnë vetëm në muajt e verës. Në transportin e brendshëm qarkullojnë

15 linja të trenit, dhe atë nga katër prej Shkupi deri në Tabanov dhe Veles, nga tre deri në Veles, nga dy deri në Gjevgjeli dhe nga një deri në Kërçovë dhe Koçan dhe anasjelltas.

Në fillim të vitit të kaluar, kompania "Trenat e Serbisë" së bashku me kompaninë greke TRAI-NOSE, vendosën që pas 30 shtatorit të vitit 2018, nuk do të qarkullojnë në linjën Beograd-Selanik-Beograd, për shkak të... Fq.5



EDITORIAL

A ËSHTË E MUNDUR FERMA FAMILJARE?



Fisnik PASHOLLI

Një proverb e vjetër polake thotë nëse fshatari është i varfër, edhe shoqëria është e varfër. Nëse ndjekim historinë e shteteve në rajon, dhe shuarjen graduale të më shumë ekonomive familjare bujqësore në Maqedoni mund të vërejmë se nga viti në vit, jo vetëm që humbet me të madhe interesimi i të rinjve që të vazhdojnë traditën e marrjes me bujqësi, por mund të vërehet edhe ulja e fitimit që sjell bujqësia dhe blegtoaria. Mjafton vetëm të shfletojmë titujt e gazetave, apo vetëm të kujtojmë pamjet e kronikave televizive, që tregojnë hallet dhe problemet e bujqve me shitjen e prodhimeve të tyre. Në kohën e transformimit të vështirë të bujqësisë jo vetëm në Maqedoni, por edhe të rajonit të Ballkanit perëndimor, plakjes së fshatit, ikjes së të rinjve jashtë, parashtrohet pyetja, se a kanë mundësi fermat familjare apo ekonomitë bujqësore familjare që të mbijetojnë dhe të avancojnë punën e tyre drejt një biznesi të leverdishëm. Fati i tyre në kohën e konkurrencës së madhe dhe tregut të hapur të ekonomisë moderne, është ngushtë i lidhur me mbijetesën e fshatit, zbutjen e shpërnguljes së madhe, përmirësimin e kushteve të jetesës në vendbanimet rurale, mundësinë që një pjesë të madhe të prodhimeve bujqësore ti prodhojmë këtu, në vend se ti importojmë nga jashtë, sigurimin e lëndës së parë për industrinë përpunuese që do të sigurojë edhe eksport dhe jo import të ushqimit...

Edhe në Evropë dhe SHBA, bujqësia kryesisht bazohet në ekonomitë familjare, për shkak se puna e familjes është fleksibile, tejkalon orarin e zakonshëm të punës dhe ka një besnikëri dhe motiv më të madh ndaj fermës familjare. Një model i tillë i punës ka treguar edhe rezistencë edhe aftësi që të mbijetojë me shekuj dhe të tejkalojë problemet e ndryshme. Në vitin 2014, sipas të dhënave zyrtare statistikore amerikane, bile 97 për qind e fermave janë familjare, ku pronari i fermës dhe të afërmit e tij posedojnë shumicën e biznesit.

Me fjalë të tjera, numri i përgjithshëm i fermave dominohet nga fermat e vogla familjare, që kanë të ardhura vjetore nën 350.000 dollarë në vit, ndërsa punojnë edhe 52 për qind të tokës në SHBA, mirëpo kontribuojnë për vetëm 23 për qind të prodhimit të bujqësore amerikane. Ferma me madhësi të mesme janë 6 për qind dhe ferma me madhësi të madhe janë 3 për qind.

Në total, fermat familjare të llojeve të ndryshme së bashku përbëjnë 98.8 për qind të fermave dhe 90 për qind të prodhimit në vitin 2016. Fermat e mëdha familjare prodhojnë gjysmën e derrave dhe dy të tretat e qumështit dhe pemë perimeve. Fermat e mëdha dhe të mesme dominojnë me 83 për qind të prodhimit të pambukut dhe 74 për qind të drithërave. Fermat e vogla amerikane prodhojnë 59 për qind të prodhimit të amerikane të pularisë dhe gjysmën e jonxhës. Gjithashtu fermat e vogla dhe të mëdha prodhojnë edhe dy të tretat e prodhimit të blegtorale që ndërlihet me lopët. Në Bashkimin Evropian, punojnë mbi 12 milion ferma familjare, ku janë të punësuar mbi 25 milion njerëz, apo çdo i njëzetë banor i Evropës.

Në Kroaci prej vitit të kaluar është në fuqi edhe ligji i veçantë kushtuar fermave familjare ekonomike, që sipas legjislativnit kroat paraqesin formë të organizuar të punës së fer-

merëve për të arritur zhvillimin e qëndrueshëm sigurinë e ushqimit, ruajtjen e resurseve bujqësore dhe rritjen e konkurrencës së bujqësisë.

Sipas , agronomëve, një ligj i tillë në detaje riorganizon prodhimtarinë bujqësore në Kroaci , dihet saktësisht se kush dhe çka prodhon, ndërsa konsumatori pritet të jetë i sigurt për origjinën e ushqimit që e konsumon. Me fjalë të tjera, pritet që përmes masave dhe mekanizmave të ndryshme , që më në fund të fillojë të marrin "frymë", fermat familjare , ti kthehen ardhmërisë , të fitojnë perspektivë, ndërsa të rinjtë të motivohen të mbesin në bujqësi.

Në Maqedoni si sfida në të ardhmen, pas ndihmesës së madhe që patën në vitet e kaluara , subvencionet në ruajtjen e interesimit për tu marrë me bujqësi, mbajtjen gjallë të prodhimtarisë bujqësore dhe blegtorale, mbetet targeti i modernizimit të bujqësisë dhe rritjes së konkurrencës së saj, përmes mjeteve në rritje të IPARD-it për fabrikat e ushqimit dhe investimin në zhvillimin rural.

Gjithashtu, duhet të punohet edhe më tej në sigurimin e kushteve më të mira të jetesës në vendbanimet rurale.


Nga ana tjetër, gruaja në vendbanimet rurale në Maqedoni, nuk ka qasje deri tek të mirat sociale dhe kulturore, i mungojnë informacionet publike, dhe nuk ka të drejtë në pushim mjekësor. Bile ka edhe gra që tërë jetën kanë kontribuar për shoqërinë, ndërsa tani nuk mund të realizojnë të drejtën për pension, thotë kryetarja e Federatës së Fermerëve të Maqedonisë, Vaska Mojsovska.

Një hulumtim lidhur me fermat familjare i publikuar në vitin 2017, nga ana e ekspertit Vasko Haxhievski tregon se ekonomitë familjare bujqësore si kërkesa më të mëdha kanë plasmanin më të sigurt , subvencionet më të larta, çmimet më të ulëta të prodhimit, trajnimet... Sipas autorit, përgjigjet për këto pyetje, i ngjasojnë edhe një liste dëshirash të shtetit, për të cilat në fakt, bujqit mundet pjesërisht të gjejnë realizimin e tyre , përmes organizimit në forma të ndryshme të punës. Kjo për shkak se biznesi ambient i në shtet, në një pjesë të madhe varet edhe nga rrjedhat ekonomike rajonale, marrëveshjet për tregti të lirë, konkurrencës me kufi të hapur, dhe faktorët e tjerë që ndikojnë negativisht që fermerët e vegjël , dhe të paorganizuar si duhet dhe sa duhet, që në një pjesë të madhe ekonomizojnë punën e tyre bujqësore në kuadër të familjes. Një nga zgjidhjet është edhe qartësimi më në fund se çka në Maqedoni do të njihet zyrtarisht forma e punës si ekonomi familjare bujqësore që në fund edhe do të mbështetet me masa të ndryshme të përkrahjes nga ana e shtetit, si rrugë më të mira qasëse, infrastrukturë më e mirë, lidhje më e mirë me fabrikat e ushqimit, ndërlidhja me turizmin rural....

Ndoshta në këtë drejtim do të ndihmonte edhe një kornizë e qartë ligjore kushtuar vetëm fermave familjare , pasqyra apo evidentimi i tërë prodhimtarisë bujqësore dhe blegtorale sipas hapësirave bujqësore, strukturës së prodhimit dhe prodhuesve, ndjekja më e madhe e tregjeve rajonale, dhe ndërkombëtare lidhur me ofertën dhe kërkesën , masa që do të orientojnë prodhimtarinë bujqësore lidhur me llojet dhe sasitë e prodhimit, ndërlidhja më e madhe me shkencën...

BETEJA PËR NJË SHQIPËRI EUROPIANE ËSHTË PA KTHIM!

"Beteja që kemi nisur për një Shqipëri si gjithë Europa është pa kthim! Kjo betejë do të përfundojë me shporrjen e kësaj qeverie të kimit dhe me triumfin e shqiptarëve. Udhëtimi ynë drejt Europës është i dhimbshëm dhe kalon përmes sakrificash, por ky udhëtim është shpëtimi ynë, është çlirimi nga e keqja që i ka zënë frymën shoqërisë, është rruga e sigurt drejt mirëqenies për njerëzit", shkruan kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha në profilin e tij në Facebook.



PËR ATA QË FLASIN PËR HALIL KASTRATIN

"Kur thoni Halil Kastriati ndërton shtëpi për skamnorët me paratë e të tjerëve; -Kjo do të thotë se ata të tjerët nuk jeni ju, por janë ata që nuk kursejnë të ndajnë paratë nga djersa e tyre për një kauzë humane.

-Kjo do të thotë edhe se ju ndiheni të zënë ngushtë që keni para dhe nuk i bëni asnjë të mirë kujt.

-Kjo do të thotë edhe se ju po xhelozoni se ata të tjerët kanë zgjedhur që paratë e tyre t'ia besojnë Halil Kastriati dhe jo juve.


-Kjo do të thotë se nuk keni thënë asgjë të re, sepse para se ta thoni ju, e ka thënë vetë Halil Kastriati shumë qartë dhe në mënyrë të sinqertë se ai ndërton shtëpitë me paratë e bashkëatdhetarëve.

-Dhe, më në fund, kjo do të thotë se ju nuk merrni vesh asgjë nga humanizmi dhe filantropia, ku dikush që s'ka kohë por ka para, dhuron paranë, dikush që nuk para, por ka vullnet e dhuron kohën e tij, kush i ka të dyjat i dhuron të dyjat dhe kështu ndërtohen shtëpitë që shpëtojnë familjet nevojtare", ka shkruar një status në Facebook, Liri Loshi.

KISHA ORTODOKSE SERBE ËSHTË NËNA E ZHDUKJES SË SHQIPTARËVE

"A mendojnë disa shqiptarë pse Patriarku i Kishës Ortodokse Serbe Irinej, Peshkopi i saj për Gjermani Grigorije, Prifti Sava Janjić, e në përgjithësi Kisha Ortodokse Serbe, janë kundër delineimit të kufirit Kosovë-Serbi dhe pse nuk duan zgjidhje të përhershme mes shteteve të Kosovës dhe Serbisë?!

Po i pyes disa shqiptarë që kanë harruar që Kisha Ortodokse Serbe është nëna e tentimit serb të zhdukjes së shqiptarëve nga Kosova për më shumë se 100 vjet. Nuk besoj që besoni që Kisha Ortodokse Serbe e ka këtë pozicion sepse do ta shtetëzojë dhe ndajë Kosovën nga Serbia. Apo e kam gabim?!", ka shkruar një status në Facebook, Uk Lushi, njëri nga ish pjesëtarët e Batalionit 'Atlantiku'.



IMUNITETI I TRAJKO VELJANOVSKIT

XHAFERI E HEQ FAJIN: GJYKATA PËRGJEGJËSE NËSE ARRATISËT VELJANOSKI

Për mundësinë e arratisjes së Veljanovskit, thotë Xhaferi, përgjegjëse do të jenë gjykatat, sepse ato duhet ta sigurojnë praninë e të akuzuarve. "E imja është që të mbaj llogari për punën e Parlamentit dhe kjo të bëhet në bazë të procedurave", tha Xhaferi



Koha Destan JONUZI

Shkup, 27 shkurt - Kryetari i Parlamentit të Maqedonisë së Veriut, Talat Xhaferi, thotë se në Parlament nuk kishte kushte të votohet për marrjen e imunitetit të deputetit dhe ish-kryetarit të Parlamentit, Trajko Veljanoski, sepse paraprakisht nuk ishte sjellë përfundim i Komisionit për Çështje të Rregullores, Mandatit dhe Imunitetit. Për këtë, tha Xhaferi, të hënën, e kishte njoftuar Gjykatën Penale. Sipas Xhaferit, Parlamenti nuk kishte përfundim në bazë të së cilit do të votohej, sepse në Komisionin raportin i votave "për" dhe "kundër"

marrjes së imunitetit ishin 4:4 që, siç theksoi ai, nënkupton se nuk kishte përfundim as "për" e as "kundër" marrjes së imunitetit. Thotë se e kishte marrë raportin e Komisionit, por pa përfundim. Në bazë të raportit, ai ishte i detyruar që të caktojë seancë edhe pse pas pikës nuk kishte përfundim të Komisionit adekuat.

Parlamenti, siç potencoi Xhaferi në takimin e djeshëm me gazetarët, nuk e sjellë vendimin me kërkesë të gjykatës, por në bazë të përfundimit të Komisionit, ndërsa të tillë në këtë rast nuk kishim. Që të mos ndodh kjo në të ardhmen, ai vlerëson se me ndryshimet e Rregullores, duhet të parashihet

zgjidhje se si të veprojnë Parlamenti në rast kur nuk ka përfundim të Komisionit. Për deklaratën e prokurores Villma Ruskoska se Parlamenti do të jetë përgjegjës për arratinë eventuale të Veljanoskit dhe Lupço Dimovskit, të cilit gjithashtu nuk i është marrë imuniteti, Xhaferi thotë se është dhënë për qëllime mediatike.

Për këtë, potencoi ai, përgjegjëse do të jenë gjykatat, sepse ato duhet ta sigurojnë praninë e të akuzuarve. E imja, tha Xhaferi, është që të mbaj llogari për punën e Parlamentit dhe kjo të bëhet në bazë të procedurave. Në lidhje me seancën në të cilën duhej të sillej vendim për marrjen e imunitetit të deputetit

Lupço Dimovski, Xhaferi theksoi se e kishte ndërprerë, sepse edhe pse në sallë kishte 61 deputetë për kuorum, nuk kishte shumicë prej 61 votave për votimin e vendimit.

Veç kësaj, Xhaferi ka informuar se Parlamenti i Maqedonisë së Veriut nuk do të punojë nga 1 prilli kur fillon fushata parazgjedhore për zgjedhjet presidenciale. Kryeparlamentari thotë se kjo është një praktikë e zakonit që Parlamenti të mos mbajë seanca në atë periudhë, por lë mundësi të thirr seancë nëse paraqitet nevojë e menjëhershme. Ai në takimin me gazetarët theksoi se nëse në raundin e dytë zgjedhor nuk ka census dhe nuk zgjidhet presidenti i ri i shtetit, sipas Kushtetutës kryetari i Kuvendit e kryen detyrën në periudhë prej të paktën gjashtë muaj. Ndërkohë, tha Xhaferi, përsëritet procedura për zgjedhjen e presidentit të shtetit, gjegjësisht shpallen zgjedhje të reja. Ky rast, potencoi kryetari i Parlamentit, është paraparë në Kushtetutë, siç është parashikuar dhe çfarë ndodh nëse në çfarëdo baze presidenti i shtetit të pengohet ta kryejë funksionin. Të dyja rastet, tha Xhaferi, janë rregulluar me nenet 81 dhe 82 të Kushtetutës.

Rama fton Zaevin në Tiranë

Shkup, 27 shkurt - Maqedonisë e Veriut dhe Shqipëria kanë shumë interesa të përbashkëta të cilat janë kapital serioz për ndërtimin e marrëdhënieve afatgjata miqësore, me projekte të cilat janë me interes të posaçëm për qytetarët e të dy vendeve, theksoi kryeministri Zoran Zaev në takimin e djeshëm me ushtruesin e punëve ministër për Evropës dhe Punë të Jashtme të Shqipërisë, Gent Cakaj. Duke i dëshiruar mirëseardhje delegacionit, në takim Zaev theksoi se edhe me këtë vizitë konfirmohet miqësia e përzemërt mes dy vendeve, pa çështje të hapura dhe me udhëzime të projektuara për përforcimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit mes qeverive dhe qytetarëve të të dy vendeve. Njëherit u falënderua për ratifikimin e Protokollit për anëtarësim në NATO në Parlamentin shqiptar. "Përveç interesave të përbashkëta strategjike për anëtarësim në Bashkimin Evropian, Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria punojnë me përkushtim për ndërlidhjen infrastrukturore të të dy vendeve, që këtë vit duhet të marrë dinamikë të re me përfundimin e përgatitjeve për start të punëve në linjën hekurudhore nga Kërçova deri në Lin, në Shqipërinë fqinje, si dhe me përfundimin dhe konektimin e aksit nga autostrada Kërçovë-Ohër me Qafë Thanën", u theksua në takim. Cakaj shprehi falënderim për takimin me kryeministrin Zaev, si dhe kënaqësinë e Qeverisë së vendit të tij dhe të kryeministrit Edi Rama nga marrëdhëniet e jashtëzakonshme dhe nga mbështetja e ndërsjelltë mes dy vendeve që shënojnë rritje të jashtëzakonshme në dy vitet e fundit. Në atë drejtim, ai në takim informoi se Qeveria shqiptare po i përfundon punët administrative për fillim të punës së Qendrës kulturore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Tiranë, dhe se po shqyrtohen mundësitë për hapje të Qendrës kulturore të Republikës së Shqipërisë në Shkup. Cakaj në takim e dorëzoi letrën nga kryeministri shqiptar Rama, me të cilën e fton kryeministrin Zaev për vizitë zyrtare në Tiranë. Me atë rast ia transmetoi urimet për përfundimin e suksesshëm të dispozitave nga Marrëveshja e Prespës, si dhe për procedurën e ratifikimit të Protokollit për inkaudrim të vendit tonë në NATO. Kryeministri Zaev u falënderua për ftesën dhe paralajmëroi se me kënaqësi do ta vizitojë Republikën e Shqipërisë, si vend mike e cila e mbështetë Republikën e Maqedonisë së Veriut nëpër tërë këtë proces, dhe si vende partnere të cilat kultivojnë vlerat e njëjta kur është në pyetje e ardhmja e përbashkët e rajonit, kumtoi shërbimi qeveritar për shtyp.

Ivanovi emëron gjeneralë në prag të zgjedhjeve presidenciale

Shkup, 27 shkurt - Presidenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gjorge Ivanov, në periudhën kur janë shpallur zgjedhjet presidenciale, ka bërë avancimin e gjeneralëve dhe ka emëruar komandantë në pozita të caktuara në Armatë. Në numrin e së martës të "Gazetës Zyrtare" janë publikuar dy dekrete të presidentit. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, Vasko Gjurovski, është avancuar nga gjeneral major në gjeneral lejtant. Mirçe Gjorgoski, nga gjeneral brigade është emëruar në pozitën e përfaqësuesit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në selinë e NATO-s në Bruksel, ndërsa kolonel Mario Jurisliq është emëruar për atashë armate në Paris. Ivanovi po ashtu ka vendosur edhe zëvendës komandant të ri të Organizatës për komandën operative të Armatës. Këtë funksion do ta ushtrojë gjenerali i brigadës, Orce Jordev. Është emëruar edhe kreu i Komandës së Përbashkët të Operacioneve - Besnik Emi. Të gjitha këto avancime dhe emërimet Gjorge Ivanov i ka nënshkruar si "president i Republikës së Maqedonisë", duke shkelur emrin Kushtetues të vendit Republika e Maqedonisë së Veriut.

ZAEVI PËRGJIGJET NË PYETJET E DEPUTETËVE MJETET PËR KLINIKËN E RE TË PARAPARA NGA KOHA E VMRO-së

Shkup, 27 shkurt - Mjetet për ndërtimin e Qendrës së re klinike në vlerë prej 480 milionë euro, dalin nga studimi i fizibilitetit i përpiluar në kohën e VMRO-DPMNE-së, më saktë në vitin 2014, deklaroi dje kryeministri Zoran Zaev në Parlamentin e Maqedonisë së Veriut, duke u përgjigjur në pyetjen e deputetes Liljana Zaturaska nga VMRO-DPMNE, për atë se shuma për Klinikën e re është e madhe dhe se ekziston dyshimi se paratë do të përfundojnë, siç tha, "në xhepat e dikujt". Ajo potencoi se shuma është katërfish më e madhe nga ajo që është konfirmuar nga pushteti paraprak dhe pyeti pushtetin nëse planifikon të ndërtojë anije kozmike me 480 milionë euro. "Tema për ndërtimin e Qendrës së re klinike është hapur që kur VMRO-DPMNE-ja ishte në pushtet, duam të vazhdojmë ta zgjidhim një problem të rëndësishëm në vend, lidhur me shëndetin tercial. Është e saktë se ishim kritik ndaj zgjidhjes për Qendrën klinike në lokacionin e vjetër, për të cilin ishin paraparë 85 plus 35 milionë euro, gjegjësisht 120 milionë euro. Në fund përfundoi me procedurë, me marrëveshje të nënshkruar, që u shkëput nga Qeveria aktuale dhe bëhej fjalë për një ndërtesë", tha Zaev. Përmendi se në kuadër të Qendrës klinike aktuale të



gjitha ndërtesat tjera mbeten, bëhet fjalë për një ndërtesë apo dy objekte të bashkuara në një objekt, që definitivisht paraqet zgjidhje, për një pjesë të caktuar të nevojave dhe dallimi është i madh. Zaevi i bëri thirrje opozitës të kyçet në këtë projekt, në komisionet profesionale dhe së bashku t'i zbatojnë të gjitha procedurat. Tha se ky është projekt i madh i rëndësishëm për të gjithë qytetarët, për të cilët kanë kërkuar edhe mbështetje nga Qeveria austriake.

GENT CAKAJ VIZITË ZYRTARE NË SHKUP

ME TIRANËN, ALEATË NË NATO DHE BE

“Maqedonia e Veriut nuk është vetëm vend fqinj si rezultat i rrethanave të rastësishme gjeografike, por edhe mik dhe partner strategjik me të cilin marrëdhëniet i ndërtojmë përmes dialogut konstruktiv dhe bashkëpunimit efektiv. Inkuadrimi i Maqedonisë së Veriut në NATO dhe rruga e përbashkët drejt BE-së është vlerë e shtuar për zhvillimin e rajonit dhe veçanërisht për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit”, ka thënë Cakaj

Koha

Zejnulla VESELI

Shkup, 27 shkurt - Shqipëria ishte vendi i tretë anëtar i NATO-s që e ka nënshkruar Protokollin për inkuadrimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Aleancë, ndërsa dy vendet do të ndajnë edhe përvoja në rrugën drejt Bashkimit Evropian. Këtë e theksoi ushtruesi i detyrës, ministër i Punëve të Jashtme i Republikës së Shqipërisë, Gent Cakaj në konferencën e përbashkët për shtyp me nikoqirin e tij, shefin e diplomacisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Nikolla Dimitrov.

“Republika e Maqedonisë së Veriut nuk është vetëm vend fqinj si rezultat i rrethanave të rastësishme



gjeografike, por edhe mik dhe partner strategjik me të cilin marrëdhëniet i ndërtojmë përmes dialogut konstruktiv dhe bashkëpunimit efektiv. Inkuadrimi i Maqedonisë së Veriut në NATO dhe rruga e përbashkët drejt BE-së është vlerë e shtuar për zhvillimin e rajonit dhe veçanërisht për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit”, ka thënë Cakaj. Ministri Dimitrov nga ana e tij e falënderoi Shqipërinë për ratifikimin e fundit të Protokollit për inkuadrimin në NATO në Parlamentin shqiptar. Ai u përqendrua edhe në vizat e përbashkëta evropiane të dy vendeve. “Suksesi i një shteti nga rajoni është sukses për tërë rajonit. Do të donim shumë që në qershor të kemi rast për festim të përbashkët”, ka thënë Dimitrov. Dy vendet presin që në qershor në Samitin e BE-së të konfirmohet vendimi për fillimin e negociatave me BE-në.

Në takim u bë fjalë, mes tjerash

edhe për Korridorin 8 dhe për mundësinë për nënshkrim të shpejtë të iniciativës për formimin e qendrave kulturore në dy vendet, si dhe për rëndësinë e bashkëpunimit shqiptarë në vendin tonë dhe në bashkëpunimin maqedonase në Shqipëri të cilat janë urë e bashkëpunimit, ndërsa u bë fjalë edhe për Ligjin për përdorimin e gjuhëve të cilin u përshëndet nga pala shqiptare si kontribut ndaj bashkëjetesës etnike dhe karakterit demokratik të shtetit. Në pyetje të gazetarëve, shefi i diplomacisë së Shqipërisë konfirmoi se dje në Shkup ka pasur takime me të gjithë liderët e partive politike shqiptare në të cilat, siç tha, kanë shkëmbyer ide për shumë çështje. “Shkëmbyem ide dhe patëm bisedime të sinqerta. E konfirmuam domosdoshmërinë për bashkëpunimin tonë të mëtutjeshëm që të koordinohen aktivitetet dhe për të pasur rol konstruktiv në përgjithësi”,

tha Cakaj. Në pyetjen si e komentojnë idenë për korigjimin e kufijve midis Kosovës dhe Serbisë, dy ministrat theksuan se kjo është para së gjithash, çështje e autoriteteve në Prishtinë dhe Beograd.

“Kjo është çështje për institucionet kosovare. Shqipëria mund vetëm ta mbështesë qëndrimin e Kosovës. Në këtë proces ne e mbështesim normalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë dhe mendojmë se kjo marrëveshje duhet të konkludojë me mbështetjen e perspektivave evropiane”, theksoi Cakaj. Për Dimitrov ka dy elemente kyçe për qëndrimin e Maqedonisë lidhur me këtë çështje. “Mbështesim zgjidhjen me të cilën do të harmonizohen edhe Prishtina edhe Beogradi. Kjo është shumë elementare sepse problemi është atje, Problemi i dytë është zgjidhja që do të kontribuojë ndaj stabilitetit rajonal dhe vizionit që tërë proces

si të shkojë drejt Evropës”, tha Dimitrov.

Ministri Cakaj është takuar edhe me liderët e partive politike shqiptare, ndërsa ka realizuar takim edhe me zëvendëskryeministrin Bujar Osmani. “Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria janë në prag të fillimit të negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe mbështetja e ndërsjellë në këtë proces paraqet shprehje të interesit tonë të ndërsjellë për suksesin e të dy vendeve në ambiciet e tyre për fillimin e negociatave me Unionin këtë vit. Kemi edhe disa muaj që t’i adresojmë në mënyrë intensive detyrimet tona, dhe t’i bindim vendet anëtare se kemi kapacitet, se kemi progres dhe se meritojmë fillim të negociatave me BE-në”, tha zëvendëskryetari i Qeverisë për Çështje Evropiane, Bujar Osmani. Gjatë takimit, siç informojnë nga SÇE-ja, Osmani i shprehu mirënjohje ministrit Cakaj, si dhe Qeverisë të Shqipërisë, për ratifikimin e shpejtë të protokollit me NATO-n si pjesë e mbështetjes së vazhdueshme për integrimet tona euro-atlantike. “Simbolika e këtij gjesti thelbësor është edhe një dëshmi për marrëdhëniet jashtëzakonisht të mira mes dy vendeve, të cilët kohë të gjatë jo vetëm që nuk kanë çështje të hapura, përkundrazi, ndërtojnë marrëdhënie të cilët paraqesin shprehje të vërteta të miqësisë së ndërsjellë dhe afimit të qytetarëve të të dy vendeve”, theksoi Osmani.



STJEPAN MESIQ PËR MIA-n

INTEGRIM TË SHPEJTË NË NATO

“Ta harrojmë për një moment Britaninë e Madhe, por vetëm Evropa e bashkuar mund të jetë lojtar i madh në botën moderne të lojtarëve të mëdhenj siç janë SHBA, Rusia, Kina, Brazili, India”, thotë Mesiq i pyetur kur Kuvendi kroat do ta ratifikojë protokollin për në NATO

Shkup, 27 shkurt - Interes i Kroacisë është që sa më shpejt ta ratifikojë Protokollin për pranimin e Maqedonisë së Veriut në NATO, deklaroi për MIA-n ish-presidenti kroat Stjepan Mesiq, i cili në Shkup merr pjesë në panel diskutimin me temë “Leadershipi i bazuar në vlera - nga parimi e deri te realizimi”, me rastin e 15-vjetorit të vdekjes tragjike të ish-presidentit Boris Trajkovski. “Besoj se Kroacia këtë do ta bëjë, sepse është interes i ynë është që sa më shpejt të realizohet dëshira e Maqedonisë të hyjë në Paktin Atlantik. Por edhe më tepër të hyjë në BE, sepse ky është vetëm hapi i parë për integrimet euroatlantike. Maqedonia ka merituar me gjithë atë që e ka bërë gjatë një viti e gjysmë, rruga e saj në integrimet euroatlantike që sa më sh-

pejt të realizohet, sepse Evropa e bashkuar është qëllimi ynë, por kjo është edhe dëshira jonë, si dhe dëshirë e të gjithë Evropës. Ta harrojmë për një moment Britaninë e Madhe, por vetëm Evropa e bashkuar mund të jetë lojtar i madh në botën moderne të lojtarëve të mëdhenj siç janë SHBA, Rusia, Kina, Brazili, India”, thotë Mesiq i pyetur kur Kuvendi kroat do ta ratifikojë protokollin për në NATO.

Ai potencoi se marrëveshja për fqinjësi të mirë me Bullgarinë është hap historik për normalizim të përhershëm të marrëdhënieve midis të dyja vendeve, ndërsa për Marrëveshjen e Prespës vlerësoi se paraqet ndoshta marrëveshje më të rëndësishme dypalëshe të nënshkruar në Evropë pas Luftës së Dytë Botërore. I pyetur nëse debati i cili ekziston në BE “se pari reforma, pastaj

zgjërimi” mund ta pengojë dhënien e dritës së gjelbër për fillim të negociatave të vendit tonë me Unionin, Mesiq është decid se zgjerimi do të duhej të përshpejtohet. “Unë do të doja të përshpejtohet pranimi i të gjithë juglindjes së Evropës në BE, sepse edhe Maqedonia edhe vendet e tjera të cilat ende nuk kanë hyrë në Union janë të lodhura nga pritja. Evropa, megjithatë, është e lodhur nga ky bashkim, ndërsa zgjedhim që në atë mënyrë që e përshpejton këtë bashkim”, thekson Mesiq.

Duke i komentuar kërcënimet e liderit të opozitës greke Kirijakos Mocotakis se do ta bllokojnë anëtarësimin e vendit tonë në BE nëse vijin në pushtet në zgjedhjet e ardhshme të parapara për në tetor, të këtij viti, Mesiq me qëndrim se në interes të Greqisë është pranimi ynë në Union. “Nuk do të doja

të komentoj deklarata të tilla, por mendoj se edhe Greqisë i përgjigjet që Maqedonia e veriut të hyjë sa më shpejt në BE, sepse nëse të gjithë i hapim kufijtë e vet shumë shpejt do të vijë deri te realizimi i më shumë qëllimeve. Para së gjithash, përfundimisht do të humben motivet për luftë, sepse historia e Evropës tregon se çdoherë ka pasur disa që në pretekstin se i mbrojnë pakicat, kanë pushtuar territore të huaja. Kur të gjithë do të hyjnë në BE, më nuk do të ekzistojë motiv që të pushtohen territore të huaja, të mbrohet pakica e vet kombëtare, sepse secili popull në një Evropë të bashkuar do të jetojë në korpusin e tij kulturor. Sipas kësaj, nuk ka arsye për pushtim të territoreve të huaja, por të gjitha arsyet janë për bashkim evropian”, porositi ish-presidenti i Kroacisë, Stjepan Mesiq.

PAK DESTINACIONE PËR UDHËTIM ME TREN

HEKURUDHA NË VENDNUMËRO

Linjat ndërkombëtare nga Shkupi vozisin vetëm deri në Prishtinë, ndërsa deri në Beograd dhe Selanik qarkullojnë vetëm gjatë muajve të verës. Në transportin e brendshëm qarkullojnë 15 linja të trenit



Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 27 shkurt - Komunikacioni hekurudhor në Maqedoni shënon rënie të dukshme. Për shkaqe objektive, por edhe subjektive se vjen e më pak trena qarkullojnë nga Shkupi, por edhe në drejtim të kryeqendrës së Maqedonisë së veriut. Linjat ndërkombëtare nga Shkupi vozisin vetëm deri në Prishtinë, ndërsa deri në Beograd dhe Selanik qarkullojnë vetëm në muajt e verës. Në transportin e brendshëm qarkullojnë 15 linja të trenit, dhe atë nga katër prej Shkupit deri në Tabanov dhe Veles, nga tre deri në Veles, nga dy deri në Gjevgjeli dhe nga një deri në Kërçovë dhe Koçan dhe anasjelltas.

Në fillim të vitit të kaluar, kompania "Trenat e Serbisë" së bashku me kompaninë greke TRAINOSE, vendosën që pas 30 shtatorit të vitit 2018, nuk do të qarkullojnë në linjën Beograd-Selanik-Beograd, për shkak të mungesës së rentabilitetit. Apo do të qarkullojnë në këtë linjë, vetëm në periudhën e verës apo prej 15 qershorit deri më

15 shtator të vitit 2019. Konfom dispozitivave ndërkombëtare, ato kanë të drejtë në një vendim të tillë, për shkak se menaxhmenti i kompanive ku nisën dhe ku nisën treni edhe mund të ndërprisë udhëtimin trenit, ndërsa Hekurudhat e Maqedonisë si menaxhment transit nuk kanë të drejtë të vendosin për një ndërprerje të tillë. Njëherazi në negociata me menaxhmentin e fqinjët verior është arritur pajtimi që treni të qarkullojë deri në fund të shtatorit të vitit të kaluar.

Maqedonia posedon 700 kilometra të hekurudhës, ndërsa parku vozitës përbëhet nga 11 trena me motor dizel dhe 4 trena me ngasje elektrike.

Në ndërkohë në plan është projekti i ri për kafe në Selanik. Hekurudhat e Maqedonisë janë në bisedime e sipër me kompaninë transportuese të hekurudhës greke, Trainose për vendosjen e linjave të reja përgjatë muajit të verës nga Shkupi deri në Selanik për shpin, dhe pikat turistike në

detin Egje, Leptokaria dhe Nei Pori, por edhe për linjë direkte prej Shkupi deri në Stamboll. Planifikohet që në këtë të inkuadrohen edhe agjencitë turistike që në ofertat e tyre do të përfshijnë udhëtimin me tren nga Shkupi deri në Nei Pori. Me autoritete greke, bisedohet edhe për vendosjen e linjës Manastir-Lerin, pas rikonstruimit të saj në fund të vitit të kaluar. Trena lokal tejkufitar parashikohen edhe me Serbinë për çka bisedohet me autoritete e atjeshme. Ideja është që treni nga Tabanoci të lidhet me trenin lokal Preshevë-Nish, për të vazhduar më tej udhëtimin për në Beograd.

Ulja e madhe e transportit të pasagjerëve me tren, është edhe më shqetësuese nëse krahasohet me situatën e para 13 viteve, kur nga Shkupi i nisnin bile 32 trena në linjat vendore dhe ndërkombëtare.

Transporti me tren në Maqedoni vite me radhë vuan edhe nga mospasja e linjës hekurudhore në drejtim të Bullgarisë që është në

ndërtim e sipër dhe pritet të përfundojë deri në vitin 2023, ndërsa me tren nga Shkupi, përmes Kërçovës deri në Durrës pritet të udhëtojmë nga viti 2030. Sfidë në të ardhmen do të jetë realizimi i linjës së hekurudhës prej Kërçovës deri në kufirin e Shqipërisë, në gjatësi prej 62.5 kilometra. Kjo linjë si pjesë e korridorit evropian tetë do ti kushtojë shtetit afër 500 milion euro, ndërsa pritet të ndërtohet në një pjesë të madhe me kredi dhe grante të jashtme, si dhe ekspertizë ndërkombëtare ngjashme me linjën në drejtim të Bullgarisë.

Në plan është edhe vendosja e linjës hekurudhore prej stacionit të trenave në Shkup deri në aeroportin e Shkupit, pas arritjes së rezultateve prej 2 milion në vit të pasagjerëve që udhëtojnë nga Maqedonia me avion jashtë shtetit. Shteti nevojitet të ndërmarrë edhe masa për lehtësimin e transportit të pasagjerëve dhe mallrave, Në shtetet anëtare të BE-së, transporti hekurudhor kryhet pa

ndryshimin e lokomotivave në vendkalimet kufitare dhe pa kryerjen e kontrolleve të ndryshme doganore. Përkundër kësaj, një tren që më parë qarkullonte nga Selaniku në drejtim të Zagrebit nevojitej që të ndërrojë së paku katër lokomotiva, deri në destinacionin e fundit. Shtuar këtu humbjen e kohës me formalitet e kontrolleve të pasaportave dhe të doganës. Nga ana tjetër, në korridorin 10, trenat e transportit të mallrave nga Hungaria përmes Rumanisë, Bullgarisë dhe deri në Greqi si rrjedhojë e anëtarësimit të këtyre shteteve në BE, e kanë shumë më lehtë të organizojnë udhëtimin në raport me shtetet e ish Jugosllavisë. Në këtë drejtim, është paralajmëruar se Maqedonia dhe Serbia prej vitit 2020 do të fillojnë të ndërtojnë vendkalim kufitar të përbashkët hekurudhor në Tabanoc me vlerë prej 4.5 milionë euro, që do të financohet nga BE.

Në ndërkohë ekspertët thonë se shfrytëzimi më i madh i trenit si mjet transportues në raport me mjetet e tjera kërkon modernizimin e tij. "Transporti me tren mund të shfrytëzohet për bartjen e mallrave dhe pasagjerëve prej Shkupit në drejtim të Tetovës, Kumanovës dhe Velesit, ku jetojnë më shumë se një milion banorë që për çdo ditë gravitojnë ndaj Shkupit. Largësia prej vetëm 50 kilometra e këtyre qendrave urbane prej Shkupit mund të jetë afër nëse pasagjerëve ju mundësohet shërbim cilësor dhe kohë e shkurtër e udhëtimit që e plotësuar me transport urban, do ti kthente ata ndaj transportit me tren", thotë eksperti Zoran Krakutovski. Sipas tij, edhe në Shkup mund të shfrytëzohet unaza e hekurudhës për të evituar tollitë në trafik por edhe për të ulur ndotjen, duke ju mundësuar qytetarëve të Shkupit të mos jenë të detyruar të tranzitojnë në qendër të Shkupit.

Diplomacia ekonomike, zyra të reja në disa shtete

Shkup, 27 shkurt - Deri në fund të këtij vitit pritet që të hapen zyra në Gjermani, Turqi, dhe Shtetet e Bashkuara, të cilat konceptohen si zyra shtetërore për tërheqjen e investimeve të huaja, por edhe si qendra nga të cilat do të ofrohen produkte nga ekonomia. Për njerëzit që do të dërgohen atje, nëpërmjet Drejtorisë për Zonat e Zhvillimit Industrial Teknologjik, do të sigurohet akomodimi dhe zyra, në mënyrë që ata menjëherë të fillojnë punën.

"Do ta kenë mbështetjen e

përgjithshme nga ne. Do të marrin të gjithë mbështetjen e infrastrukturës. Mendojmë se modeli do të jetë i suksesshëm", thonë nga Drejtorja për Zonat e Zhvillimit Industrial Teknologjik. Prandaj, ata informuan se së bashku me Ministrin e Punëve të Jashtme tashmë po punojnë në procesin e regjistrimit të këtyre zyrave, të cilat do të jenë zyra përfaqësuese tregtare. Aktivitetet nuk do të përqendrohen vetëm në këto tre vende, por zyra në Gjermani do të mbulojë Evropën, zyra në Turqi do të

jetë përgjegjëse për Lindjen e Mesme, ndërsa zyra në SHBA për të gjithë kontinentin.

Koncepti i promotorëve u prezantua nga Qeveria e VMRO-DPMNE-së dhe për ta u paguan shuma të larta nga buxheti i shtetit. Auditorët gjithashtu vunë në dukje vërejtje serioze mbi punën e promotorëve ekonomikë. LSDM njoftoi në programin zgjedhorë se do të shfuqizojë këtë koncept të promovimit të shtetit sepse është i shtrenjtë dhe nuk mban një investim. (Q.A)

LSM propozon rritje të pagës minimale

Shkup, 27 shkurt - Lidhja e Sindikatës së Maqedonisë (LSM) konsideron se ka hapësirë që të rritet paga minimale e cila për momentin arrin 12.165 denarë. Përlllogaritjet e Sindikatës tregojnë se ka nevojë për rritjen e pagës minimale, madje për së paku 12 për qind. "LSM tregon se në kushte kur shporta minimale sindikale për janar 2019 arrin 32.761,00 denarë, ndërsa vetëm harxhimet për ushqim arrijnë 13.621,33 denarë ekziston nevojë reale e rritjes së pagës minimale e cila konform rekomandimeve

evropiane dhe tendencave duhet të arrijë 60 për qind nga paga mesatare në shtet, thonë në LSM. Prej atje shtojnë se konform Ligjit, në mars duhet të bëhet harmonizim i pagës minimale sipas kriterëve të përcaktuara, që ministri për Punë dhe Politikë Sociale do ta shpall në Gazetë zyrtare sipas mendimit paraprak në Këshillin ekonomik-social. "LSM është e gatshme për fillimin e dialogut social lidhur me rritjen e propozuar të pagës minimale e cila do të jetë bazë e rritjes së pagave për të gjithë të punësuarit.

PAS TRAGJEDISË SË LLASKARCËS

ÇFARË MËSIMESH NXORI SHTETI?

"Duhet të punojmë që të formohet një qendër e përbashkët për thirrje urgjente, jo vetëm për qytetin e Shkupit por për gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, që të mund të gjitha ekipet që janë në terren të jenë në shërbim të qytetarëve", thonë nga Qendra e Shëndetit-Shkup, nën ombrellën e së cilës është Ndihma e Shpejtë. Më shumë se dhjetë vite nuk ka të dhëna të sakta se sa pika të zeza ka në rrugët e Maqedonisë së Veriut dhe ku saktë ato ndodhen

Koha Destan JONUZI

Shkup, 27 shkurt - Po bëhen 16 ditë nga tragjedia në afërsi të fshatit Llaskarcë të Shkupit në të cilën humbën jetën 15 persona, ndërsa 37 të tjerë ngelën të lënduar. Ende po hetohet se pse u rrokullisë autobusi dhe i njëjti "fluturoi" për 200 metra nga autostrada në një rrugë lokale. Të parët, të cilët u dolën në ndihmë viktimave të kësaj fatkeqësie fatale, ishin banorët lokalë ndërsa më pas në vendin e tragjedisë kanë ardhur ekipet e Ndihmës së Shpejtë. Pamjet dhe transmetimet ishin të tmerrshme.

"Të gjithë kërkonin ndihmë, e ti nuk mund të arrish që në të njëjtën kohë t'u ndihmosh të gjithëve. E tmerrshme. Kishte njerëz edhe nën autobusin e përmbysur", këto ishin dëshmitë e para të banorëve pas aksidentit. Nuk kanë munguar as thirrjet telefonike drejtuar edhe Ndihmës Shpejtë, por në thirrjen e parë nuk ka pasur sqarim të saktë mbi fatkeqësinë, as për numrin e madh të viktimave. Në ora 17 e 3 minuta kemi pranuar thirrjen e parë për përmbysjen e një kamioni, pasi që informacioni i parë ka qenë ky, që pas 30 sekondave të marrim një telefonatë tjetër se nuk bëhet fjalë për kamion, por për autobus, që ishte e tmerrshme, pasi që e dinim se atëherë do të ketë një numër të madh të të lënduarve", thonë për gazetën KOHA nga Ndihma e Shpejtë në Shkup.

Të gjithë 8 autoambulancat, prej të cilave 5 janë në funksion të



plotë, u nisën në drejtim të Llaskarcës, ndërsa Ndihma e Shpejtë-Shkup, ka ngelur pas asnjë autoambulancë, në rast nevojë për intervenim. Në vitin 2012 për nevojat e Ndihmës së Shpejtë-Shkup, janë blerë 14 autoambulanca, ndërsa tani në funksion janë vetëm se 8 prej tyre, nga të cilat 5 me kapacitet të plotë.

NDIHMË E SHPEJTË, ME AUTOAMBLANCA TË NGADALTA!

Shërbimi i emergjencës mjekësore në Maqedoni, funksionon në kuadër të shtëpive të shëndetit, ndërkaq buxheti jepet nga Fondi për Sigurim Shëndetësor, varësisht ekipeve mjekësore. Për një ekip mjekësor, buxheti mujor arrin vlerën prej 177.000 denarë, i cili shfrytëzohet për paga bruto të ekipit mjekësor - mjekë, motër medicinale dhe vozitës të autoambulancave, si dhe për mirëmbajtje të objekteve shfrytëzuese, autoambulancave, mjeteve medicinale dhe derivate të naftës. Ndërsa, prej viti 2016, autoambulanca nuk ka në punktin në Çento, në Gjorçe Petrov, në Draçevë, në Petrovec, në Çuçer Sandevë të Shkupit, kurse mbulesa dhe dhënia e shërbimit shëndetësor sigurohet nga ana e punkteve tjera të Ndihmës së Shpejtë.

Problemi me autoambulancat e Ndihmës së Shpejtë në Maqedoni, përveç se në numrin e tyre varë-

sisht numrit të banorëve në qytetet e caktuara, qëndron edhe në gatishmërinë e veturave. Sipas të dhënave, Maqedonia kryesisht ka vetura të vjetra dhe armotizuara që duhet të shërbejnë për rreth 2 milionë banorë. Veturat më të amortizuara i ka Kërçova, e kurse më të vjetrën e ka Probishtipi. Në Kërçovë shërbimi i Ndihmës së Shpejtë kryhet me dy autoambulanca që janë më të amortizuara në Maqedoni. Njëra ka 1 milionë e 360 mijë kilometra dhe tjetra ka 800 mijë kilometra të kaluara. Pas saj vjen Kriva Pallanka me dy autoambulanca: me mbi 652 mijë kilometra dhe 620 mijë kilometra të kaluara, Dibra me një autoambulancë me 640 mijë kilometra, Velesi me një autoambulancë me mbi 452 mijë kilometra dhe Ohri me dy autoambulanca me mbi 450 mijë kilometra dhe me rreth 442 mijë kilometra. Në bazë të vitit të prodhimit, autoambulanca më e vjetër që ofron shërbime të Ndihmës e Shpejtë përdoret në Probishtip - e prodhuar në vitin 1986, pas saj në Dellçevë - e prodhuar në vitin 1987, në Krushevë dhe Strugës - të prodhuara në vitin 1989, në Negotinë dhe Ohër - të prodhuara në vitin 1993 dhe në Veles - e prodhuar në vitin 1994. Nga 156 vetura, 33 për qind e tyre janë donacion i huaj, rreth 40 për qind janë financim i mjeteve të buxhetit shtetëror, e kurse për 27 për qind Ministria e

Shëndetësisë nuk ka informacion se nga kush janë financuar. Së fundmi është përmblyllur proceduar e tenderimit dhe Ndihma e Shpejtë e Maqedonisë së Veriut duhet që të furnizohet edhe me 12 autoambulanca të reja, nga të cilat 6 do të jenë për Shtëpinë e Shëndetit në Shkup me qëllim që të vihen në funksion edhe 6 punktet e Ndihmës së Shpejtë në Shkup të cilat nga viti 2016 nuk janë në funksion. Ndërkohë që priten edhe 3 autoambulanca si donacion nga Republika Çeke.

AUTOMJETET ZJARRFIKËSE TË VJETRA 27 VITE!

Numri i 25 ka qenë automjeti i shërbimit të zjarrfikësve i cili nga njësisia e lagjes Gjorçe Petrov është nisur në drejtim të Llaskarcës më datën 13 shkurt. Automjeti është i vjetër tri dekada, pra që nga koha e socializmit. Nga ana tjetër gjithandëj nëpër botë ekziston një numër telefoni për thirrjet urgjente, ndërsa në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka tre (192, 193, 194), të veçantë për policinë, ndihmën e shpejtë dhe shërbimin kundër zjarrit. Edhe shërbimi i Ndihmës së Shpejtë nuk ka një qendër të përbashkët ku pranohen thirrjet urgjente të Ndihmës së Shpejtë, por çdo qytet ka qendrën e vet të thirrjeve urgjente në Ndihmën e Shpejtë.

Ndërkaq, tridhjetë njësitet ter-

ritoriale të Zjarrfikësve në Republikën e Maqedonisë së Veriut posedojnë 220 automjete zjarrfikëse, vjetërsia mesatare e të cilave është 27 vite, tregon analiza e Qendrës për Komunikime Qytetar. Prej gjithsej 220 automjeteve 154 janë të prodhuara në shekullin e kaluar. Më të vjetrat janë nga viti 1966 të cilat i posedojnë Strumica nga marka "fap 13" dhe Vallandova nga marka "tam 5500". Nga kjo Qendër bëjnë krahasim duke theksuar se ministritë dhe komunat kanë në dispozicion 2645 automjete, që nënkupton se në çdo të 12-in automjet vjen nga një automjet special zjarrfikës. Për dallim nga automjetet e udhëtimit të cilat kryesisht blihen nga paratë e buxhetit, pjesa më e madhe e automjeteve speciale zjarrfikëse janë fituar si donacione. "Te automjetet e udhëtimit ka situatë të kundërt, ndërsa 71 për qind janë blerë në mileniumin e ri. Përkundër 27 viteve të automjeteve zjarrfikëse, ato të udhëtimit janë të vjetra 12,5 vite", theksojnë nga Qendra.

Automjetet në Kratovë janë më të vjetrat - me vjetërsi mesatare prej 39 viteve, përderisa veturat më të reja i ka Velesi - me vjetërsi mesatare prej 18 viteve. Krahas Kratovës, vjetërsi mesatare më të madhe se 30 vite kanë automjetet e njësiteve zjarrfikëse në: Manastir, Gjevgjeli, Kriva Pallankë, Krushevë, Ohër, Sveti Nikole, Strugë dhe Strumicë. Në analizën është theksuar se në bazë të numrit të banorëve, më shumë automjete ka njësi territoriale i Qytetit të Shkupit me 47 automjete, mesatarisht 26 vite. Vijon Manastiri, njësi territorial i të cilit i mbulon edhe Novacin dhe Mogillën, me 13 automjete, me vjetërsi mesatare prej 30 viteve. Në grupin e njësiteve territoriale zjarrfikëse me më shumë 10 automjete bën pjesë edhe Strumica, e cila i mbulon edhe komunat Bosilovë, Vasilevë dhe Novo Sellë, me 12 automjete, të vjetra mesatarisht 30 vite. Më së paku, nga tri automjete kanë njësitet territoriale në Demir Hisar mesatarisht të vjetra 28 vite, Kavadar 25 vite, Kratovë 39 vite, Krushevë 38 vite dhe Makedonski Brod 21 vite.

"Për shkak të vjetërsisë së automjeteve, një pjesë e madhe e komunave nuk posedojnë aspak të dhëna për vlerën e këtyre automjeteve. Prej 220 automjeteve, të dhëna për vlerën ka vetëm për 77 automjete. Ato, kur janë blerë ose ishin fituar si donacion, kanë kushtuar 2.975.318 euro, gjegjësisht vlera mesatare e një automjeti ishte 38.640 euro", theksohet në analizë. Baza e të dhënave të të gjitha automjeteve zjarrfikëse është përgatitur në bazë të të dhënave të si-

NDIHMË FINANCIARE PËR TË PËSUARIT E LLASKARCËS

Anëtarët e Këshillit të Komunës së Gostivarit në seancën e fundit njëzëri ka miratuar vendimin për ndarjen e ndihmës në të holla për fëmijët e viktimave dhe udhëtarëve të lënduar në aksidentin e autobusit tek fshati Llaskarcë. Mjetet do të paguhet nga buxheti i komunës. "Kjo ndihmë është në shenjë të solidaritetit ndaj viktimave në ngjarjen tragjike ndaj familjeve të viktimave dhe të lënduarve në aksidentin e autobusit në rrugën Shkup-Tetovë. Nga 30 mijë denarë do të merr

familja e viktimave, ndërsa nga 15 mijë denarë do të marrin të lënduarit", qëndron në shpjegimin e këshilltarëve. Si gjest të falënderimit për ndihmën e ofruar dhe humanitetin e treguar nga banorët e fshatit Llaskarcë, komuna Bashkësisë lokale do t'i donojë 300 mijë denarë. Javën e kaluar, Këshilli i Qytetit të Shkupit si shprehje e solidaritetit, çdo familje e cila ka humbur anëtar të vetin do t'i ndajë ndihmë në para prej 100 denarë në shumë neto, ndërsa të lënduarve nga 30 mijë denarë.

POLICIA SIGURON SHOFERIN E AUTOBUSIT

Shoferi i autobusit, i cili para dy javëve u përmbys në rrugën Shkup-Tetovë me ç'rast humbën jetën 14 persona, ndërsa 37 u lënduan, po merr kërcënime për jetën e tij, ndërsa Ministria e Punëve të Brendshme



ndërmerr masa për mbrojtjen e tij si pjesë e procedurës. Kështu deklaroi ministri i Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski, ndërsa pret që Prokuroria publike për një kohë shumë të shkurtër të tregojë shkaku konkret për aksidentin për çka janë mbledhur shumë materiale, ndërsa ekspertizat janë nga fundi. "Punojmë ende në lidhje me rastin sipas urdhrave që i marrim nga Prokuroria publike. Shumë materiale janë grumbulluar, ekspertizat janë nga fundi dhe pres që PP për një kohë shumë të shkurtër të dalë me shkaku konkret lidhur me ngjarjen. Është e saktë se shoferi merr kërcënime për jetën e tij. Kërcënohet dhe për këtë ndërmerr masa për mbrojtjen e tij sepse edhe kjo është pjesë e kësaj procedure. Është me rëndësi që t'i mbrojmë të gjithë", deklaroi Spasovski.

guruara nga 30-të njësitet territoriale zjarrfikëse, në bazë të kërkesës së dorëzuar për informacione me karakter publik.

Në bazë të Ligjit për zjarrfikës, njësite territoriale zjarrfikëse formojnë Qyteti i Shkupit dhe komunat: Manastir, Veles, Gjevgjeli, Gostivar, Koçan, Kumanovë, Ohër, Prilep, Strumicë, Tetovë, Shtip, Resnjë, Kavadar, Vallandovë, Dibër, Berovë, Vinicë, Dellçevë, Kriva Pallankë, Kratovë, Strugë, Kërçovë, Krushevë, Makedonski Brod, Radovish, Sveti Nikolla, Probishtipi, Demir Hisari dhe Negotina.

THIRRJET URGJENTE DUHET TA KENË NJË QENDËR TË PËRBASHKËT

"Duhet të punojmë që të formohet një qendër e përbashkët për thirrje urgjente, jo vetëm për qytetin e Shkupit por për gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, që të mund të gjitha ekipet që janë në terren jo vetëm nga qyteti i Shkupit por edhe jashtë tij të jenë në shërbim të qytetarëve", thonë nga Qendra e Shëndetit Shkup, nën ombrellën e së cilës është Ndihma e Shpejtë. Sipas planit autoambulancat duhet të kontrollohen nga një qendër e vetme dhe me sistem GPRS ku do të detektohet vetura që është më afër vendit ku duhet të jepet ndihma e shpejtë. "Një qendër e përbashkët, një numër i përbashkët telefoni jo vetëm që do të zvogëlonte harxhimet, por do të fitohej edhe një intervenim më i shpejtë dhe më i mirë", thonë nga Ndihma e Shpejtë.

PIKAT E ZEZA

Më shumë se dhjetë vite nuk ka të dhëna të sakta se sa pika të zeza ka në rrugët e Maqedonisë së Veriut dhe ku saktë ato ndodhen, pasi që me ndryshimet në Ligjin për siguri në komunikacion, termi "pikat e zeza" është fshirë dhe tani po mbahet evidencë për lokacionet e rrezikshme të komunikacionit. Në vitin 2018, në fatkeqësi komunikacioni kanë humbur jetën 129 persona, ndërsa 6.700 persona kanë qenë të lënduar. Ndërsa sipas të dhënave të vitit 2010, në shtet janë regjistruar 169 pika të zeza, por disa prej tyre tanimë janë larguar, duke marrë parasysh faktin se janë ndërtuar disa rrugë alternative, siç është autostrada e re nga Demir Kapia deri në Gjevgjeli, si dhe janë zgjeruar disa rrugë kritike, ndërkohë që së shpejti duhet të lëshohet në përdorim edhe autostrada Shkup - Shtip, ndërsa për disa vite do të funksionon edhe autostrada Kërçovë - Ohër. Megjithatë, kjo do të thotë se tërësisht janë eliminuar disa nga pikat problematike të rrugëve.

Sipas rekomandimeve të Këshilli Republikan për Siguri në Komunikacion, është primare që vozitësit të fokusohen në kushtet e rrugës dhe ta respektojnë sinjalizimin e rrugëve, pasi që kur nuk ka tejkalime të shpejtësisë dhe vozitet në mënyrë të disiplinuar nga ana e të gjithë pjesëmarrësve në komunikacion, nuk ka arsye që të ndodh edhe fatkeqësia në komunikacion.



KRSKRRJEP ALARMIN

RRETH 40 MIJË AUTOMJETE PA REGJISTRIM VOZITEN NËPËR RRUGË

Sipas KRSK-së, asnjë arsyetim nuk mund të jetë i mirë dhe të gjithë shoferët duhet të jenë të vetëdijshëm për pasojat të cilat i sjellë automjeti që nuk është në rregull dhe i paregjistruar



Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 27 shkurt - Rreth 40.000 automjete të paregjistruara dhe të pasiguruara, sipas kompanive të sigurimit, në mënyrë aktive janë të përfshira në komunikacionin e rrugëve dhe paraqesin kërcënim për lëvizjen e sigurt në komunikacion, paralajmërojnë nga Këshilli Republikan për Siguri në Komunikacionin e Rrugëve. Prej atje theksojnë se siguria në komunikacion në masë të madhe varet nga rregullshmëria e veturës, por se edhe krahas kësaj një grup i caktuar i shoferëve i shfrytëzojnë automjetet duke shmangur ose "harruar" kontrollin e detyrueshëm teknik të automjeteve, servisit e rregullt dhe sigurimitin e rregullt të detyrueshëm dhe regjistrimitin e automjetit.

"Raporti i tillë drejtë automjetit dhe në përgjithësi drejtë sigurisë në komunikacion është i

papërgjegjshëm dhe i rrezikshëm. Motivet e sakta për mënyrën e tillë të sjelljes zbulohen vështirë, por është e sigurt se bëhet fjalë për udhëtarë pa përgjegjësi të cilët e nënvlerësojnë rrezikun nga fatkeqësitë eventuale dhe të cilët i nënçmojnë pasojat nga fatkeqësitë. Shoferët e tillë, edhe krahas asaj që e vërejnë se ka parregullsi të caktuara ose sistem i caktuar i automjetit nuk funksionon, megjithatë vendosin që të përfshihen në komunikacion dhe ta rrezikojnë sigurinë në komunikacion", thonë nga KRSK. Theksojnë se vozitja e automjeteve të parregullta dhe të paregjistruara është e rrezikshme, me rrezik dhe pa dobi nëse kemi parasysh faktin se sa të mëdha janë sanksionet për pjesëmarrje në komunikacion me automjet të paregjistruar dhe cilat janë pasojat dhe humbjet nëse merret pjesë në fatkeqësi komunikacioni me automjet që nuk është

në rregull, i paregjistruar dhe i pasiguar.

Arsyetimet më të shpeshta të cilat i përdorin shoferët janë "Kam shpenzime, nuk kam mjaftueshëm para", "Isha i sigurt se vetura ishte në rregull", "Nuk shfaqte shenja të defektit", "Gjithë jetën vozis kështu, asgjë nuk ka ndodhur", "Nuk e përdor shumë veturën, nuk më paguhet që ta regjistroj".. Sipas KRSK-së, asnjë arsyetim nuk mund të jetë i mirë dhe të gjithë shoferët duhet të jenë të vetëdijshëm për pasojat të cilat i sjellë automjeti që nuk është në rregull dhe i paregjistruar. Për pjesëmarrje në komunikacionin e rrugëve, automjetet duhet të regjistrohen, të kenë patentë shofer valid ose vërtetim për vozitje dhe duhet të shënohen me targa të regjistrimit. Mosrespektimi i kësaj dispozite ligjore sanksionohet me dënim në të holla prej 500 eurove në kundërvlerë denari.

ENERGJIA ELEKTRIKE

"EVN Maqedoni" zgjidhet për furnizues universal

Shkup, 27 shkurt - EVN Maqedoni zgjidhet ofertues më i mirë në paraqitjen elektronike publike në tenderin për zgjedhjen e Furnizuesit universal me energji elektrike. EVN Maqedoni ka ofruar diferencë më të ulët prej 11.5 për qind. Në ndërkohë, asnjë prej tetë furnizuesve aktivë të energjisë elektrike, prej gjithsej 30-të në tregun e energjisë elektrike, nuk ka ofruar pako për amvisëritë, edhe pse 1 janari i këtij viti ka liberalizim të tërësisht të tregut të energjisë elektrike. Kryetari i Komisionit Rregullator të Energjetikës (KRE), Marko Bislimovski, tha se mosinteresimi i furnizuesve vjen si pasojë e çmimit të lartë të energjisë elektrike në tregun vendor dhe në atë rajonal.

"Për fat të keq, në periudhën e kaluar furnizuesit, para së gjithash për shkak të çmimeve të larta të energjisë elektrike të tregut në vend, por edhe në atë rajonal, ash-

tu siç lëviz çmimi nga 70 deri në 80 euro për megavat -orë, ende nuk kanë interes që t'i ofrojnë shërbimet e tyre familjeve, por me Ligjin e ri për energjetikë edhe me aktet nënligjore në pjesën e energjisë elektrike që i solli KRE-ja familjeve të cilat janë ende në tregun rregullator i garantohet çmimi aktual", thekson Bislimovski. Pres, theksoi ai, që në mars dhe në prill, në periudhën e ujërave të mëdha, që është karakteristike për rajon tonë, kur të fillojë pranvera dhe shkrirja e dëborës, të ketë edhe ulje të caktuar të çmimit në tregun rregullator për shkak të prodhimit më të madh të energjisë elektrike. Kjo, sipas Bislimovskit, nënkupton që të ketë ofertë më të madhe, ndërsa pret edhe kërkesa të vijë duke u ulur, para së gjithash për shkak të përfundimit të sezonit të ngrohjes.

Ai saktëson se në dy muajt e parë të vitit janë ofruar dhe janë

lidhur marrëveshje për furnizim me një numër të madh të konsumatorëve të vegjël të cilët deri në liberalizim kanë shfrytëzuar energji industriale. "Tregu i energjisë elektrike tërësisht u liberalizua nga 1 janari i këtij viti dhe sipas njohurive tona, një pjesë e madhe e furnizuesve aktivë në janar dhe në shkurt kanë lidhur marrëveshje me konsumatorët që kanë paguar të ashtuquajturën energji industriale", tha Bislimovski. Sipas tij bëhet fjalë për konsumatorë të vegjël komercialë - dyqane të vogla të cilave tani i janë ulur për 20-30 për qind shpenzimet për energjinë elektrike. "Deri tani në tregun rregullator paguhen rreth 150 euro për megavat-orë, ndërsa tani me energjinë e blerë elektrike dhe me shpenzimet e përfshira për rrjetëzime shpenzimet e tyre janë ulur për 20-30 për qind, tha Bislimovski. (F.P)

PREZANTOHET PROJEKTI “DREJT ARSIMI PAQËSOR”

NXËNËSIT, PROMOTOR TË IDEVE ZHVILLIMORE

Arsimi paqësor i përfshin nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme dhe ky projekt do të vazhdojë edhe në të ardhmen, me qëllim të inkurajohen nxënësit si ndërtues individual të kulturës për paqe dhe në përgjithësi të rritet përkushtimi ndaj paqes në një komunitet apo shoqëri



Koha Delvina KËRLUKU

Shkup, 27 shkurt - Arsimit Paqësor ose arsimit për paqe, sot, në kohën e krizës globale dhe pasigurisë, ngjall interes gjithnjë më të madh. Ai promovon njohuri, shkathtësi dhe qëndrime që mund t'ju ndihmojnë njerëzve që ti tejkalojnë konfliktet në mënyrë paqësore, të ndërtojë shoqëri me të drejta, dhe të krijojë kushte për paqe pozitive. Vlerat kryesore të arsimit paqësor,

janë themeli i ndryshimit të dëshiruar shoqëror, përfshi respektimin e të drejtave të njeriut dhe ndërtimin e besimit. Këto ishin thekse nga prezantimi i projektit “Drejt arsimit paqësor” organizuar nga Ambasada e Parë e Fëmijëve në Botë “Megjashi”, në bashkëpunim me Byronë e Arsimit në Maqedoni. Ana Bitoljanu, anëtare e ekipit të Arsimit paqësor, nga “Megjashi” tha se programi për Arsim Paqësor

është realizuar në shumë shkolla të Maqedonisë që nga viti 2011. Qëllimi kryesor është zvogëlimi i dhunës nëpër shkolla dhe ndërtimi i kulturës së paqes.

Me fëmijët duhet të bisedohet, shtoi ajo, në çfarëdo temë dhe nëse nuk ka komunikim atëherë nuk mund të arrijmë deri te mirëkuptimi dhe bashkëpunimi paqësor.

Fatmire Ajdari, nga “Megjashi” tha se dhunë ndërmjet bashkëmo-

shatarëve padyshim që ka në shkolla dhe qëllimi është që përmes programeve dhe trajnimeve të nxënësve të ulet dhunën dhe të rritet kultura e paqes në shkolla. Ajo porositi që të ketë mirëkuptim dhe paqe në mes të nxënësve. Qëllimi i programeve të këtuja, sipas saj, është vendosja e paqes dhe e tolerancës nëpër shkolla, me përdorimin e teknikave për zvogëlimin e konflikteve si dhe ngritja e

vetëdijes për zvogëlimin e dhunës nëpër shkolla.

Me edukimin dhe trajnimin, nxënësve iu mundësohet që t'i njohë edhe rreziqet ekzistuese dhe të mundshme, që të stërvitet për veprimet në rast të kërcënimeve, që të veprojnë në mënyrë të sigurt dhe konstruktive në situatat e dhëna, që të arrijë njohuri, qëndrime dhe të zhvillojë kulturë të mbrojtjes, paqes dhe tolerancës, gjegjësisht të veprojnë si individ paqësor dhe integruar në proceset demokratike në Maqedoni.

Përfaqësues të shkollave thanë se projekti “Arsimi paqësor” u ofron përkrahje të konsiderueshme sa u takon temave që lidhen me paqen, respektimin e të drejtave të njeriut, zgjidhjen paqësore të konflikteve, bulizmin, ndërmjetësimin në shkollë, rritjen e vetëdijes ekologjike, etj. Arsimit paqësor i përfshin nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme dhe ky projekt do të vazhdojë edhe në të ardhmen, me qëllim të inkurajohen nxënësit si ndërtues individual të kulturës për paqe dhe në përgjithësi të rritet përkushtimi ndaj paqes në një komunitet apo shoqëri.

Publicitet

KOMUNA E ÇAIRIT

KRYETARI I KOMUNËS

Nr. _____ prej _____

Kryetari i Komunës së Çairit, Shkup, gjatë shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga, **Hajrulla Mustafa** rr. “Rifat Burxheviq” nr. 42, nga Shkupi e dorëzuar me numër 08-9920 të datës 01.09.2011, në bazë të nenit 21, paragrafi (11), paragrafi (12), të Ligjit për trajtimin e objekteve të ndërtuara në mënyrë të paligjshme (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 23/11, nr. 54/11, nr. 155/12, nr. 53/13, nr. 72/13, 44/14, 115/14, nr.199/14, nr. 124/15, 129/15, 271/15, 31/16 dhe 190/17) e në bazë të nenit 205, paragrafi 1 dhe neni 209 nga Ligji për procedurë të përgjithshme juridike (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 38/2005 110/08 dhe nr.51/2011), e miraton këtë:

AKTIVENDIM
për përcaktimin e statusit juridik të objektit të paligjshëm

1. Përcaktohet statusi juridik i objektit të paligjshëm:
shtëpi banimi
që gjendet, rr. “Dizhonska 7” nr. 25, Shkup, PK 2377/16, KK Çair; e regjistruar në Fletë pronësinë nr. 95270 dhe nr. PK 2377/6, KK Çair; e regjistruar në Fletë pronësinë nr. 94275, objekt i cili është shënuar si:
numri i objektit 1, Përdhese, hyrja 1, banesa 1, dedikimi i pjesës së veçantë të objektit: **banim** sipërfaqja e brendshme 81m².
numri i objektit 1, Përdhese, hyrja 1, banesa 1, dedikimi i pjesës së veçantë të objektit: **sipërfaqe ndihmëse** sipërfaqja e brendshme 7 m².
numri i objektit 1, Nënkulm, hyrja 1, banesa 1, dedikimi i pjesës së veçantë të objektit: **banim** sipërfaqja e brendshme 82 m².
numri i objektit 1, Nënkulm, hyrja 1, banesa 1, dedikimi i pjesës së veçantë të objektit: **sipërfaqe ndihmëse** sipërfaqja e brendshme 14 m².
numri i objektit 1, Bodrum-1, hyrja 2, banesa 1, dedikimi i pjesës së veçantë të objektit: **bodrum** sipërfaqja e brendshme 37 m².

2. Si bartës i të drejtës të pronësisë së objektit nga pika 1 e dispozitivit të këtij aktvendimi, caktohet, **Hajrulla Mustafa** rr. “Rifat Burxheviq” nr. 42, nga Shkupi, me letërnjoftimi nr. G0202748.

3. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Elaborasi gjeodezik për përcaktimin e gjendjes faktike të objektit të paligjshëm nr. 7-295-3/16 oq 23.02.2017, i përpiluar nga “GEO-URBAN” SHPK-Shkup.

4. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi i njëjti paraqet bazë juridike për regjistrimin e të drejtës të pronësisë së objektit në librin publik për regjistrimin e të drejtave të patundshmeve ndërsa gjatë regjistrimit shënohet se objekti ka fituar status juridik në pajtueshmëri me Ligjin për trajtimin e objekteve të ndërtuara në mënyrë të paligjshme.

Arsyetim

Kërkuesi **Hajrulla Mustafa** rr. “Rifat Burxheviq” nr. 42, nga Shkupi, e dorëzuar me numër 08-9920 të datës 01.09.2011, për përcaktimin e statusit juridik të objektit paligjshëm: **shtëpi banimi** që gjendet, rr. “Dizhonska 7” nr. 25, Shkup, PK 2377/16, KK Çair; e regjistruar në Fletë pronësinë nr. 95270 dhe nr. PK 2377/6, KK Çair; e regjistruar në Fletë pronësinë nr. 94275, me gjithsej sipërfaqe të brendshme 221 m²

Kërkuesi me kërkesën parashtror:
- Elaborasi gjeodezik për përcaktimin e gjendjes faktike të objektit të paligjshëm nr. 7-295-3/16 oq 23.02.2017, i përpiluar nga “GEO-URBAN” SHPK-Shkup.
- Fotokopje e letërnjoftimit
- Fletë pronësie nr. 95270 të datës 23.02.2017
- Fletë pronësie nr. 94275 të datës 23.02.2017
- Akt noteri – Deklaratë nr. PLA 12/217/12 në Shkup të datës 22.10.2012.
- Akt noteri – Deklaratë nr. PLA 83/2019 në Shkup të datës 14.01.2019.
- Vërtetim për pasqyrë historike të regjistrimeve të realizuara për PK 2377/6 KK Çair të datës 19.12.2018 me nr. 1107-11387/2018
- Vërtetim për pasqyrë historike të regjistrimeve të realizuara për PK 2377/16 KK Çair të datës 19.12.2018 me nr. 1107-11391/2018

Gjatë procedurës janë sjellë këto:
- Procesverbal nga këqyrja në vend me nr. 08-9920 të datës 19.09.2013.
- Pëlqim urbanistik me nr. 08-9920 të datës 14.02.2019.
- Konkluzion për pagim të kompensimit nr. 08-9920 të datës 19.02.2019.

Toka në të cilën është ndërtuar objektit është në pronësi për PK 2377/16 KK Çair në emër Levajkovski Dragi 83/2000 pjesë, Levajkovski Dushko 83/2000 pjesë, Milloshева Jelica 250/2000 pjesë, Mitrovic Dançe 83/2000 pjesë, Todorovska Arseno 84/2000 pjesë, Todorovska Dobrinka 83/2000 pjesë, Todorovska Mirjana 84/2000 pjesë, Todorovski Bllagoja 250/2000 pjesë, Todorovski Sasho 84/2000 pjesë, Todorovski Stefanço 250/2000 pjesë, Todorovski Trajçe 83/2000 pjesë, Todorovski Cvetan 250/2000 pjesë, Unkovska Elizabeta 83/2000 pjesë, Asenço Todorovski 250/2000 pjesë, regjistruar në fletë pronësie nr. 95240 dhe në pronësi për PK 2377/6 KK Çair në emër të Levajkovski Dragi 1/24 pjesë, Levajkovski Dushko 1/24 pjesë, Milloshева Jelica 3/24 pjesë, Todorovska Arseno 1/24 pjesë, Todorovska Dobrinka 1/24 pjesë, Todorovska Mirjana 1/24 pjesë, Todorovski Anto Asenço 3/24 pjesë, Todorovski Bllagoja 3/24 pjesë, Todorovski Sasho 1/24 pjesë, Todorovski Stefanço 3/24 pjesë, Todorovski Trajçe 1/24 pjesë, Todorovski Cvetan 3/24 pjesë, Unkovska Elizabeta 1/24 pjesë, Mitrovic Dançe 1/24, të regjistruar në Fletë pronësinë nr. 94275.

Dedikimi i objektit të paligjshëm është i banimit, ndërsa në pajtim me dokumentacionin e planit urbanistik në fuqi në një pjesë të PK 2377/16 dhe PK 2377/6 KK Çair parashihet infrastrukturë rrugore.

Gjatë përbushjes së kushtit nga neni 12 paragrafi (1) alineja 7, për objekte të ndërtuara në mënyrë të paligjshme të ndërtuar në truall në të cilin në pajtim me dokumentacionin e planit urbanistik në fuqi është paraparë ndërtimi i infrastrukturës rrugore zbatohen vetëm dispozitat nga standardet nga neni 19 i Ligjit për trajtimin e objekteve të ndërtuara në mënyrë të paligjshme me të cilën përcaktohet objekti a është tërësi ndërtimore dhe funksionale, a është në rënie dhe a ka qasje deri te objekti, ndërsa këto objekte **NUK përpunohen** në dokumentacionin e planit urbanistik.

Kryetari i Komunës së Çairit, pas shqyrtimit të dokumentacionit të parashtruar, realizimin e këqyrjes në vend, këqyrjen në pajtueshmërinë urbanistike, konstaton se janë përbushur kushtet për miratimin e aktvendimit për përcaktimin e statusit juridik të objektit të paligjshëm.

Në bazë të asaj që u theksua më lart, u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

UDHËZIM PËR KËSHILLË JURIDIKE: Kundër Aktvendimit të Kryetarit të Komunës së Çairit për përcaktimin e statusit juridik të objektit të paligjshëm dhe për refuzimin e kërkesës për përcaktimin e statusit juridik të objektit të paligjshëm, mund të dorëzohet ankesë në afat prej 15 dite nga dita e pranimit të aktvendimit, deri te organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga lëmi i rregullimit të hapësirës. Ankesa taksohet me taksë administrative në shumë prej 250,00 denarëve.

Dorëzuar deri te:
- Kërkuesi
- Arkivi
Miralib - E.A.
Plehtiro - S.K.

Kryetar
Visar Ganiu

KOMUNA E GOSTIVARIT

www.gostivari.gov.mk
info@gostivari.gov.mk
tel. +389 (0) 42 213 511
fax. +389 (0) 42 214 406

Nr. 13-1533/80
27.02.2019
Gostivar

Në bazë të nenit 24 alineja 11 nga Ligji për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gaz. zyrtare e RM nr. 51/05, 137/07, 91/09, 124/10, 18/11, 53/11, 144/12, 55/13, 163/13 dhe 42/14), Kryetari i Komunës së Gostivarit e solli këtë:

L A J M Ë R I M

Lajmërohen qytetarët dhe personat juridikë të përfshirë në hapësirën e Projekt **Planit Detal Urbanistik të Bllok 32, Njësia Urbane ”G”** - Komuna e Gostivarit, se Kryetari i Komunës së Gostivarit solli Aktvendim për organizim e përsëritur të:

PREZANTIMIT PUBLIK DHE ANKETËS PUBLIKE

Rreth Projekt **Planit Detal Urbanistik të Bllok 32, Njësia Urbane ”G”** - Komuna e Gostivarit, që kufizohet në mes rrugëve:

- Nga ana veriore me rrugën “101”,
- Nga ana jugore me rrugën e re të projektuar servitore “Se 14” dhe rrugën banesore “Bn 5”,
- Nga ana lindore me rrugën e re të projektuar banesore “Bn 5” dhe rrugën servitore “Se 3”, dhe
- Nga ana perëndimore me shtegun Hekurudhor “Kërçovë-Gostivar-Shkup”.

të vërtetuar nga Këshilli Komunal i Gostivarit në mbledhjen e mbajtur më datë 22.12.2014.

Prezantimi publik do të mbahet në mjediset e Komunës së Gostivarit, respektivisht në sallën e Këshillit Komunal të Gostivarit më datë **05.03.2019 (e martë) në ora 12:00.**

Projekt **Plan Detal Urbanistik të Bllok 32, Njësia Urbane ”G”** – Komuna e Gostivarit, do të ekspozohet në lokalet e Komunës së Gostivarit në afat prej 10 ditë pune edhe atë nga **05.03.2019 deri 18.03.2019**, çdo ditë pune prej orës **08:00-16:00.**

Fletët anketuese gjenden në Qendrën për Shërbime Publike të Komunës së Gostivarit, kurse në afatin e paraparë personat e interesuar juridikë dhe fizikë nga zona konkrete të përfshirë me Planin, mund të parashtrorjnë vërejtje me shkrim në fletët anketuese.

Kryetari i Komunës
Arben Taravari

Nga kjo njësi kanë njoftuar se rritje të numrit të bujqve është shënuar nga viti 2006 deri në vitin 2010, kurse trend i zvogëlimit të bujqve apo atyre që kanë qenë të interesuar për të shfrytëzuar subvencione ka rënë gjatë periudhës prej viti 2015 deri në vitin 2017 dhe kjo për shkak të situatës së përgjithshme politike në vend

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 27 shkurt - Kohëve të fundit është rritur dukshëm interesimi i bujqve tetovarë, sidomos të atyre që kanë nevojë për makineri bujqësore gjegjësisht për të marrë subvencione nga shteti. Rritja vërehet sidomos pas publikimeve të programeve për përkrahjen e bujqve të rinj me makineri bujqësore në vlerë prej 10 mijë euro. Këtë e kanë konfirmuar edhe në Njësinë rajonale të Ministrisë së Bujqësisë në Tetovë, prej nga theksojnë se çdo ditë ka bujq që për herë të parë regjistrohen. Sipas tyre, rritja është vërejtur gjatë vitit të kaluar dhe në fillim të këtij viti. Interesimi më i lartë po ashtu i dedikohet edhe disa ndryshimeve që janë bërë për sa i përket moshës së bujqve. "Rritja e bujqve gjatë viti 2018 dhe në fillim të këtij viti është e evidente në krahasim me dy vitet e kaluara. Duke patur parasysh se në të kaluarën ku mosha ka qenë fiks prej 18 deri në moshën 40 vjeçare, buj-

NGA 15 MARS APLIKIMI PËR SUBVENCIONE

RRITET INTERESIMI PËR SUBVENCIONE NË TETOVË



qit nuk kanë mundur të aplikojnë nëse kanë qenë të moshës 38 vjeçar. Tash ky kusht është larguar, dhe personat deri në moshën 40 vjeçare mund të aplikojnë. Prandaj edhe ka një rritje të interesimit në këtë drejtim. Kemi të bëjmë me subvencionet nga IPA fondet dhe nga Zhvillimi rural", deklaroi drejtori i Njësisë rajonale të Ministrisë së Bujqësisë në Tetovë, Afrim Sejrani. Nga kjo njësi kanë njoftuar se rritja e numrit të bujqve është shënuar nga viti 2006 deri në vitin 2010. Kurse trendi i zvogëlimit të bujqve, apo atyre që kanë qenë të interesuar për të shfrytëzuar subvencione ka rënë gjatë periudhës prej viti 2015 deri në vitin 2017, dhe kjo për shkak të situatës së përgjithshme politike në vend. Regjistrimi i bujqve kryhet në këtë njësi rajonale dhe bujqit me vendi-

min e marrë pastaj aplikojnë nëpër agjenci. Deri më 15 mars është regjistrimi i bujqve ndërsa më 16 mars fillon edhe aplikimi për subvencione. Por nga kjo njësi kanë njoftuar se do të kërkohet që afati përfundimtar që është 31 maj për paraqitje të subvencioneve të vazhdohet edhe më tej për shkak të angazhimeve të bujqve pikërisht në atë periudhë. "Zakonisht më 15 mars fillon aplikimi për subvencione dhe zgjatë deri në fund të muajit maj. Ne zakonisht parashtrajmë kërkesa që të vazhdohet afati për paraqitjen e subvencioneve për shkak të angazhimeve të bujqve në atë kohë. Ne vlerësojmë se bujqit pikërisht në kohën kur merren me të mbjellat e tyre duhet që të vijë dhe të paraqesin subvencionet, prandaj kërkojmë që ata të kenë më shumë hapësirë,

por kjo do të varet nga Qeveria" tha Sejrani. Ai ka theksuar se deri më 15 mars qytetarët duhet që të rregullojnë dokumentacionet e tyre nëse eventualisht kanë ndryshime në pronë apo ndryshime tjera që më pas mund të aplikojnë më lehtë. Në Tetovë, kryesisht më shumë subvencione marrin bujqit për qumësht, kopshtari, pemëtari, blegtori për tokë të mbjellur dhe kështu me radhë. Sipas të dhënave, rreth 1600 persona apo bujq tetovarë marrin subvencione për qumësht, kurse numri i përgjithshëm i bujqve në Tetovë që marrin subvencione është rreth 5 mijë. Numri i përgjithshëm i bujqve në Tetovë të regjistruar në regjistrat e kësaj njësie është 10 mijë. Vetëm brenda muajit shkurt janë hapur mbi 40 regjistra të rinj respektivisht janë regjistruar bujq të rinj.

KRONIKË

Burg për personin që shtiu me armë

Sektori i Punëve të Brendshme Tetovë, ka iniciuar padi penale kundër 23 vjeçarit R.A. nga fshati Llërcë, për shkak të bazave të dyshimit se ka kryer vepër penale përpunim i paautorizuar, mbajtje dhe tregti me armë ose materie shpërthyes. I denoncuar R.A. dyshohet se në afërsi të xhamisë së fshatit Llërcë, ka shtënë me armë zjarri, të cilën e ka poseduar pa dokumente, ku është arrestuar dhe është mbajtur në stacionin policor Tetovë. Gjykatësi në procedurë paraprake, i ka caktuar masë paraburgimi në afat prej 30 ditësh, dhe R.A. është dërguar për vuajtje të dënimit në Shkup.

Arrestohet një shtetas i Shqipërisë pa dokumente

Të martën rreth orës 16.00, në rrugën magjistrale Gostivar-Kërçovë, në dalje të Gostivarit, është arrestuar 38 vjeçari M.D., shtetas i Shqipërisë, i cili nuk ka poseduar asnjë dokument identifikimi dhe në mënyrë ilegale ka qëndruar në vend. Pas arrestimit, M.D. është mbajtur në stacionin policor Gostivar për procedurë të mëtejme.

Plaçkitet 70 vjeçari nga Gostivari

70 vjeçari O.R. nga Gostivari, të martën ka denoncuar se rreth orës 09 e 30 minuta, në rrugën "Nikolla Parapunov" në Gostivar, dy persona të cilët paraprakisht i kanë kërkuar dhe të njëjtëve u ka dhënë një shumë të caktuar të parave, me forcë ia kanë marrë portofolin dhe kanë ikur. Janë duke u marrë masa për zbardhjen e rastit.

Zjarr afër Zonës ekonomike në Tetovë

Të martën rreth orës 17.00, në atarin e fshatit Saraqinë të Tetovës, në afërsi të Zonës së lirë ekonomike është përhapur zjarr në sipërfaqe prej 5000 metra katrorë, ku është djegur kullosë e thatë dhe fidanë të vishnjave.

Me intervenim të zjarrfikësve të Tetovës, zjarri shpejtë është lokalizuar në tërësi. Nuk ka patur persona të lënduar, kurse është kryer hetim në vendin e ngjarjes. (U.H)

MPB: Po keqpërdoren raste të vjetra me persona të zhdukur

Shkup, 27 shkurt - Ministria e Punëve të Brendshme i demantoi informatat që dy ditët e fundit janë shpërndarë në rrjetet sociale se është zhdukur Lluca Bozhinovski. "Po keqpërdoret rasti nga viti 2017, kur personi është raportuar se është zhdukur dhe menjëherë është gjetur. Në të vërtetë, Lluca Bozhinovski është paraqitur i zhdukur më 03.08.2017 në SP Cjorçe Petrov dhe menjëherë është gjetur, respektivisht është ndërprerë kërkimi pas tij më 04.08.2017. Apelojmë deri te qytetarët që të mos bien pre në lajmet e tilla të rreme, me të cilat disa individë dëshirojnë të shkaktojnë dëmtim dhe pasiguri", theksojnë nga MPB-ja. Gënjeshtrat dhe dezinformatat e tilla, sipas MPB-së, bëhen me qëllim që të shkaktojnë dëmtim te qytetarët.

Mungesa e investimeve, Sugarevski thotë se nuk është sezon ndërtimi

Shkup, 27 shkurt - Ministri i Transportit dhe Lidhjeve, Goran Sugareski pret të realizohen investimet e planifikuara kapitale për sivjet edhe krahas përqindjes së ulët të realizimit të tyre në muajin e kaluar, që siç deklaroi ai, ka të bëjë në atë se nuk është sezon ndërtimi, ndërsa punohet në tenderë për projektet e parapara. "Tani nuk është sezon ndërtimi, një pjesë e punëve që duhet të bëhen janë në fazën e tenderimit, ashtu që pritjet tona janë se in-

vestimet kapitale do të jenë shumë më të larta nga viti i kaluar", deklaroi Sugareski. Sipas tij, do të realizohet edhe paralajmërimi se viti do të jetë ekonomik dhe se investimet e planifikuara kapitale buxhetore do të jenë me vlerë më të madhe nga viti i kaluar. Për 15 ditë me fillimin e sezonit të ndërtimit fillon rikonstruktimi i 40 rrugëve, për çfarë është përgatitur dokumentacioni i plotë. "Absolutisht do të kemi vit ekonomik dhe nëse i shohim të

gjithë treguesit jo vetëm të mjeteve buxhetore që janë paraparë për investime kapitale, por edhe jashtë buxhetit, siç është për shembull Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore që për momentin ka 300 për qind më tepër mjete në krahasim me tremujorin e parë të vitit të kaluar, jam i bindur se të gjitha numrat nga ajo që Qeveria i ka planifikuar në buxhet, gjegjësisht investimet kapitale buxhetore, do të realizohet", tha Sugareski.

Vdekjet me rritje më të madhe se lindjet

Shkup, 27 shkurt - Numri i foshnjave të sapolindura në tremujorin e katërt prej vitit 2018, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit paraprak, është rritur për 5.0 për qind dhe arrin 5597 foshnja të sapolindura, njoftoi Enti Shtetëror i Stati-

stikës. Rritje për 9.1 për qind shënon edhe numri i personave të vdekur dhe arrin 5405, ndërsa prej tyre 48 janë foshnja të vdekura. Rritja natyrore arrin 192, që nënkupton se për po kaç persona është më i madh numri i fëmijëve

të sapolindur nga numri i personave të vdekur. Në kuartalin e fundit vjet janë lidhur 3 261 martesë, që është për 6,4 për qind më shumë se e njëjta periudhë në vitin 2017. Në tetor, nëntor dhe dhjetor të vitit të kaluar ka pasur 442 shkurorëzime.

Liberalët fals!



Nga
Nazim RASHIDI

"M Minoriteti i padukshëm i Greqisë - Slavët Maqedonas" ose në origjinal "Greece's invisible minority - the Macedonian Slavs" është një artikull i botuar nga BBC, që po përhapet shumë në rrjetet sociale. Sigurisht ka një ngazëllim nga maqedonasit, sidomos ata që janë mbështetës të Marrëveshjes së Prespës, sepse teksti vjen si rrjedhojë pikërisht e kësaj marrëveshjeje, por shpjegon dhe historinë, ku autori tregon për prezencën e njerëzve në Greqi që flasin një gjuhë tjetër përveç asaj greke.

Teksti gjithashtu nëpërmjet një 92 vjeçari, z. Fokas tregon edhe represionin, ndalesën për të përdorur gjuhën në periudha të ndryshme historike, madje dhe një sekuencë ku autoritetet kanë shkuar edhe në varrime për të parë se në çfarë gjuhe bëhen edhe vajtimet. Sigurisht rrëfime të njohura për shqiptarët. Gjithsesi, për mos të përshkruar tekstin plotësisht, ai flet edhe për arrestime e vuajtje dënimesh me burg, humbje jetësh, fate njerëzish të vështira, që kujtojnë sagat ballkanike, por edhe kontekstin e sotëm me Marrëveshjen e Prespës. Por si në çdo rrëfim ballkanik, teksti ka shkaktuar reagime. Autoritetet greke kanë akuzuar për "falsifikim të historisë" nga ana e BBC-së, etj... etj... si këto që ne i kemi të njohura. Por ajo që dua të vë në dukje me këtë shpjegim është efekti i një shkrimi për "të fshehurit" në Greqi dhe gëzimi i madh për artikullin në Maqedoni. Pashë te njerëzit satisfaksionin e mirënjohjes, e një dëshmie për prezencën, por edhe një krenarie për të vërtetën. Sepse shumë njerëz që shpërndanë artikullin këtë thoshin: "E shihni, kemi pasur të drejtë", për disa gjëra që i kemi thënë.

Por paralelisht me këtë artikull, muri i Facebook-ut tim u mbush me një manifestim kulturor "Zlatna bubamara" në të cilin vlerësohen arritjet në fusha të ndryshme kulturore e sportive. Sigurisht duke qenë se duam të jemi një shoqëri, hapa për të parë se çka ka ndodhur dhe kush është vlerësuar. Normal, si përherë kisha habi. A po edhe një diçka, ky manifestim është privat. Pra organizatori bën dhe nderon kë të dojë dhe për këtë ka të drejtë. Por efektet shoqërore ama sërisht i lëshon, dhe unë për këtë flas. Ku ishte habia? Ndër evente, shfaqje, koncerte, emra, arritje që ishin vlerësuar kishte veç evente, shfaqje, koncerte, arritje që i njihnin e kishin parë veç maqedonasit. Tani unë e di se shoqëria jonë është relativisht e ndarë. Dhe thashë, ky event është privat, por nëse

pretendohet të vlerësohen efektet që janë lënë në shoqëri, mund të kishte një përpjekje më shumë. Për shembull kështu në mend më vjen shfaqja "Gratë", e Qëndrim Rijanit, që nuk la festival pa u vlerësuar. Interpretimi befases dhe tejet i arrirë i Vjollca Bekteshi Hamitit në shfaqjen e fundit "Duet për një". Apo përvjetori i 30 i "Elita 5", apo shumë e shumë arritje e vlerësime që më vjen keq që s'po i përmend tani. Dhe kjo mospërmendje dhe mosdije e këtyre arritjeve mbase dhe nuk do të më bënte edhe aq përshtypje nëse disa njerëz nuk do të kishin përhapur në rrjetet sociale edhe artikullin për minoritetin e fshehur në Greqi edhe lajmet për vlerësimet në manifestimin "Zlatna Bubamara" që ka dhe prapashitesën "na popullarnosta", pra të popullaritetit. Por që nuk njeh dhe nuk sheh popullarët e një pjesë të madhe e të rëndësishme të shoqërisë ku jetojmë. Këto ditë për shembull është "hit" Talat Xhaferi me seancën e diskutueshme rreth heqjes së imunitetit të Trajko Veljanovskit. Po mirë, për shembull, këta individë kur shohin këta politikanët shqiptarë, debatet, ministrat, etj. nuk shtrojnë pyetje apo dhe kuriozitet se kush janë popullorët e këtyre "tjerëve"? Sigurisht që përgjigja është "jo". Sepse rezultati është i qartë. Megjithatë, ribëhet

pyetja sërisht natyrshëm për të disatën herë: Si mundet mos të kesh asnjë kuriozitet për të marrë vesh se çfarë krijojnë dhe prodhojnë të tjerët?

Në manifestimin në fjalë, kishte emra të them "jo maqedonas". Sigurisht jam i bindur që ishin atje me meritë dhe nuk i duhet hequr asnjë vlerësim, por ka një gjë. Janë persona e ngjarje që janë shfaqur brenda gardhit të "tjetrit". Asnjë emër apo vlerësim nuk është bërë për krijime që kanë ndodhur jashtë terrenit tipik etnik. Dhe kjo nuk është në rregull për një shoqëri që pretendon të ndërtohet si një me gjithë dallimet që ka. Pastaj është shumë kontradiktore me vetë ata njerëz që nga një anë vlerësojnë artikullin e BBC-së për të "fshehurit" dhe nga ana tjetër fshehin të tjerët apo nuk bëjnë asgjë për të zbuluar "të fshehurit" brenda kësaj shoqërie. E dini si, mbase këta "të tjerë" edhe nuk kanë nevojë të zbulohen nga një pjesë e shoqërisë që është tejet e vetëfokusuar. Për shembull, shqiptarët kanë dinamikë të tjera në rajon. Artistët shqiptarë në Maqedoni mendojnë me mendjen e një tregu më të madh. Nëse ke sukses, je popullor ndër miliona njerëz. Për disa mbase as që është sfidë të njihen tek maqedonasit kur theksohet aq shumë ky vetëfokusim. Për shembull aktori

Do të vazhdojë kjo shoqëri të fshehtë njëri-tjetrit dhe do të vazhdojmë të lodhemi ende duke zbuluar njëri-tjetrit. Sinqerisht është e tepërt. Aq më shumë lodhës është liberalizmi fals. Mbase liberalë fallo ko nga të dyja anët. Por sërisht, sado i njëanshëm të tingëllojë, vazhdimi të fshihen "të fshehurit" konstant, ndërkohë gjithçka që ndodh rreth dhe brenda kësaj shoqërie ka aq shumë prezencë të njëri-tjetrit, tregon se roli i strucit bëhet me qëllim. Dhe kjo nuk mund të jetë diçka OK!



Xhevdet Jashari, vërtet është pjesë e filmit "Gospod postoi, imeto i e Petrunija" (Zoti ekziston, emrin e ka Petrunia), që pati sukses në Berlinale, një nga festivalet më të njohur në botë, por fama e tij ama në kontekste rajonale kalon çdo aktor maqedonas. Dhe modeli i suksesit të një shqiptari, kur sheh vetëfokusimin maqedonas, mbase as që merr parasysht Maqedoninë, si një. Por këtu është problemi. Do të vazhdojë kjo shoqëri të fshehtë njëri-tjetrit dhe do të vazhdojmë të lodhemi ende duke zbuluar njëri-tjetrit. Sinqerisht është e tepërt.

Aq më shumë lodhës është liberalizmi fals. E di shpesh kundër argumenti është se sa shqiptarët i njohin maqedonasit? I njohim. Se ua dimë gjuhën. I vlerësojmë dhe i gëzohemi suksesit, humorit, arritjeve të tyre. Sidomos ato krijime që reflektojnë sendërtimin e përbashkët të kësaj shoqërie. Po mbase liberalë fals ka nga të dyja anët. Por sërisht, sado i njëanshëm të tingëllojë, vazhdimi të fshihen "të fshehurit" konstant, ndërkohë gjithçka që ndodh rreth dhe brenda kësaj shoqërie ka aq shumë prezencë të njëri-tjetrit, tregon se roli i strucit bëhet me qëllim. Dhe kjo nuk mund të jetë diçka OK!

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goe Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovaja lsk.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribimi: "Sloboden Pecat" - rr. Kej 13 Noemvri nr.3/1-238, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e mërkurë, 27 shkurt 2018 | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006

Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjigjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA

E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221

Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhirollogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

Grequisë po i çahet thesi i minoriteteve



Nga
Shaban MURATI

Të vërtetat historike, sado që disa qeveri apo një shtet të mundohen t'i mbyllë e t'i varrosë për dekada e shekuj, vjen një ditë dhe ato shpërthejnë kur nuk e pret, sepse historia i ka pjekur kushtet për të dalë në dritë. Ndaj shkaktoi një tërmet politik, publik dhe historik reportazhi profesional i prestigjiozes britanike BBC, i transmetuar në datën 24 shkurt 2019, me titullin: "Minoriteti i padukshëm i Grequisë-maqedonasit sllavë". BBC, të cilën e dëgjon dhe e beson e gjithë bota, shprehet: "Duke ratifikuar një marrëveshje me Republikën e Maqedonisë së Veriut të sapoemërtuar, Greqia në mënyrë të nënkuptuar njohu ekzistencën e gjuhës dhe të etnicitetit maqedonas. Ajo ka përgënjeshtuar ekzistencën e minoritetit të saj maqedonas për dekada. A do të ndryshojë diçka tani?". Pra BBC nuk e shtron çështjen e ekzistencës së minoritetit maqedonas në Greqi, por shtron çështjen a do të ndryshojë Greqia qëndrimin e saj mohues të deritanishëm për minoritetet. BBC citon historianin grek Leonidas Embiricos që vlerëson se numri i maqedonasve sllavë, që jetojnë në rajonin grek të quajtur "Maqedoni" është mbi 100 mijë vetë.

Alarmi politik, publik dhe shtetëror grek erdhi për shumë arsye. Së pari, sepse u komprometua në arenën ndërkombëtare blafi zyrtar i mosekzistencës së minoriteteve në Greqi. Së dyti, sepse është një realitet historik dhe kontemporan, që Greqia duhet ta përballojë dhe ta pranojë dhe të sillt si një shtet vërtet europian dhe demokratik. Është e kuptueshme se pas një politike të stazionuar zyrtare dhe kombëtare të mosnjohjes dhe të represionit e të asimilimit të minoriteteve të huaja në Greqi është e vështirë të merret kthesa dhe të dalë përpara botës si një demokraci me hije të zeza. Ndaj siç shkruante "Protothema" në 25 shkurt, "raporti i BBC shpërtheu një seri të reaksioneve serioze politike në Greqi".

Raporti e vendosi qeverinë e kryeministrit Aleksis Cipras në një pozitë të vështirë përballë opozitës dhe qarqeve nacionaliste greke, por edhe përballë opinionit publik ndërkombëtar. Një zyrtar i lartë i qeverisë i deklaroi agjencisë greke të lajmeve "ANA" se raporti ka pikëpamje të shtrembëruar dhe të gabuar, dhe njoftoi se qeveria greke po planifikon t'i dërgojë një letër BBC me qëllim që të përgënjeshtrojë pretendimet. Partia kryesore e



Do apo nuk do, Greqia po përballlet me çështjen e minoritetit turk, maqedonas, shqiptar, etj. Është pozitive që çështja e minoritetit maqedonas në Greqi u bë temë dite e politikës dhe e publikut atje. Thesi i minoriteteve po çahet nga historia dhe procesi i njohjes së botës së qytetëruar me të vërtetat e brendshme të shoqërisë së sotme greke po zhvillohet

opozitës "Demokracia e Re", akuzoi qeverinë se me Marrëveshjen e Prespës ka hapur kutinë e Pandorës për kërkesa dhe pretendime antihistorike ndaj Grequisë. Ambasadori grek në Londër në 25 shkurt i dërgoi një letër proteste BBC, duke i shkruar se çështja e minoritetit maqedonas në Greqi nuk ekziston, formula e njohur qeveritare greke edhe për çështjen çame. Përtej përdorimit dhe keqpërdorimit politik dhe elektoral të ditës, çështja e minoritetit maqedonas në Greqi përbën një të vërtetë dhe një realitet, para të cilit nuk mundet më Athina zyrtare të mbyllë sytë. BBC ka takuar dhe folur me shumë njerëz konkretë, që afishojnë përkatësinë etnike dhe linguistike maqedonase. Ndër të intervistuarit është një jurist i vjetër, që deklaroi se gjuha e tij e nënës është maqedonishtja. Sipas raportit, në vitin 1936 diktatori grek Metaksa ndaloi gjuhën maqedonase dhe detyroi maqedonist-folësit të ndryshojnë emrat e tyre në emra grekë. Deri në vitin 1951 ata janë regjistruar si sllavisht-folës. Por represioni dhe asimilimi bënë të tyren. Realiteti dhe koha kërkojnë që Athina të rishikojë kursin e saj antidemokratik dhe antihistorik të mosnjohjes së minoriteteve. Greqia është përpjekur me të gjitha instrumentet e detyrimit që ta mbajë të mbyllur thesin e minoriteteve. Por tani në shekullin e demokracisë dhe të integriteteve europiane, në shekullin e globalizimit dhe të teknologjisë moderne të informacionit, të internetit e të rrjeteve sociale me shtrirje ndërkombëtare, thesi i minoriteteve ka filluar të çahet dhe



nuk ngjitet dot më. Para 10 vitesh, në 18 shkurt të vitit 2009, në Asamblenë e Përgjithshme të OKB, është shpërndarë një raport i OKB, i hartuar nga ekspertja e pavarur ndërkombëtare e çështjeve të minoriteteve, juristja amerikane Gay McDougall, ku i bëhet thirrje Grequisë të njohë minoritetin turk dhe maqedonas dhe "të përqendrohet në mbrojtjen e të drejtës për vetë-identifikim, për lirinë e shprehjes dhe lirinë e shoqatave për ato komunitete". Athina e neglizhoi raportin e OKB, por rrota e historisë lëviz përpara.

Greqia ka realisht disa minoritete. Kemi një minoritet turk në Greqi dhe kjo ishte një temë e bisedimeve midis presidentit turk Erdogan dhe kryeministrit grek Cipras, gjatë vizitës së këtij të fundit në fillim të shkurtit në Turqi. Kemi një minoritet maqedonas, që ndodhet në Greqi dhe i cili po lëviz prej kohësh fizikisht që të kërkojë të drejtat e tij njerëzore, gjuhësore dhe kulturore. Herët a vonë, është një çështje, që nuk do të mund të shmanget në bisedimet zyrtare midis dy shteteve. Portali grek "in.gr" në 5 dhjetor 2018, pra gjashtë muaj pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Prespës, shkruante se kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev, në konferencë shtypi u kishte deklaruar gazetarëve: "Ju flisni për maqedonasit në Greqi. Le të pyesim veten çfarë kemi bërë për ta në 27 vitet e fundit. Zgjidhja e këtij problemi, që kemi pasur për 27 vjet, ishte një barrë për shpatullat tona. Tani kemi shansin që fëmijët tanë në Greqi të mësojnë gjuhën maqedonase. Deri tani ka qenë një tabu". Pra kryeministri maqedonas evidenton se marrëveshja e Prespës sjell një element të ri trajtimi në çështjen e minoritetit maqedonas në Greqi. Në fakt kjo kërkesë e Shkupit është në përputhje me

normat ndërkombëtare dhe me të drejtën e minoritetit maqedonas në Greqi, që në një të ardhme do të duhet të pranohet në dosjen e marrëdhënieve midis dy shteteve për problemet e pazgjidhura midis tyre.

Marrëveshja e Prespës krijoi një raport të ri midis dy shteteve fqinjë dhe hoqi pengesën e madhe për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në NATO dhe në BE. Është një zhvillim pozitiv, që normalisht duhet të ndikojë edhe në kapërcimin e paragjykimëve të vjetra dhe të mentaliteteve të ngurosurat nacionaliste, që kanë karakterizuar Athinën në qëndrimet mohuese ndaj minoriteteve. Anëtarësimi i Maqedonisë së Veriut në NATO dhe në BE do të bëjë që ky problem të shtrohet akoma më me force në marrëdhëniet midis dy shteteve. Dëshmia e re ndërkombëtare e realitetit të minoritetit maqedonas është në vazhden e procesit të ndërkombëtarizimit të çështjes së minoriteteve në Greqi, proces, që ka nisur prej disa kohësh. Të gjithëve u kujtohet, (me përjashtim të diplomacisë shqiptare), akti i madh historik i Komisionit Europian, kur Komisioneri i lartë i BE për zgjerimin, Johannes Hahn, në shtator të vitit 2016 afishoi në parlamentin europian qëndrimin e Komisionit Europian për ekzistencën e çështjes çame në marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Grequisë.

Është një minoritet shqiptar në Greqi, i cili në periudhën midis dy luftërave botërore, është pranuar zyrtarisht nga qeveritë e Grequisë. Është një minoritet shqiptar, të cilin Greqia zyrtarisht e ka pranuar në Lidhjen e Kombeve. Është vërtetë antihistorike, që presidenti i Grequisë sot, Prokopis Pavlopoulos, e ka shpallur devizë personale fushatën e urrejtjes së tij ndaj minoritetit çam në Greqi. Në një deklaratë në

datën 24 shkurt në ceremoninë e përvjetorit të 106 të pushtimit të Konicës shqiptare nga forcat greke, (ngjarje që në mediat e mjera shqiptare u quajt "ditë e çlirimit" të Konicës), presidenti grek kërcënoi Shqipërinë se nuk do ta lejojë të hyjë në zonën europiane se "nuk ka hedhur tej ato kërkesa të pakonceptueshme të gjoja të drejtave të çamëve kriminelë, bashkëpunëtorë të nazistëve". Pas represionit të jashtëzakonshëm të qeverive greke ndaj popullsisë çame në Greqi, është e kuptueshme se Athina do të këmbëngulë që të mos hapet dosja e çështjes çame.

Tragjizmi në rastin e minoritetit çam në Greqi është se Shqipëria nuk arriti dot asnjëherë të ngrihej as në nivelin e Shkupit në përpjekjet për njohjen statusit të minoritetit çam në Greqi dhe për realizimin e të drejtave të tij të humbura. Sepse është vërtet skandaloz që në vitin 2017 Tirana pranoi që qeveria greke të mos lejonte përfshirjen e çështjes çame në të ashtuquajturën paketë të çështjeve të pazgjidhura në bisedimet midis Shqipërisë dhe Grequisë. Nuk duhet harruar se ky qëndrim i pranueshëm ishte në kundërshtim me vetë programin zyrtar të qeverisë socialiste, të miratuar në Kuvend në shtator të vitit 2013, ku afishohet çështja çame si çështje politike e dosjes së bisedimeve midis dy vendeve.

Historia vonon, por nuk harron për të nxjerrë nga dheu të vërtetat e groposura. Edhe në marrëdhëniet ndërkombëtare ka diçka të ngjashme me arkeologjinë. Të varrosura në dekada e shekuj, dalin në dritë artefaktet e pamohueshme, që dëshmojnë nevojën e korigjimeve dhe të rivendosjes së historisë dhe të së drejtës. Kështu po ndodh e do të ndodhë edhe me çështjen e minoriteteve në Greqi. Do apo nuk do, Greqia po përballlet me çështjen e minoritetit turk, maqedonas, shqiptar, etj. Është pozitive që çështja e minoritetit maqedonas në Greqi u bë temë dite e politikës dhe e publikut atje. Thesi i minoriteteve po çahet nga historia dhe procesi i njohjes së botës së qytetëruar me të vërtetat e brendshme të shoqërisë së sotme greke po zhvillohet. Do të ishte në të mirë të vetë Grequisë pajtimi me këto realitete dhe zbatimi i normave dhe standardeve demokratike për minoritetet, që përmbajnë konventat europiane, dhe që përbëjnë një nga bazat e BE, ku Greqia është anëtare.

(Gazeta DITA)

DIABETI DOBËSON KOCKAT, ÇFARË DUHET TË KONSUMONI PËR TË SHMANGUR PASOJAT

Rreziku i frakturave ishte më i lartë në mesin e njerëzve të prekur nga diabeti i tipit 1. Tek pacientët e diagnostikuar me diabetin e tipit 2, rreziku i frakturave i atribuohet faktorëve që shkojnë përtej nivelit të sheqerit në gjak



Njerëzit e prekur nga diabeti i tipit 1 janë më të rrezikuar nga frakturat, thotë një studim. Studiimi në fjalë u krye në Mbretërinë e Bashkuar. Ekspertët analizuan të dhënat e 3300 personave të prekur nga diabeti i tipit 1 dhe 44,000 të tjerëve të prekur nga diabeti i tipit 2. Ata matën të dhënat e nivelit të sheqerit në gjak të pjesëmarrësve për 2 deri në 3 muaj. Gjetjet treguan se të dy kategoritë e pacientëve ishin të rrezikuar nga frakturat dhe problemet me kockat. Megjithatë, rreziku i frakturave ishte më i lartë në mesin e njerëzve të prekur nga diabeti i tipit 1. Tek pacientët e diagnostikuar me diabe-

tin e tipit 2, rreziku i frakturave i atribuohet faktorëve që shkojnë përtej nivelit të sheqerit në gjak. Diabeti prek miliona njerëz në botë dhe ai i tipit 2 është më i përhapur. Ky lloj i sëmundjes ndodh kur njeriu bëhet rezistent ndaj insulinës.

Diabeti i tipit 1 diagnostikohet më shumë tek fëmijët dhe adoleshentët dhe shkaktohet nga mungesa e insulinës.

FAKTORË TË TJERË RREZIKU TË FRAKTURAVE

Frakturat janë një rezultat jo vetëm i një trauma, por edhe dobësimi të kockave. Trauma

shkaktohet nga rrëzimi ndërsa forca e kockave varet nga volume, forma dhe cilësia e tyre. Dendësia kockore është një faktor i rëndësishëm rreziku. Gratë janë më të rrezikuara nga frakturat sepse kanë një dendësi më të dobët kockore. Ekspertët identifikojnë duhanpirjen dhe ushqyerjen si faktorë të rëndësishëm rreziku për frakturat e kockave. Sipas tyre, nëse një person rrëzohet në anë, është 6 herë më i rrezikuar nga një frakturë e ijeve. Mësoni më poshtë gjeni ndryshimet që duhet të bëni për të parandaluar frakturat.

KONSUMONI MË SHUMË

KALCIUM

Doza ditore është 1200 mg kalcium në ditë për femrat dhe 1000 mg kalcium për meshkujt. Këtë mineral mund ta merrni nga produktet organike të bulmetit, sardelet, barishtet, zarzavatet si brokoli, kumbullat e thata e të tjerë.

MË SHUMË VITAMINË D


Vitamina D zbut rrezikun e kësaj sëmundjeje dhe e ndihmon organizmin të përthithë më shumë kalcium. Trupi prodhon vetë vitaminë D nëse ekspozohet në diell për 10-15 minuta në ditë.

VITAMINA K

Vitamina K e ndihmon organizmin të prodhojë proteina për kocka të shëndetshme dhe të pakësojë sasinë e kalciumit të nxjerrë nga trupi. Ushqimet e papura me vitaminë K janë lakrat e vogla, ushqimet e fermentuara të bulmetit, kumbullat dhe brokoli.

MË SHUMË KALIUM

Kaliumi neutralizon acidet që largojnë kalciumin nga organizmi. Burimet më të mira të kaliumit janë banania, avokado, luleshtrydhet, portokalli, mango, kivi, pjeshkët, hurmat, karrotat, patatet e ëmbla, brokoli dhe speci i kuq. Doza e rekomanduar e kaliumit për të rriturit është 4700 mg.



Vaji i peshkut rrit inteligjencën e fëmijëve dhe parandalon kancerin

Vaji i peshkut, i cili shihet si ushqim i trurit nga ekspertët, është i rëndësishëm për shëndetin tonë. Një minimum prej 2.2 gram në ditë nga vaji i peshkut, rekomandohet të konsumohet, pasi shërben si mburojë mbrojtëse në trup, sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Shkalla e inteligjencës për fëmijët pas përdorimit të vajit të peshkut u rrit me 7.5 për qind, thonë disa studime. Për të parandaluar pothuajse të gjitha sëmundjet e zemrës dhe kancerit, zgjidhja kalon përmes vajit të peshkut, këshillojnë mjekët. Gjithashtu së fundi studimet tregojnë se vaji i peshkut mund të mbrojë edhe ndaj një vrasësi tjetër: kanceri i gjirit. Burimi ushqyes, i njohur edhe si Omega-3, mund të merret në kapsula ose në formë të lëngshme. Teoria se nëse konsumon vajin e peshkut do të shtosh në peshë është krejtësisht e gabuar. Vaji i peshkut është një nga yndyrat esenciale në gjakun tonë. Vaji i peshkut është një domosdoshmëri, veçanërisht në pikën e mbrojtjes nga sëmundjet. Kapsulat nuk përmbajnë sodium. Ai është një produkt i sigurt për të gjithë përfshirë këtu dhe gratë shtatzëna, duke i mbajtur sa më larg sëmundjeve apo edhe depresionit. Vaji i Peshkut rigjallëron lëkurën duke shtuar prodhimin e kolagenit dhe elastinëve që dhurojnë freski.

Këto gabime mos i bëni kurrë në mëngjes

Zgjimjet në mëngjes janë gjithmonë të vështira, sidomos tani në periudhën e dimrit kur koha e keqe ju bën edhe më gjumashë në mëngjes. Por duhet të kuptoni që momenti kur zgjohemi është edhe më i rëndësishmi gjatë ditës, ndaj duhet bërë në një mënyrë që të mos keni asnjë shqetësim më vonë. Pa dashur ne bëjmë disa veprime që kontribuojnë negativisht në energjinë tonë të ditës, ndaj dhe duhet t'i ndaloni sapo të kuptoni që ato shtojnë dhembjen e kokës. Më poshtë do t'ju tregojmë tre gabime të zakonshme që nëse edhe ju i bëni duhet t'i eliminoni menjëherë.



SHTYRJA E ALARMIT. Nëse ju mendoni se ato 5 apo 10 minuta që e shtyni alarmin do t'ju bëjnë që të ngopeni me gjumë në fakt nuk është aspak kështu. Në momentin

që nisni të flini sërish, do t'ju zërrë një gjumë i thellë dhe sapo të vijë ky moment zilja do të bjerë sërish çka do t'ju japë një ndjesi tronditjeje dhe nuk është aspak mirë

për shëndetin e zemrës tuaj.

KONTROLLI I EMAILIT, GJËJA E PARË QË BËNI? Mos u fusni direkt në gjendjen e punës. Largohuni nga kontrolli i email-it sepse do t'ju "prezantojë" me stresin që në mëngjes dhe kjo nuk është aspak gjë e mirë as për ditën tuaj dhe as për shëndetin.

KONSUMIMI I KAFESË DUKE U VESHUR. Nëse jeni me nxitim, më mirë lëreni konsumimin e kafesë për një moment më vonë, sepse në rast se konsumoni kafe duke u veshur apo duke bërë diçka gati, shtohet hormoni i stresit dhe në vend që të shtoni energjinë tuaj, në fakt stresoheni edhe më shumë.

Rrethohuni nga bluja, largon stresin në dhomën e gjumit

Ngjyrat e ndryshme kanë impakt të ndryshëm në trurin e njeriut. Thuhet se e kuqja sjell oreksin dhe njihet si ngjyra e kuzhinës. E gjelbra ka një efekt qetësues dhe dominon dhomat e ndenjes.

Po dhoma e gjumit? Blu, e kaltër nuk ka rëndësi, mjafton të luani me nuancat e blusë. Ky nuk është supozim, e thotë shkencën. Një studim i Travelodge doli në përfundimin se e kaltra mund të

ketë një ndikim real në cilësinë e gjumit. Studiuesit gjetën se nga mijëra të anketuar, njerëzit që flinin në dhoma të lyera me nuancat e blusë ishin më të qetë në përgjithësi, në krahasim me ata që flinin në një dhomë të lyer me nuancat e ngjyrave të tokës.

Efekti qetësues i blusë, shprehet Chris Idzikowski nga Edinburgh Sleep Centre, lidhet me receptorët e specializuar të quajtur

qeliza ganglion në pjesën e retinës së syve tanë, të cilët janë më të ndjeshëm ndaj ngjyrës blu. Një tjetër studim shkencor ka dalë në përfundimin se çarçafët e bardhë luftojnë stresin, ankthin apo pagjumësinë.

Mjafton të shtroni në krevatin tuaj çarçafë të bardhë, të lyeni muret ngjyrë të kaltër dhe kjo do të ndikojë drejtpërdrejtë në psikozën tuaj.



Ka një vend në Europë ku burrat gjithashtu marrin pushim të gjatë për të qëndruar me fëmijët e tyre. Dhe gratë nuk heqin dorë nga karrierat e tyre

Ngjan si një bar i vogël, i pikturuar me ngjyrë të kuqe, i rrethuar nga shtyrje të dëborës dhe i rrethuar me pemë. Brenda, zërat e katër burrave që këndojnë. Por nuk jemi në një shtëpi të gjuetisë në rrethin polar, ne jemi në zemër të Stokholmit. Dhe ata që këndojnë baladën Pippi Longstocking janë etërit e familjeve me fëmijët e tyre që rrinë në këmbë midis këmbëve të tyre. Në "çerdhet e hapura" Skånegatan, në rrethin e bukur të Södermalm, mëngjesi është "koha e babait". Në të vërtetë, nuk është planifikuar. "Ndonjëherë ata arrijnë në njëzet, të gjithë etërit, - thotë Jesse Holm, - as nuk e di se ku t'i vendos".

Në Suedi, shkollat e vërteta të fëmijëve nuk lejojnë fëmijët para 12 muajsh, por shteti garanton leje prindërore për një vit, shumë mirë të paguar dhe të ndarë mjaft mirë mes prindërve. Merita e "aksioneve", e cila rezervon për çdo anëtar të çiftit të paktën tre muaj. Kush nuk i merr ato, i humb dhe, nëse ai është një baba, rrezikon të humbasë edhe fytyrën e tij. Por kjo ndodh për shumë pak: statistikisht thonë se nëntë nga dhjetë baballarët prindorin pushim (në Itali janë dy) për një mesatare prej 3 muajsh dhe 19 ditësh. E gjithë kjo pas 10 ditëve të atësisë pranë lindjes, i jepet çdo punonjësi. Ky është një sistem i rafinuar në 40 vjet, i cili sot siguron nivele të larta fertiliteti të Suedisë dhe nivele stratosferike të punësimi të femrave, si dhe përfitime të të gjitha llojeve për fëmijët dhe prindërit. Studimet dhe hulumtimet janë më të mbushura me dendësi sesa dëborat në dimër: ka edhe një që numëron në 7% rritjen mesatare të pagës së një gruaje për çdo muaj leje të marra nga bashkëshorti i saj.

Pas të dhënave, prisni të zbuloni rekordmenin. Dhe kur dëgjoni këto baballarë të këndojnë të gjitha këngët e çerdheve, ju dyshoni se i keni gjetur ato. Në vend të kësaj, figurat e primave fshehin tregime lëvizëse në jetën e tyre kokëfortë dhe normale. Thomas Lindman Flores, një kontraktor i vogël ndërtimi, nuk donte të përsëriste gabimet e babait të tij: "Kompania është e tij, kur isha i vogël ai nuk ishte kurrë aty. Por për mua është shumë e ndryshme". Lindman ka punuar për muaj vetëm një ditë në javë dhe në të tjerat ai është në pushim me vajzën e tij Evita. Ata me fëmijë të vegjël e dinë se cilësia e kohës së përbashkët nuk është e mjaftueshme: kërkon sasi. Dhe për të organizuar sasinë, aftësitë e dobishme mate-

SUEDIA, SEKRETI I BABALLARËVE ME KOHË TË PLOTË

NJË VIT ME FËMIJËT E TYRE



matikore kthehen.

Olof Klugman, redaktor në një revistë javore, kohët e fundit ka pasur binjakët e tij të parë. Në këtë rast ditët e dhëna nga shteti për çiftin rriten (nga 480 në 660) dhe prindërit mund të qëndrojnë së bashku në shtëpi për disa muaj. "Jam në shtëpi për katër muaj e gjysmë, së shpejti kthehem në punë një ditë në javë, pastaj katër muaj me kohë të pjesshme dhe më në fund një tjetër gjashtë muaj baba me orar të plotë". Mekanizmi garanton fleksibilitet të madh. Dhe në gazetë si ia bëjnë? "Ata u organizuan, askush nuk është i shqetësuar". Thomas Strandqvist, një mësues i edukimit qytetar në Huddinge, gjysmë ore nga Stokholm, është rasti i shkollës: gjashtë muaj për secilin fëmijë. "Nëse unë u lejoj atyre të ndryshojnë temperaturën, ai zgjohet". Gruaja e tij është në punë, së shpejti do të marrë dy fëmijët e tjerë në shkollë.

"Do të shihni se si ata më ndihmojnë me fëmijën, ne jemi një ekip".

Veterani i vërtetë është një koleg i tij, Andreas. Ai flet një italishte të përsosur. "Por unë kam lindur këtu, në Itali kam jetuar vetëm në mes 18 dhe 22 vjeç, Carabinieri më ka bindur që të garoj për ta". Për të filluar një familje, megjithatë, Vincenza është kthyer në Suedi. Tri dekada më vonë, trofetë qëndrojnë në katin e fundit të një doli ku asnjë nga pesë fëmijët nuk mund t'i arrijë: ai është në pushimin e pestë; Ai kaloi pothuajse tre vjet, duke u marrë ekskluzivisht me djemtë. "Në lagje kërkojnë më shumë këshilla nga unë sesa tek edukatorët e tyre të shkollës: ata e dinë se unë jam ekspert". Prej 15 vitesh ka punuar mësues në të njëjtën shkollë të Thomas. "Nëse kam humbur një shans në punë? Ndoshta, por unë ende jam 30 vjet



Pilulë me Wi-Fi për kolitin

Gjenerata e re e ilaçeve të robotizuara shtohet me një tjetër produkt. Sapo është krijuar Vibrant, një pilulë inteligjente që shërben për të luftuar problemet e kolitit, shqetësim ky që godet rreth 15% të popullsisë globale. Është prodhuar nga një kompani farmaceutike izraelite dhe kapsula merret me ujë, si shumica e ilaçeve. Kur mbërrin në zorrë nis të vibrojë, duke lehtësuar kështu lëvizshmërinë e mureve intestinale, e më pas duke ndihmuar evakuimin në mënyrë natyrale. Lëvizja e pilulës kontrollohet me Wi-Fi, me anë të një radiokomande të jashtme, që bën të mundur edhe programimin e vibrimit në disa modalitete. Testet e para të kryera mbi rreth 300 vullnetarë, që 1 kanë marrë këto pilula për 8 javë nga 5 herë në ditë, kanë rezultuar të suksesshme, efikase dhe pa efekte anësore. Megjithatë kërkuesit thonë se do të vijojnë edhe teste të tjera, për rikonfirmime të mëtejshme.

përpara daljes në pension: koha që kalova me fëmijët e mi kurrë nuk do të më largojë".

Nyja e karrierës për disa është edhe e kundërt. Një nga etërit në kopshtin Skånegatan, Olle Wessel, punon në një kompani softuerike. Në korrik ai do t'u japë fund 8 muajve që ai ka zgjedhur për t'u kushtuar Tilde-së: "Askush nuk më dha probleme për leje: ndryshe do të kisha ndryshuar shoqërinë, e di vlerën e tregut dhe nuk mund të pranoj kushte për fëmijët". Për Pelle Nordin, 8 muajt e kaluar me djalin e tij Elton kanë ndryshuar shumë gjëra: "Është e vështirë të përshkruani një lidhje familjare kur jetoni aq tërësisht: është një shans unik, mund të them se kam gjetur një ekuilibër të vërtetë". Gruaja e tij, Jona, ka pasur kohë t'i përkushtohet karrierës së tij: "Dhe tani ne të dy kemi një kuptim të nevojave tona shumë më të thella". Përveç faktit, shton ai, "se Eltoni ka mësuar të thotë "baba" para "nënë", edhe nëse më pengon pak 'ta pranoj atë".

Nordin është një menaxher i Tieto, një multinacional dixhital me zyra në 25 vende: "Gjithmonë më kanë inkurajuar të marr pushim dhe e kam pasur kthimin shumë të thjeshtë". "Por për të tjerët, pushimi gjithashtu shërben për të vënë në pikëpyetje rrugën e tyre, të shumtë janë ata që vendosin të ndryshojnë punët, ose të fillojnë biznesin e tyre", shton Johan Bavman, një fotograf që kaloi 16 muaj si baba. Shumë kompani, veçanërisht në sektorin më të avancuar teknologjikisht, inkurajojnë shprehimisht pushimin. Spotify, e cila nga Stokholm ka pushtuar botën e muzikës streaming, liston në faqen e saj të internetit të gjitha përfitimet e një ekuilibri të saktë të punës dhe jetës. Dhe ngrë 100% (pa kufij të ardhurash) mbulimin e pagave për 6 muajt e parë të pushimit prindëror. Pothuajse të gjitha marrëveshjet kolektive të punës, në çdo rast, përforcojnë kontributin e shtetit.



Forma e fshehtë e depresionit

Maskimi i depresionit pas një buzëqeshjeje është i mundur, madje edhe i përhapur. Quhet Smiling Depression, depresioni i qeshur, ndonëse në fakt nuk do të thotë se këta persona që e kanë vuajënë më pak, por thjesht është më e vështirë që ky shqetësim psikologjik të identifikohet tek ta. Termi që përdoret nuk është teknik për psikologët, për të cilët ai që i afrohet më tepër është termi depresion atipik. Sipas kërkueses Olivia Remes së Universitetit të Cambridge, njerëzit që jetojnë me këtë gjë, zakonisht nuk lenë asnjëherë përshtypjen se mund të kenë ndonjë motiv për të qenë të trishtuar. Sipas saj janë kryesisht njerëz që kanë një karrierë, shtëpi, fëmijë, partner. zhvillojnë biseda të këndshme, por jo vetëm. Shpesh ndjehen vetëm dhe sforcimet që bëjnë për të vazhduar me këtë maskim i bën të jenë tej mase vulnerabël dhe të brishtë. Sipas kërkueses, kjo gjendje shqetësuese e fshehtë është mjaft e përhapur dhe prek në Britaninë e Madhe 15-40% të atyre që vuajënë nga depresioni.

VEPRIMET E OPOZITËS NUK KANË MIRATIM NDËRKOMBËTAR

“Të protestuarit është një akt demokratik, por djegia e gomave, përdorimi i shashkave dhe çarja e kordonëve të policisë për të sulmuar një institucion publik, dhe veçanërisht zemrën e demokracisë, nuk janë të tillë. Po ashtu, e nxisim policinë të reagojë në mënyrë përpjestimore”, thuhet në reagimin e OSBE-së



Ndërkohë që opozita protestonte përpara parlamentit, kryeministri Rama zgjodhi të mos mernte pjesë në seancë, por të vijonte turin e tij “Bashkia që duam”.

Nga Lushnja kryeministri tha se opozita është duke u fshehur për ti shpëtuar reformës në drejtësi.

“Ata që deri dje ishin në parlament sot vinë protestojnë para derës së parlamentit, duke thënë se janë populli se i gënjen mendja se mund të fshihen në popull kur të vijë momenti për të dale para drejtësisë. Kemi bërë një reformë në drejtësi për të cilën ishim gati të prishnim edhe qeverinë me ata që ishim më parë, se ata nuk e donin reformën në drejtësi. Kjo është faza

kur po pastrohet drejtësia, ku po ndahen gjykatësit dhe prokurorët e ndershëm, ku do të marrin në dorë drejtësinë e re që po ngrimë e para tyre do të dalin të gjithë ata që duhet, qofshin gjyqtar, qofshin prokuror a biznesmen. Se shqipëria nuk mund të jetë vendi ku zulumet mund të vazhdojnë pa ndëshkur, “ka thënë Rama.

Reagimi i parë nga ndërkombëtarët sa i takon dhunës dhe përplasjeve para parlamentit këtë të mërkurë, ka ardhur nga OSBE. Përfaqësia e OSBE në Tiranë deklaroi se dhuna nuk është përgjigja për problemet e Shqipërisë. OSBE dënon sërish nxitjen politike të dhunës dhe bën thirrje për vetëpërmbytje dhe përgjegjësi.

“Të protestuarit është një akt demokratik, por djegia e gomave, përdorimi i shashkave dhe çarja e

kordonëve të policisë për të sulmuar një institucion publik, dhe veçanërisht zemrën e demokracisë, nuk janë të tillë. Po ashtu, e nxisim policinë të reagojë në mënyrë përpjestimore. Ne po e monitorojmë situatën me shqetësim. Përgëzojmë mediat për shërbimin e madh që po i bëjnë demokracisë përmes raportimeve të drejtpërdrejta”, thuhet në reagimin e OSBE-së.

Dorëheqja e deputetëve të opozitës nga mandatet parlamentare, ka sjellë edhe reagimin e bashkëraportuesit për Shqipërinë në Asambleenë Parlamentare e Këshillit të Evropës, Andrej Hunko.

“Në një shoqëri demokratike, parlamenti është qendra e debatit politik, dialogut dhe diskutimit. Parlamentarët i përkasin parlamentit!”, thuhet në deklaratë.

Duke përshëndetur faktin se protestat e fundjavës së kaluar u zhvilluan në mënyrë paqësore, ata i bënë thirrje deputetëve të opozitës të rishikojnë vendimin e tyre për dorëheqje nga mandati dhe të rinisin punën në parlament. Në të njëjtën kohë, ata i bënë thirrje shumicës në pushtet që të sigurojnë një hapësirë të përshtatshme për opozitën për të funksionuar dhe për t’u angazhuar në një dialog të sinqertë dhe domethënës mbi reformat kyçe dhe qeverisjen e vendit. “Të dyja palët duhet të përdorin parlamentin për t’u angazhuar, në mirëbesim, në një dialog të tillë në mënyrë që të kapërcehet stuhia aktuale politike. Nëse kërkohet, ne jemi të gatshëm për të ndihmuar kolegët tanë nga të dyja palët në këtë përpjekje.”



Rusia reagon për deklarin e Ramës “Kosova bashkohet me Shqipërinë”

Rusia reagoi pas deklaratës së kryeministrit Edi Rama se Kosova është pjesë e Shqipërisë, duke e quajtur atë “të papranueshme”. Zëdhënësjë e Ministrisë së Jashtme ruse, Maria Zakharova e përdori konferencën e rregullt për shtyp për të përcjellë reagimin e Moskës ndaj pohimeve të shefit të ekzekutivit shqiptar.

Rusia sipas saj nuk mund të rrije pa folur, sidomos kur Rama, sic theksoi Zakharova, e bëri të qartë se Bashkimi i Kosovës me Shqipërinë nuk është një “plan B” por “një plan A”.

“Menduam se mbase nuk ishte përkthyer mirë deklarata e tij, ndaj e verifikuam disa herë. Kryeministri shqiptar e lidhi implementimin e këtij plani me diskutimet aktuale mbi korrigjimin e kufijve në kuadër të procesit të negociatave dhe arritjes së një marrëveshjeje finale mes Beogradit dhe Prishtinës. Ne konsiderojmë se retorika të tilla janë krejtësisht të papranueshme. Kjo është një çështje që ka të bëjë me shkeljen e integritetit territorial të Serbisë dhe statusin e Rajonit Autonom të Kosovës”, u shpreh Zakharova. Këtë ne e shohim si shkelje të rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, vazhdoi zëdhënësjë e cituar nga mediat serbe e ato kosovare, që më tej kërkoi edhe reagimin e Perëndimit për “plane të tilla gjeopolitike”. Zakharova theksoi edhe një herë se pozicioni i Rusisë mbi zgjidhjen e çështjes së Kosovës, mbetet i pandryshuar.

Vojvodina kërkon rikthimin e autonomisë së plotë nga Serbia



Kryetarët e partive Liga Socialdemokrate e Vojvodinës (LSV) dhe Partitë e Vojvodinës, Nenad Čanak dhe Aleksandar Oxhiq kanë paralajmëruar formimin e partisë Fronti i Vojvodinës, që do të ketë qëllim autonominë e plotë të kësaj krahine, shkruan sot gazeta e Beogradit “V. Novosti”.

Sipas kësaj gazete ata ankohen se për realizimin e këtij qëllimi po u pengojnë partitë serbe.

LSV javën e shkuar i ka parashtruar Kuvendit të Serbisë një rezolutë, por edhe një propozim ligj për financimin e Vojvodinës në mënyrë që të ndryshojë Kushtetuta, ndërsa krahina të rikthejë autonominë e plotë.

Regjimi i Milloseviqit autonominë e Vojvodinës e suprimoi me forcë në vitet e tetëdhjeta të shekullit të kaluar, pak para se këtë veprim ta ndërmerre kundër Kosovës.

Mallrat serbe po riambalazhohen për t’u shitur në treg

Kosova ende nuk ka arritur ta vërtetojë nëse produktet nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina po shiten në tregun vendor, duke ua ndërruar vendin e origjinës.

Që nga vendosja e taksës ka pasur dyshime se produktet janë dërguar në Maqedoni, aty iu është shtuar edhe ndonjë përbërës dhe pastaj janë ambalazhuar dhe vendi i origjinës iu është shkruar në Maqedoni, raporton KTV.

Në Doganën e Kosovës kanë treguar se deri tani janë identi-

fikuar vetëm 5 raste të dyshimta të tilla, e që janë produkte ushqimore. Si rrjedhojë, është kërkuar nga Dogana e shtetit fqinj verifikimi i vendit të origjinës.

Importi nga Maqedonia gjatë tre muajve të masës mbrojtëse ka qenë 24 milionë euro ose 2 milionë euro më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Stavileci ka treguar se rritje e ngjashme është edhe me vendet e tjera të rajonit.

Por, sipas kryetarit të Odës

Ekonomike të Kosovës, nuk është e jashtëligjshme mundësia që vendi i origjinës të ndërrohet në këtë formë, por ai e quan këtë vetëm jokorrekte.

Rukiqi ka thënë se mundësitë për të ndërmarrë masa ndaj kompanive, janë të kufizuara edhe shkaku i kufizimeve politike.

Gjatë tre muajve të fundit që kur është vënë taksë ndaj produkteve serbe në Kosovë, janë importuar vetëm rreth 670 mijë euro mallra kryesisht lëndë e parë e



prodhimit, që janë rreth 140 milionë euro më pak import nga Serbia se sa vitin e kaluar.

Ndërkaq, nga Bosnje Hercegovina janë importuar rreth 100 mijë euro mallra.

Dy vjet më parë Bashkimi Europian vendosi krijimin e një Prokurorie europiane (EUStA). Por kërkimi i një prokurori europian kthehet të përshtatshëm u kthye në politikum të keq

Plani kohor për krijimin e Prokurorisë Europiane (EUStA) u bë i qartë që në fillim: Autoriteti i ri duhet të fillojë punën më 2020. Synimi i tij, hetime mbarëeuropiane kundër korrupsionit, pastrimit të parave dhe mashtrimeve me paratë e BE. 16 vende anëtare, mes të cilave dhe Rumania, patën rënë dakord në prill 2017 që Prokuroria Europiane (EUStA) të krijohet në kuadër të një "bashkëpunimi të forcuar". Ndërkohë në këtë plan marrin pjesë 22 nga 28 vendet anëtare të BE.

Tre kandidatë për postin e ri të Prokurorit kanë arritur të shkojnë deri në raundin e fundit. Një komision i pavarur ekspertësh ka bërë zgjedhjen, sipas kritereve profesionale dhe Parlamenti Europian ka propozuar që postin ta marrë prokurorja rumune Laura Kövesi, dhe jo francezi Jean Francois Bohnert ose gjermani, Andres Ritter. Këto ditë merret vendim përfundimtar.

KÖVESI, SINJAL ALARMI PËR BUKURESHTIN

Siç u pa tani, ish drejtoresha e zyrës rumune për luftën kundër korrupsionit, DNA, nuk ka qenë vetëm sinjal alarmi për social-liberalët e qeverisë në pushtet në Bukuresht. Pas një sulmi frontal

"RASTI" KÖVESI



nga partia socialdemokrate PSD, parti në pushtet, dhe partneres së saj pseudoliberal ALDE, kundër juristes Kövesi, të vlerësuar nga BE është shprehur edhe Bullgaria.

Sipas njoftimeve nga rrethet diplomatike në Bruksel, në Komisionin e përfaqësuesve të përherëshëm të BE, kundër kandidaturës së Kövesit nuk votoi vetëm ambasadorja rumune në BE, por edhe kolegu i saj bullgar. Bullgaria, po ashtu si Rumania ka probleme kronike me korrupsionin e përhapur gjithandej. Të dy vendet ndodhen nën monitorim të fortë që me futje e tyre në BE, në vitin 2007. Laura Kövesi gëzon edhe në Bullgari respekt të madh.

E PREFERUAR EDHE NË BULLGARI

Mbas vizitës së saj në Sofje dy vjet më parë, shumica e bullgarëve e vlerësojnë Kövesin, si luftëtare e vendosur kundër korrupsionit shtetëror. Njëkohësisht në internet kundër saj ngrihen pretendime se ajo është "një projekt amerikan". Edhe kryeministri bullgar, Bojko Borisov e ka kritikuar disa herë luftëta-

ren e korrupsionit, të cilës ia kanë frikën. Sipas Borisovit, Bullgarisë nuk i duhet "modeli rumun", por duhet të orientohet më shumë drejt Gjermanisë dhe vendeve të tjera.

Marrja në pyetje këtë të martë nga Komisioni për lirinë qytetare, drejtësinë dhe çështjet e brendshme, si dhe nga Komisioni për kontrollin e buxhetit është një etapë tjetër e procesit për zgjedhjen e shefes së prokurorisë europiane. Shpifjet e bëra nga qeveria e Bukureshtit dhe sidomos një histori e çuditshme procesi dënimi, që u bë shpejt e shpejt pas përcaktimit të saj si kandidate nga sistemi i ri i drejtësisë në Rumani, mund të dobësojë shanset për zgjedhjen e Kövesit. Ka ekspertë në Bruksel që thonë të kundërtën, se mënyra se si qeveria e vet është duke u sjellë kundër saj tregon për punën e shkëlqyer që ajo ka bërë si drejtoreshë e DNA.

AUTOGOL PËR QEVERINË E BUKURESHTIT?

Në Parlamentin Europian janë duke u shtuar përkrahësit e kandidaturës së saj. Jo vetëm poli-

tikanë konservatorë nga Partia Popullore Europiane (EVP) dhe fraksioni liberal ALDE, por edhe anëtarët e socialdemokratëve europianë dhe Të gjelbërit duan që të mbështesin Kövesin për tu zgjedhur. Sa e rëndësishme është kjo përkrahje dhe sa e suksesshme ka qenë puna lobiiste e qeverisë rumune kundër kandidaturës së saj, do të tregohet në dy raundet e fundit të procesit të zgjedhjes. Në Pleniumin e Parlamentit Europian do të shkojë të mërkurën vetëm fituesi i etapës së ndërmjetshme, për tu zgjedhur me dy të treta si prokuror i ri europian.

Nuk ka rëndësi nëse Laura Kövesi mbërrin deri në fund apo jo. Qeveria social-liberale rumune ka bërë autogol gjatë mbajtjes së presidencës së BE. Ka kohë që bëhen spekulime për t' i përjashtuar të dyja partitë nga familja e partive europiane. Procesi i vazhdueshëm kundër drejtësisë së pavarur dhe kundër shtetit të së drejtës do të detyrojë disa politikanë europianë që të veprojnë. Për shkak të besueshmërisë që u duhet para zgjedhjeve europiane. /DW

RIKTHEHET KONFLIKTI NË KASHMIR



Pakistani i rrëzon dy avionë luftarak Indisë

Rikthehet konflikti ushtarak mes Pakistanit dhe Indisë. Të dy vendet janë fuqi bërthamore. Avionët luftarakë pakistanezë kanë rrëzuar dy avionë indianë të mërkurën, sipas zëdhënësit ushtarak të Pakistanit. Ky përshkallëzim dramatik erdhi vetëm një ditë pasi Forcat Ajrore Indiane bombarduan një kamp trajnimi të terroristëve brenda Pakistanit. Forcat ajrore të Pakistanit "qëlluan dy avionë indianë brenda hapësirës ajrore pakistaneze", tha zëdhënësi i ushtrisë pakistaneze, Asif Ghafoor. Njëri nga aeroplanë ra brenda pjesës së Kashmirit të kontrolluar nga Pakistani dhe tjetri u rrëzua në anën e Indisë. Piloti indian që ra në territorin pakistanez është arrestuar, deklaroi zëdhënësi. Pastaj, forca ajrore të Pakistanit kanë goditur objektivat brenda Kashmirit të kontrolluar nga India Sulmi është kryer nga hapësira ajrore pakistaneze sipas një deklarate nga Ministria e Jashtme e Pakistanit. "Ne nuk kemi ndërmend të përshkallëzojmë konfliktin, por jemi plotësisht të përgatitur për ta bërë këtë, nëse jemi të detyruar." tha Ministria e Jashtme Pakistanit.

ERDOGAN TREGTARËT I QUAN "TERRORISTË TË USHQIMIT"

Për Presidentin Erdogan, ulja e çmimit të ushqimeve e bashkë me të dhe të pakënaqësive të publikut, do të jetë çelësi për të ruajtur kontrollin në qytetet kyçe si Stambolli në zgjedhjet lokale të muajit të ardhshëm

Presidenti turk Rexhep Tayyip Erdogan i ka shpallur luftë inflacionit pas rritjes së çmimit të ushqimeve me 30 për qind si rezultat i rënies së vlerës së monedhës turke vitin e kaluar. Në një përpjekje që synon të garantojë të ardhmen e tij politike, zoti Erdogan ka marrë

masa radikale për të frenuar rritjen e çmimeve ndërsa ka akuzuar tregtarët e prodhimeve ushqimore, për rritje të paarsyeshme të çmimit.

Kjo është një pamje e zakonshme në të gjithë Stambollin, qendra shpërndarjeje që punojnë për shtetin, të cilat shesin ushqime të subvencionuara. Ato janë pjesë e një initiative të Presidentit Erdogan, që ka fituar mjaft popullaritet mes njerëzve të dëshpëruar nga çmimet e larta të ushqimeve. "Çmimet e ushqimeve janë të larta, ndodh që të shkosh në treg e kthehesh në shtëpi pa blerë asgjë. Pse? Sepse produktet janë të shtrenjta. Afrohesh të blesh presh dhe sheh se kushton 6 apo 7 lira. Çmimi i spinaqit është rritur në dhjetë lira. Unë mund ta përballoj, por familjet e mëdha nuk mund ta blejnë kurrë me këtë

çmim", thotë Nimet, punonjëse universitare. Rënia e vlerës së monedhës vitin e kaluar solli për pasojë një valë inflacioni, që çoi në rritjen e kostos së prodhimeve ushqimore. Presidenti Erdogan, në mesin e një fushate për një proces të rëndësishëm zgjedhor në nivel lokal që mbahen në muajin mars, fajësoi tregtarët me shumicë dhe ata me pakicë të ushqimeve për rritjen e tepruar të çmimeve, duke i etiketuar ata si "terroristë të ushqimit". Zinxhirët e supermarketeve, nën kërcënimin e nisjes së hetimeve rreth çmimeve të paarsyeshme, thonë se aktualisht po shesin nën kosto dhe duke mbajtur nën kontroll sasinë e mallit për shitje. Në këtë etiketë shkruhet se patatet, të cilat kushtojnë rreth pesë lira për t'u prodhuar, shiten me dy lira. Fu-

shata e ndrydhjes së çmimeve nga subvencionet dhe kërcënimet, ka nxitur dëshpërimin tek tregtarët e vegjël. "Ka ndikuar nivelin e shitjeve në masën 50 për qind. Konsumatorët vijnë këtu, shohin çmimet dhe nuk blejnë asgjë, thjesht largohet, çmimet janë shumë të larta. Nuk mund të konkurosh me shtetin. Shteti e blen produktin për tre lira e gjysmë dhe e shet me dy", thotë Aliu, një tregtar patatesh.

"Ti ke qenë këtu pranë meje për rreth gjysmë ore, a më pe të shes ndonjë gjë? Asnjë! Më doli fryma duke bërë titull që nga mëngjesi dhe kam shitur vetëm dy kile për dy klientë" thotë Hulusi, tregtar domatesh.

Për blerësit, të cilët kërkojnë çmime më të mira në kushtet kur të ardhurat e tyre janë ulur, lufta e



çmimeve e udhëhequr nga Presidenti Erdogan është më se e mirëpritur. "Ka pasur një rënie të çmimit të ushqimeve këtë javë. Javët e kaluar çmimet ishin mjaft të larta. Me ndërhyrjen e presidentit ka pasur një rënie të çmimeve dhe kjo i gëzon njerëzit. Shpresoj që të vazhdojë kështu", thotë Sule, blerëse.

Për Presidentin Erdogan, ulja e çmimit të ushqimeve e bashkë me të dhe të pakënaqësive të publikut, do të jetë çelësi për të ruajtur kontrollin në qytetet kyçe si Stambolli në zgjedhjet lokale të muajit të ardhshëm.

MEDIAT ITALIANE ARTIKULL VLERËSUES PËR ROMANIN “OTELLO, ARAPI I VLORËS”

Vlora është një Venedik i dytë, dy qytete kozmopolite përballet detit, në ngjashmëritë dhe dallimet e Otellos, i cili i huaj në të dy prej tyre, vazhdon të mendojë se deri në momentin që ju të gjeni veten duhet të zgjidhni vetëm një

Nga Shaul BASSI

“Otello ishte njeriu i parë i zi që vinte në Vlorë. Gjatë shekujve, deti kishte sjellë në qytet, Ciklopë që ende jetojnë në drithërimat e fëmijëve, sirena të gjelbra që kishin turbulluar mendjet e peshkatarëve, njerëz me bishta që ngjithnin malet.”

Në këtë pasazh, i cili shënon kalimin e romanit nga pjesa e parë veneciane në skenën shqiptare, narratori tregon mësimin e tij frymëzues të tragjedisë. Ashtu si te Shakespeare, Arapi mbron veten kundër akuzave për magji të zezë para Senatit të Venedikut me tregimet e tij fantastike të “kani-balëve, dhe burrave, kokat e të cilëve rriten / nën supet e tyre” (Otello, I, 3), Ben Blushi e përsërit, me një listë të ngjashme të krijesave imagjinare, që e vetmja magji e vërtetë është ajo e fjalës.

Vlora e tregimit, në fakt, është shumë ndryshe nga përralla: është një port në luftë, pushtuar nga



murtaja dhe rrethuar nga turqit, një vend i urisë dhe frikës si ajo kombinon shkencën dhe paragykimet, mikpritjen dhe armiqësinë, dashurinë dhe seksin e përzier me dhunën dhe dhimbjen.

Vlora është një Venedik i dytë, dy qytete kozmopolite përballet detit, në ngjashmëritë dhe dallimet e Otellos, i cili i huaj në të dy prej tyre, vazhdon të mendojë se deri në momentin që ju të gjeni veten duhet të zgjidhni vetëm një.

Shkrimtari dhe politikani Ben Blushi, i cili me këtë punim interesant përkthyer nga Elda Katorri fitoi çmimin letrar të Bashkimit

Evropian në vitin 2014, ka pasuruar një traditë të gjatë të rishkrimit romantik të Shekspir.

Karakteri më enigmatik, Otello për shekuj me radhë ka detyruar aktorët dhe drejtorët që të pranojnë misterin e së kaluarës së tij dhe ta reinventojnë vazhdimisht historinë dhe identitetin.

Shumë autorë kanë përfutur nga qëllimi më i gjerë i formës së romanit për të plotësuar këto boshllëqe me biografi alternative. Disa, si sudanezi Tayeb Salih me “Sezoni i Migracionit në veri” (Shitësit, 1992) fsheh komplotin e Shekspir në një komplot kolonial;

dhe Caryl Phillips, në “Kujtimi i Gjakut” (Imprimatur, 2015), shkruan një lloj rezymeje për ngjarjet e dramës; ndërsa Tracy Chevalier, në më të fundit roman me titullin “Djali i ri” (Rizzoli, 2017) transponon historinë në Shtetet e Bashkuara të sotme duke theksuar përshtatshmërinë e temës interraciale. Ndryshe nga këta (dhe ndoshta në sajë të ekscentricitetit të saj në krahasim me kanunin anglez) Blushi nuk ka shqetësime për të përdorur karaktere dhe emra origjinale, që më pas të ridizajnojnë historinë dhe gjeografinë e tyre. Si një anglist dhe jo një ekspert i letërsisë shqipe, gjej në këtë pabesi të dukshme një homazh besnik ndaj origjinalit. Shekspiriana është me të vërtetë liria që Blushi merr me burime: pa u marrë lexuesve kënaqësinë e duke i joshur me ritmin e ngadaltë dhe bukurinë e historisë, do të themi vetëm se këtu Othello nuk është një veteran i betejës që vjen në Venecia si oficeri me përvojë, por një fëmijë sklav që i jepet Desdemonës së vogël, vëllai i të cilit ligo luan një rol dytësor në këtë çështje.

Shekspirian është ndoshta edhe anakronizmi i përhapur, i cili sjell deri kaq vonë portrete të shekullit të katërbëdhjetë të grave lakuriq në muret e pallateve veneciane dhe çokollata në tryezat e tyre, duke portretizuar mjekun shqiptar Stefano Gjika shkencëtarin bashkëkohor të Vesalius dhe Harvey në një kanal mesjetar.

Së fundi, Shekspiriane është

aftësia e autorit për të marrë disa imazhe figurative nga tragjedia, duke i zhvilluar ato dhe pastaj duke i hedhur në veprime të vërteta dhe romantike.

Në skenën e parë të tragjedisë, ligo krahason Otellon me një hamshor, që ngjall kafshët në sytë e babait të tmerruar të Desdemonës; Blushi fjalë për fjalë e kthen atë në një kalë, i poshtëruar dhe torturuar nga shokët e tij rob në Vlorë. Në fakt, dhjetë vitet që Otello kaloi në Shqipëri e shohin atë vetëm të veshur në rrobat e një luftëtari që me guxim sfidon osmanët; për shumicën e kohës ai duket si një karakter pasiv, i burgosur, i vuajtur, viktimë e eksperimenteve perverse shkencore dhe torturës mizore, viktimë e paragykimet dhe qëllimit të errët e joshjes mashkullore që i shtojnë një dimension tjetër në një roman shumë origjinal lirik, të përgjakshtëm dhe sensual.

Hija e shekullit të 21 përfshihet vazhdimisht në lexim, pa u bërë asnjëherë prezencë e vështirë didaktike, në këtë Mesdhe të lashtë. Ne lexojmë për një emigrant të ndarë gjithmonë nga veçantia e pakalueshme e jetës së tij (me kujtimet e tij nostalgjike, punët që i copëtojnë zemrën e dashurisë, dilemat e tij dhe veprimet e tij fatale) dhe stereotipet që i rëndojnë. Tani si dikur, i huaji dëshiron të jetë vetvetja, por ai duhet të luftojë pa fundësisht me fantazmat që shfaqen projekton mbi të: “Njerëzit e donin Otellon, por urrejnë Arapin”.

Netflix, kërcënim për kinematë

Vendi ideal për të parë një film gjithmonë ka qenë një kinema, mirëpo viteve të fundit platforma “Netflix” është kthyer në një kërcënim për kinemanë.

Kjo platformë e cila ka filma, serië nga më të fundit është duke konkurruar bindshëm me kinematë.

Në vitin 2018 “Netflix” ka thyer rekordet e abonimeve dhe të klientëve të rinj, duke arritur shifrën e 139 milionë në mbarë botën, shifër kjo 3 herë më tepër se 5 vite më parë. Gjithashtu ja vlen të


përmendet që në një familje nuk sheh vetëm një person kështu që numri është edhe më i lartë. Platforma “Netflix” ka arritur rreth 40% e përdoruesve në SHBA, si dhe ka kryer investime për të patur kontentin e saj origjinal, duke shpenzuar deri në 13 bilion dollarë në serië si “Narcos” etj. Mirëpo, kjo platformë ka marrë edhe kritika, pasi një pjesë të vogël të filmave i jep në kinema për një kohë të shkurtër për t’i transmetuar më pas në adresën e tyre. Viti 2017 ishte një

vit i vështirë për ata që realizojnë filma. Por kudo në botë kinematë kanë arritur që në 2018 të fitojnë 41.5 bilion dollarë, 2.6% më shumë se në 2017. Duket se kinematë, por edhe teatrot janë në një ‘luftë’ për audiencë. Megjithatë është ende herët për të thënë se “Netflix”, por edhe platforma të tjera janë duke shënuar fundin e kinemasë pasi edhe ato kanë problemet e tyre në treg duke patur parasysh rritjen e çmimit të abonimit në vende të ndryshme.



Morgan Freeman mban flamurin e Kosovës

Aktori dhe regjisori i njohur nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Morgan Freeman, ka pozuar me flamurin e Kosovës përkrahë atij të SHBA-së. Madje flamurin e shtetit tonë ai po e mban në pallton e tij. Fotografinë e Freeman me flamurin e Kosovës e kanë shpërndarë në rrjetet sociale diplomatët e shtetit tonë në Panama. “Kënaqësi të takojmë një ndër aktorët me të mirë të të gjitha kohërave, Morgan Freeman”, thuhet në njoftimin e tyre. Duket se diplomatët kosovarë ia kanë dhuruar aktorit të njohur flamurin tonë, të cilin ai po e mban në pallton e tij. Ndryshe, Morgan Freeman është një aktor dhe regjisor filmi nga Shtetet e Bashkuara dhe ishte kandidat për çmimin Golden Globe në vitin 2005 në kategorinë protagonistit dytësor. Morgan Freeman fitoi me rolin në filmin Million Dollar Baby çmimin e Academy Awards.



Muzeu i Artit Bashkëkohor në Kështjellën e Rivolit organizon për të parën herë një ekspozitë personale të Anri Salës. Artisti i rëndësishëm me origjinë shqiptare, që ka përfaqësuar Francën në Bienalen e Venecias, më 2013-ën, Anri Sala ka marrë pjesë në ekspozita të rëndësishëm në Kështjellën e Rivolit, mes tyre ato kolektive “Fytyra në turmë”, më 2005-ën dhe “Emocioni i ngjyrave të artit”, më 2017-ën

ANRI SALA - MUZIKA SI GJUHË



shëm. Vepra e Ravel-it, u kompozua më 1929-ën, për një muzikant që kishte humbur dorën e djathtë në Luftën Parë Botërore. Projekti i Salës është interpretimi i të njëjtës pjesë muzikore nga dy muzikantë. Secili film është fokusuar në ko-reografinë e dorës së majtë duke përfshirë të tërë tastierën ndërsa dora e djathtë qëndron e palëvizur. Dy filmat projektohen njëherazi duke krijuar përshtypjen e një gare muzikore, për shkak të mospërputhjes mes tempeve të tyre, që janë përgatitur nga Sala dhe kompozitori dhe dirigjenti Ari Benjamin Meyers. “Kur luan në piano me të dy duart, qendra e trupit është përballë qendrës së pianos. Por kur nis të luash vetëm me dorën e majtë, i gjithë trupi duhet të lëvizë në skajin e djathtë të pianos si për të shlyer diçka që mungon. Kështu, përpjekja e trupit për të shlyer humbjen flet rreth shoqërisë, rreth luftës,” do të shprehej artisti shqiptar në një intervistë për New York Times.

INSTALACIONI “RAVEL RAVEL”

Në projektin “Take Over” janë dy vepra të mirënjohura muzikore, të shoqëruara me historinë e ngatërruar politike dhe kulturore, Marsejeza dhe Internacionalja. E shkruar më 1792-shin, Marsejeza ka qenë e lidhur me Revolucionin Francez dhe shpejt u përhap edhe në shtete të tjera duke u bërë simbol i rrëzimit të regjimeve

shtypës. Kështu, lirika e Internacionales së 1871-shit u vendos fillimisht me tingullin e Marsejezës, deri më 1888-ën kur muzika origjinale u kompozua dhe kënga u bë himn standard i lëvizjes socialiste. Të dy himnet kanë pësuar ndryshime të mëdha në konotacionet e tyre politike; nga revolucionet, rimëkëmbjet, socializmi, rezistenca dhe patriotizmi, me shoqërimi shtesë si kolonizimi dhe shtypja në gjysmën e dytë të shekullit të njëzetë (si himne kombëtare të Francës dhe Bashkimit Sovjetik, respektivisht). “Take Over” e bën të dëgjueshme marrëdhënien e afërt të këtyre dy himneve politike dhe eksploron ngjashmërinë muzikore për gjumë të këtij ndryshimi domethënie simbolike. Vepra manifestohet si një strukturë e përbajtur arkitekturore që konsiston në një mur qendror me panele xhami në kënde. Dy këngët duket sikur dyfishohen në dy filma komplementarë. Secili i projektuar nga njëra anë e murit projektues, filmat shfaqin tastierën e pianos së Disklavier, interpretuar një instrumentist human, por i animuar në programim, një larmi veprimesh, e shndërrojnë tastierën në një peizazh të animuar bardhezi, me luginë dhe maja.

“TAKE OVER”, VIDEO-PROJEKT I ANRI SALËS

Duke nisur nga vitet 2000, Anri Sala krijon instalacione fil-

mike dhe muzikore, skulptura, fotografi dhe dizajne që hetojnë frakturat dhe mospërputhjes përmes të cilave shpaloset historia. Artisti përdor hapësirën arkitektonike për të moduluar elementë pamorë, zanorë dhe taktilë, me qëllimin për të gjeneruar interpretime të reja dhe mundësi të padëgjues nga brenda një vizioni emancipues të gjuhës dhe kulturës. Duke na distancuar nga “logjikja”, kuptimi direkt i bazuar në gjuhë, vepra e tij hap dyert e perspektivave të shumëfishta dhe interpretimeve. Në kontrast me kinemanë tradicionale, përdorimi i dallueshëm i sfidave të filmit sfidon epërsinë e imazhit, duke i lejuar tingullit të shërbejë si një aluzion i rëndësishëm narrativ: muzika i flet historisë dhe memories, bën bashkë të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen e shikuesit në një përvojë të vetme filmike.

Kjo “e tashme e vazhdueshme” e gjetur në veprën e Salës ka një efekt të mbërthyerit të audiencës në një moment specifik sesa t’i projektonte ata në iluzionin e asaj çka shohin. Duke krijuar këtë gjendje vetëdijesimi, artisti propozon një ushtrim në rezistencën civile me implikime politike; vepra e tij na lejon të rimarrin në konsideratë marrëdhënien e hapësirës sonë dhe kohën drejt vendndodhjes dhe momentin historik të përshkruar në film.

EKSPOZITA DO TË KETË FORMËN E NJË PARADE

“Po e rafinoj paradën sa më shumë që mundem këtu në studio. Mezi pres t’ju bashkohem në Rivoli, për pak realitet, sepse po kaloj shumë kohë në simulime dhe virtualitet. Po mendoja t’i jepja ekspozitës një titull; As you go. Në anglisht, ose italisht—Mentre vai? Vizualisht, më duket anglishtja më muzikore (megjithëse italishtja është gjuhë më melodike. As you go, ngjan si Do Re Mi Fa Sol...Përmes kësaj parade, ekspozita si e tërë bëhet një instrument muzikor që mbështetet në qëndrimin e vizitorëve për të përfutur dimensionin e saj të plotë... Jam i interesuar në idenë se nuk ka destinacion për t’u arritur, se finalja është tek trajektorja”, është shprehur artisti.

Si përbërës të një orkestre të pazakontë, tre veprat në ekspozitën e Kështjellës janë rimodeluar nga artisti duke përdorur si instrument realitetin e shtuar, për t’u ofruar vizitorëve një përvojë me impakt të lartë emotiv dhe sinestetik. Ekspozita do të ketë formën e një parade, me një fluks imazhesh në lëvizje dhe narracione të shumëfishta. Më shumë sesa një prezantim të tre veprave filmike të gërshetuara, në tërësinë e saj ekspozita mund të interpretohet si diapozitiv i aftë të transformojë projektimet në një skulpturë gjigante në lëvizje.

Përvjetori i botimit të “Alfabetares së gjuhës shqipe”

Më 27 shkurt të vitit 1897 u botua në Stamboll “Alfabetarja e gjuhës shqipe”, e cila u botua me nismën e atdhetarëve Sami Frashërit, Jani Vretos e Pashko Vasës.


Ishte një nga veprimtaritë më të rëndësishme të patriotëve shqiptarë të Stambollit, të cilët më 12 tetor 1879 themeluan “Shoqërinë e të Shtypurit të Shkronjave Shqip”, shoqëri kulturore, që kishin për synim të nxiste zhvillimin e

kulturës në gjuhën shqipe dhe ta vinte atë në shërbim të çështjes së çlirimit kombëtar nga Turqia.

Me alfabetin, plotësonte një nga kërkesat bazë për përhapjen e propagandës atdhetare dhe i hapte rrugën botimeve të para serioze të Rilindjes sonë Kombëtare. Në gjirin e saj bashkëpunuan ngushtësisht myslimanë të mëdhenj si vëllezërit Frashëri, katolikë të shquar, si Pashko Vasë Shkodrani, e

ortodoksë të mësuar e atdhetarë si Jani Vreto, ishte pra model i bashkëpunimit ndërmjet feve në shërbim të Atdheut.

Gjithsesi çështja e alfabetit të shqipes do të zgjidhej përfundimisht vetëm me Kongresin e Manastirit, që u mbledh më 14 nëntor 1908, ku u hartua një alfabet i ri me shkronja latine. Është alfabeti që përdorin edhe sot e kësaj dite gjithë ata, të cilët shkruajnë shqip.





REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
Up1 Nr.08-66
27.02.2019
Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi 1 alineja 2, nenit 82 paragrafi 1 alineja 6 dhe nenit 83 e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19), ndërsa në lidhje me nenin 80 paragrafi 5 i të njëjtit ligj, nenit 51 paragrafi 1 dhe paragrafi 3 dhe nenit 52 paragrafi 2 e Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 124/15), nenit 14 të Ligjit për kontestet administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/06 dhe 150/10) dhe nenit 24 të Rregullores për procedurat e punës financiare dhe kontabilitetit të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale nr. 01-6222/1 të datës 12.12.2014, duke vepruar sipas Propozimit të Up1 nr. 08-66 të datës 14.02.2019, për ngritje të procedurës për marrje të lejes për emetim televiziv të Shoqërisë tregtare radiodifuzive K TRI Televizioni SHPKNJ Kumanovë, ndërsa në pajtim me Konkluzionin nr. 02-1122/4 të datës 27.02.2019, Këshilli i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, në mbledhjen e 11-të të mbajtur më datë 27.02.2019 ka sjellë:

VENDIM

Për marrjen e lejes për emetim televiziv të Shoqërisë tregtare radiodifuzive K TRI Televizioni SHPKNJ Kumanovë

1. MERRET leja për emetim televiziv, nr. 08-21 të datës 05.01.2015 Shoqatës tregtare radiodifuzive K TRI Televizioni SHPKNJ Kumanovë, për shkak të mosplotësimit të obligimit nga neni 80 paragrafi 5 i Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, për shkak të mos pagesës kompensimit vjetor për leje të emetimit televiziv në afatin e caktuar me ligj - 30 ditë nga dita e pranimit të Faturës nr. 2019-100-0017 (nr. ynë ark. 05-104/1 të datës 10.01.2019).

2. Fatura nr. 2019 -100-0017 (nr. ynë ark. 05-104/1 e datës 10.01.2019) do të ndërpritet dhe subjektit nga pika 1 e këtij Vendimi, do të jepet faturë e re, e cila ka të bëjë vetëm për periudhën e punës, gjegjësisht deri në ditën e sjelljes së vendimit për marrje të lejes, dhe e cila duhet të paguhet jo më vonë se 8 (tetë) ditë nga dita e publikimit të saj.

3. Ky Vendim të publikohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", në ueb faqen e Agjencisë dhe në dy gazeta ditore, prej të cilave njëra gazetë ditore në gjuhën e komunitetit që nuk është shumicë, ndërsa e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

4. Ky Vendim është përfundimtar.

Arsyetim

Shoqëria tregtare radiodifuzive K TRI Televizioni SHPKNJ Kumanovë, është posedues i lejes për emetim televiziv nr. 08-21 e datës 05.01.2015, për emetim përmes multipleksit digital terestrial, në nivel rajonal, për rajonin D2 - Stracin (Kumanovë, Likovë, Nagoičan i Vjetër, Romanlije, Kriva Pallanka, Kratovë), programi televiziv me format të përgjithshëm argëtues, në gjuhën maqedonase dhe gjuhën shqipe.

Në pajtim me nenin 80 paragrafi 1 të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 13/16, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19), për lejen për emetim televiziv ose radio emetim radiodifuziv, me përjashtim të servisit publik radiodifuziv, paguajnë kompensim vjetor në llogari të Agjencisë në pajtim me këtë ligj. Kompensimi vjetor paguhet për secilin vit aktual duke filluar nga data e dhënies së lejes për emetim televiziv ose radio emetim në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të faturës së dhënë nga Agjencia (neni 80 paragrafi 5 i Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale).

Në lidhje me kompensimin për lejen e dhënë për emetim televiziv SHTR K TRI Televizioni SHPKNJ Kumanovë, nr. 08-21 të datës 05.01.2015, Agjencia më datë 14.01.2019, i ka dorëzuar faturë nr. 2019-100-0017 (nr. ynë ark. 05-104/1) në pajtim të së cilës radiodifuzeri ka qenë i obliguar që të paguajë 221.984,00 (dyqindënjzetë mijë e nëntëqindetëdhjetëkatërt) denarë për kompensim vjetor për lejen për emetim televiziv, për periudhën prej 05.01.2019 deri më 04.01.2020. Në Agjenci në librin e dorëzimeve është regjistruar se fatura është pranuar në mënyrë të rregullt më datë 14.01.2019.

Në pajtim me nenin 27 paragrafi 1 të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, Agjencia bën mbikëqyrje administrative, i cili bëhet për punën e publikuesve medial nga aspekti i harmonizimit të punës së tyre me kushtet e caktuara me Ligjin për media, Ligjin për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale dhe dispozitat e sjella në bazë të tij (neni 29 paragrafi 1 i Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale).

Agjencia përmes Sektorit për financa dhe logjistikë, ka bërë mbikëqyrje administrative të punës së SHTR K TRI Televizioni SHPKNJ Kumanovë nga aspekti i përmbushjes së obligimit për pagesë të kompensimit vjetor për lejen, pas çka pas realizimit të mbikëqyrjes së rregullt administrative, në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e realizuar administrative nr. 05-831/1 të datës 13.02.2019, ka konstatuar se radiodifuzeri i theksuar nuk ka përmbushur obligimin ligjor të caktuar me nenin 80 paragrafi 5 i Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, gjegjësisht nuk ka paguar kompensimin vjetor për lejen për emetim televiziv në llogari të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale. Gjegjësisht, sipas faturës së dorëzuar me nr. 2019-100-0017 të datës 10.01.2019, SHTR K TRI Televizioni SHPKNJ Kumanovë, ka pasur obligim të paguajë 221.984,00 (dyqindënjzetë mijë e nëntëqindetëdhjetëkatërt) denarë për kompensim vjetor për lejen për emetim televiziv për periudhën prej më 05.01.2019 deri më 04.01.2020. Në Raportin e cituar me shkrim për mbikëqyrjen e realizuar administrative, është konstatuar se deri më 12.02.2019 kur ishte afati përfundimtar ligjor për pagesë të kompensimit për lejen për emetim televiziv për periudhën prej 05.01.2019 deri më 04.01.2020 SHTR K TRI Televizioni SHPKNJ Kumanovë nuk ka realizuar pagesën në shumë prej 221.984,00 (dyqindënjzetë mijë e nëntëqindetëdhjetëkatërt) denarë.

Në bazë të nenit 23 paragrafi 1 alineja 3 e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale është përcaktuar se nëse konstatohet mosrespektim të dispozitave të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale dhe akteve nënligjore të sjella në bazë të tij, si dhe të kushteve dhe obligimeve të përcaktuara me lejen dhe akteve të tjera të Agjencisë, kundër themeluesit të medias, Këshilli i Agjencisë mund të ndërmerr masa - marrje të lejes.

Në pajtim me nenin 82 paragrafi 1 alineja 6 e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, Agjencia do të marrë lejen për emetim televiziv ose radio emetim, para përfundimit të afatit për të cilin është dhënë dhe do të fshijë radiodifuzerin nga regjistri i radiodifuzerëve, pas lajmërimit të dorëzuar me shkrim më herët, nëse poseduesi i lejes nuk e paguan kompensimin për lejen për në afatin e caktuar me ligj.

Procedurën për marrje të lejes për emetim televiziv ose radio emetim, në pajtim me nenin 83 paragrafi 1 të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale e ngritë Këshilli pas propozimit të drejtorit të Agjencisë.

Duke pasur parasysh gjendjen e caktuar faktike, në pajtim me të cilën poseduesi i lejes, SHTR K TRI Televizioni SHPKNJ Kumanovë, në afatin e caktuar ligjor prej 30 ditëve nga dita e pranimit të faturës së dhënë nga Agjencia, nuk ka përmbushur obligimin nga neni 80 paragrafi 5 i Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, gjegjësisht poseduesi i lejes nuk ka paguar kompensimin për leje për emetim televiziv në afatin e caktuar ligjor, Drejtori i Agjencisë, d-r Zoran Trajčevski në bazë të nenit 83 paragrafi 1, ndërsa në lidhje me nenin 82 paragrafi 1 alineja 6 e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, ka parashtruar Propozim Up1 nr. 08-66 të datës 14.02.2019, për ngritje të procedurës për marrje të lejes për emetim televiziv të SHTR K TRI Televizioni SHPKNJ Kumanovë.

Këshilli i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale në mbledhjen e saj të 8-të të mbajtur më 15.02.2019, me Konkluzion nr. 02-748/14 të datës 15.02.2019, ka miratuar Propozimin, Up1 nr. 08-66 të datës 14.02.2019, për ngritje të procedurës për marrje të lejes për emetim televiziv SHTR K TRI Televizioni SHPKNJ Kumanovë, të parashtruar nga propozuesi, Drejtori i Agjencisë, d-r Zoran Trajčevski.

Në lidhje me procedurën e ngritur për marrjen e lejes së SHTR K TRI Televizioni SHPKNJ Kumanovë nr. 08-21 të datës 05.01.2015, ndërsa në pajtim me nenin 82 paragrafi 1 të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, Agjencia ka parashtruar Lajmërim deri tek radiodifuzeri i theksuar (Up1 nr. 08-66 të datës 15.02.2019) ku është paralajmëruar se nëse nuk e paguan kompensimin vjetor për lejen për kryerje të radio emetimit në pajtim me nenin 83 paragrafi 3 të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të Propozimit të Drejtorit të Agjencisë, Up1 nr. 08-66 të datës 14.02.2018, do të sjellë Vendim për marrje të lejes së saj për emetim televiziv, pas çka në pajtim me nenin 85 paragrafi 2 të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, radiodifuzeri do të fshihet nga regjistri i radiodifuzerëve.

Lajmërimi Up1 nr. 08-66 i datës 15.02.2019, është dërguar deri tek SHTR K TRI Televizioni SHPKNJ Kumanovë, në formë me shkrim përmes "Postës së Maqedonisë" Shkup, pas çka në Agjenci është parashtruar fletëdorëzim se e njëjta është dorëzuar në mënyrë të rregullt më datë 19.02.2019. Gjithashtu, Lajmërimi deri tek radiodifuzeri është dërguar edhe në formë elektronike më datë 15.02.2019 në adresën elektronike të radiodifuzerit i regjistruar si informacion për kontakt në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë, si dhe adresës elektronike të radiodifuzerit i evidentuar në regjistrin e radiodifuzerëve të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 83 paragrafi 3 i Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, Këshilli obligohet në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të propozimit të Drejtorit për ngritje të procedurës për marrje të lejes, të sjellë vendim me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit.

Duke pasur parasysh faktin se poseduesi i lejes SHTR K TRI Televizioni SHPKNJ Kumanovë, nr. 08-21 të datës 05.01.2015, dhe në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të Propozimit Up1 nr. 08-66 të datës 14.02.2019 nga ana e anëtarëve të Këshillit të Agjencisë, nuk ka përmbushur obligimin e paraparë me nenin 80 paragrafi 5 të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, person i autorizuar nga ana e Drejtorit të Agjencisë në bazë të Autorizimit nr.03-1125/1, parashtroi Propozim nr.08-66 të datës 26.02.2019 me të cilin Këshilli i Agjencisë në bazë të nenit 82 paragrafi 1 alineja 6 e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, ndërsa në pajtim me Konkluzionin e Agjencisë, nr. 02-1122/4 të datës 27.02.2019, ka sjellë Vendim të cilën merret leja nr. 08-21 e datës 05.01.2015 për emetim televiziv të SHTR K TRI Televizioni SHPKNJ Kumanovë, për shkak se poseduesi i lejes nuk ka përmbushur obligimin nga neni 80 paragrafi 5 e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, gjegjësisht nuk ka paguar kompensimin për leje për emetim televiziv në afatin e caktuar me ligj.

Në pajtim me nenin 24 të Rregullores për procedurat e punës financiare dhe të kontabilitetit të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, nr. 01-6222/1 të datës 12.12.2014, nëse poseduesi i lejes për emetim televiziv ose radio emetim nuk realizon pagesë të kompensimit, pas faturës së parashtruar në afatin e caktuar në paragrafin 3 të këtij neni të Rregullores, i njëjti ndërpritet dhe i jepet faturë e re që ka të bëjë vetëm për periudhën e punës, e cila faturë paguhet jo më vonë se tetë ditë nga dita e dërgimit të saj. Në të kundërtën, pagesa e borxhit do të realizohet përmes gjyqit.

Fatura nr. 2019-100-0017 (nr. ynë ark. 05-104/1) e datës 10.01.2019 për kompensim të lejes për emetim televiziv, ndërpritet dhe SHTR K TRI Televizioni SHPKNJ Kumanovë, i jepet faturë e re, që ka të bëjë vetëm për periudhën e punës, gjegjësisht deri në ditën e sjelljes së vendimit për marrje të lejes, dhe i cili duhet të paguhet jo më vonë se 8 (tetë) ditë nga dita e dhënies së saj.

Në pajtim me nenin 84 të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, Vendimi për marrje të lejes për emitim televiziv ose radio emitim është vendimtar, ndërsa kundër të njëjtës poseduesi i lejes ka të drejtë të parashtrrojë padi deri tek gjykata kompetente në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të tij. Procedura para gjykatës kompetente është urgjente.

Në bazë të asaj që është theksuar më lartë është sjellë Vendim si në dispozitivin.

Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale

Kryetari i Këshillit

Llazo PETRUSHEVSKI, s. r.

Udhëzim për mjet juridik: Vendimi për marrje të lejes për emitim televiziv të dhe SHTR K TRI Televizioni SHPKNJ Kumanovë është vendimtar. Kundër vendimit për marrje të lejes, SHTR K TRI Televizioni SHPKNJ Kumanovë ka të drejtë të parashtrrojë padi deri tek gjykata kompetente në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të tij.

Koha
E përditshme informative

ÇMIMORE PËR PREZANTIM TË PAGUAR POLITIK ZGJEDHJET PRESIDENCIALE 2019

Faqja e parë (color) 1 cm ²	3 €
Faqja e fundit (color) 1 cm ²	1,5 €
Faqja e brendshme (color) 1 cm ²	1,10 €
Faqja e brendshme (bardhë e zi) 1 cm ²	0,8 €
1/1 faqja e brendshme (bardhë e zi)	500 €
1/2 faqja e brendshme (bardhë e zi)	280 €
1/4 faqja e brendshme (bardhë e zi)	180 €
1/1 faqja e brendshme (color)	650 €
1/2 faqja e brendshme (color)	380 €
1/4 faqja e brendshme (color)	200 €
1/2 faqja e brendshme portret (bardhë e zi)	400 €
1/2 faqja e brendshme portret (color)	500 €

Shërbime speciale: - kërkesa e veçantë për pozicionim të reklamës e mrit çmimin për 25%.

Në çmim nuk është llogaritur TVSH-ja.

Dimensionet

1/1 250 x 385 mm

1/2 150 x 190 mm

1/4 122 x 190 mm

“Pavarësisht barazimit të fundit, ne në tabelë jemi në pozitë shumë të mirë dhe tani duhet të sigurohemi ta përforcojmë atë. Fokusi shkon drejt sfidës me Bellasicën, që nuk do të jetë aspak e lehtë”, ka deklaruar Murati

MURATI: DUHET TË PËRFORCOJMË VENDIN E PARË



duhet të shfrytëzohet për të materializuar punën tonë”, shprehet Mevlan Murati. Mbrojtësi kuqezi kërkon të kthehet vëmendja kah ndeshjet që pasojnë dhe tashmë përqendrimi i takon sfidës të së dielës me Bellasicën në Tetovë. “Pavarësisht barazimit të fundit, ne në tabelë jemi në pozitë shumë të mirë dhe tani duhet të sigurohemi ta përforcojmë atë. Fokusi shkon drejt sfidës me Bellasicën, që nuk do të jetë aspak e lehtë. Ne respektojmë çdo rival dhe pikët mund të fitohen vetëm nëse performojmë në maksimumin e mundësive tona. Kemi gjithë javën para nesh për të pritur sa më të gatshëm këtë ndeshje”, shtoi numri ‘16’. Pas ndeshjes me Makedonija Gj.P. të hënën skuadra punoi në rikuperim, ndërsa të martën futbollistët kishin ditë të lirë. Të mërkurën vazhdojnë përgatitjet për sfidën me Bellasicën, ndërsa në këtë drejtim stafi teknik ka paraparë nesër të zhvillohet ndeshje miqësore me Gostivarin.

se edhe me një pikë jemi në situatë shumë të mirë. Duhet të vazhdojmë të fitojmë në ndeshjet

e radhës, pasi kemi të gjitha mundësitë të bëjmë këtë. Tetë pikë avantazh në krye të tabelës



Veseli, lojtari më i dobët i Serisë A në këtë sezon

Nëse tifozët shqiptarë shohin me kënaqësi vlerësimet që po merr javë pas javë Berat Gjimshiti apo edhe konfirmimin e emrave si Thomas Strakosha e Etrit Berisha, situata e Frederik Veselit është paksa ndryshe. Ndonëse mbrojtësi i përfaqësueses shqiptare është aktualisht titullar te Empoli dhe po luan me rregullsi, paraqitjet e tij nuk kanë qenë edhe aq bindëse në Serinë A. Kjo ka bërë që edhe vlerësimet për të të jenë të ulëta dhe për momentin, rezultoni në bazë të notave të siguruar javë pas javë, si lojtari më i dobët i Serisë A. Portali TMW ka vendosur javë pas javë nota për paraqitjet e futbollistëve dhe çdo javë nxjerr një listë me mesataret e tyre për të bërë një renditje të më të mirëve dhe atyre që kanë zhgënjyer deri tani. Nëse në majën e listës së Serisë A, ashtu siç pritet, janë emrat e Ronaldo, Kualjarella, Piotek apo Zhervinjio, në fund, emri që bie në sy është ai i Frederik Veselit. Mbrojtësi kuqezi, në ndeshjet e zhvilluara deri tani në Serinë A ka regjistruar një mesatare note prej 5,47, më e ulëta në elitën e futbollit italian sipas kësaj renditje, notë të cilën e ndan me Pulgar të Bolonjës. Duke qenë në një skuadër e cila është e përfshirë plotësisht në luftën për mbijetesë, nuk pritet që situata e Veselit të ndryshojë shumë shpejt, thjesht që ai të mundohet të largohet sa më parë nga kjo pjesë e renditjes.

HENDBOLL

Maqedonia me trajner të ri?

Shkup, 27 shkurt - Përfaqësuesja e Maqedonisë së Veriut në hendboll, sot ose nesër do të shpalojë emrin e trajnerit të ri, pas largimit të Raul Gonzalesit. Sipas informatare jozyrtare, trajneri i ri do të jetë Danilo Brestovac, aktualisht trajneri i skuadrës së Metalurgut. Komisioni për zgjedhje të trajnerit të ri, sot do të shqyrtojë 6 kandidatura, në të cilat janë 3 trajner nga Maqedonia dhe të tjerat janë të huaj. Përpos Brestovacit, këtu janë Vladimir Gligorov dhe Goran Andonovski. Ndërkohë skuadra e Metalurgut, nuk dëshiron që të heq dorë nga trajneri



Brestovac, duke theksuar se një lëvizje e tillë mund të ndodhë vetëm pas 7 muajve. Nga ana tjetër, përfaqësuesja e Maqedonisë së Veriut, në muajin mars

duhet të nis përgatitjet për sfidat eliminatorie me Islandën. Presidenti i Federatës së Hendbollit, Zhivko Mukaetov insiston që trajneri të jetë nga Maqedonia.



Abdurrahimi, rikthim në fushë pas tre muajsh

Shkup, 27 shkurt - Besart Abdurrahimi është rikthyer të luajë për skuadrën e Hermanshtad në Rumani pas një mungese 3 mujore. Ish-futbollisti i Shkëndijës u aktivizua gjatë fillimit të pjesës së dytë në takimin e Kupës kundër Vitorulit. Me hyrjen e Abdurrahimit në fushë, Hermanshtad shënoi dy gola duke çuar ndeshjen në 2:2, por më pas Vitorul shënoi sërish dhe ndeshja u mbyll me fitoren 3:2 të skuadrës së drejtuar nga legjenda rumune Haxhi. Takimi i fundit i Abdurrahimit me ekipin rumun datonte më 25 nëntor të vitit të kaluar dhe që prej atij momenti, lojtari i përfaqësueses së Maqedonisë nuk kishte qenë më as i grumbulluar në stol.

FIFA lejon Useinin të luaj për Renovën



Shkup, 27 shkurt - Muhamed Useini vendosi në merkaton dimërore të largohej nga Flamurtari, për shkak të pakënaqësisë ndaj klubit vlonjat. Mesfushori u transferua në kampionatin Maqedonisë së Veriut, duke firmosur me skuadrën e Renovës. Mirëpo, drejtuesit e “kuqezinjve” pretendonin se lojtari nuk mund të largohej për arsye se ishte ende në kontratë me klubin e Flamurtarit, ndërsa vendosën që çështjen ta ndiqnin në instancat e FIFA-s. Ndërkohë në zyrat e klubit

të Renovës ka arritur dokumentacioni nga FIFA, e cila e lejon Useinin të aktivizohet rregullisht prej kësaj jave në kampionatin maqedonas. Drejtuesit e Renovës do të depozitojnë menjëherë në Federatë e Maqedonisë së Veriut, dokumentacionin në mënyrë që të mos ketë asnjë pengesë për 27-vjeçarin. Në këtë formë mesfushori ka arritur të fitojë çështjen ndaj ish klubit të Flamurtarit duke marrë lejkalimin, dhe si lojtar i lirë i është bashkuar me Renovën.

Në pajtim me nenin 107 paragrafi 13 nga Ligji për mjedisin jetësor (Gz. Zyrtare e RM nr. 53/05; 81/95; 24/07; 159/08; 83/09; 48/10; 124/10; 51/11; 123/12; 93/13; 42/14; 44/15; 129/15; 192/15; 39/16; 28/18; 65/18 dhe 99/18) dhe nenit 14 paragrafi 1 nga Rregullorja për procedurën e marrjes së A- Lejes së integruar ekologjike (Gz. Zyrtare e RM nr. 04/2006, 116/14 dhe 31/16), SHA për prodhim të energjisë elektrike TEC Negotinë, në pronësi të shtetit, Negotinë, e publikon këtë tekst:

Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor e Republikës së Maqedonisë

SHPLL

Projekt A - leje integruar ekologjike
për : SHA për prodhimin e energjisë,
TEC Negotinë në pronësi shtetërore Negotinë
fsh. Dubrovë - Negotinë
1440 Negotinë, Republika e Maqedonisë

Instalacioni SHA për prodhimin e energjisë, TEC Negotinë në pronësi shtetërore, Negotinë, fsh. Dubrovë – Negotinë, ka dorëzuar kërkesë deri te MMJPH për marrjen e A- Lejes për harmonizim me planin operativ. Pas zbatimit të procedurës ligjore MMJPH, ka lëshuar A- Leje për harmonizim me planin operativ nr. 11-9071/1 nga 03.10.2013.

Sipas njoftimit të pranuar për realizimin e tërësishëm të planit operativ (në pajtim me nenin 138 pika 6 dhe 7 të Ligjit për mjedisin jetësor (Gazeta zyrtare e RM 53/05, 81/05, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10, 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 187/13, 42/14, 44/15, 129/15, 192/15, 39/16, 28/18, 65/18 dhe 99/18) nga Inspektorati shtetëror i mjedisit jetësor nr.11-3221/2 nga 08.06.2018, MMJPH e zbaton procedurën e mëtutjeshme për marrjen e A-Lejes së integruar ekologjike.

Instalacioni sipas Rregullores për përcaktimin e aktiviteve të instalacioneve, bien nën aktivitetin nga Shtojca I, Pika 1:

1.1 Instalacione me djegie me hyrje nominale të nxehtësisë më të madh se 50 MW, Fuqia e instaluar: 210 MW

Drejtoria mjedisit jetësor pranë MMJPH përgatiti,
Projekt A - leje të integruar ekologjike për
SHA për prodhimin e energjisë,
TEC Negotinë në pronësi shtetërore, Negotinë

Projekt Leja do jetë e shpallur, në ueb faqen zyrtare të Ministrisë së mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor www.moep.gov.mk

Informacione në lidhje me Projekt Lejen, të interesuarit do të mundet të marrin në Ministrinë e Mjedisit jetësor dhe planifikimit Hapësinor (e-mail: g.filipovski@moep.gov.mk)

Të interesuarit, në **afat prej 14 ditëve** nga dita e shpalljes në mjetet e informimit, do të mundet t'i dërgojnë vërejtjet e tyre në lidhje me Projekt Lejen, në formë të shkruar, deri te Ministria e Mjedisit jetësor dhe planifikimit Hapësinor në këtë adresë: Sheshi Presveta Bogorodica nr.3, 1000 Shkup.

Në bazë të nenit 19 të Rregullores për mënyrën e realizimit të ekskursioneve shkollore dhe aktivitete tjera të lira, komisioni për zbatim të procedurës për realizim të ekskursioneve të nxënësve dhe aktiviteteve tjera të lira nga SHMEJQSH "Vasil Antevski - Dren" - Shkup e publikon këtë:

SHPLLJE PUBLIKE

për grumbullim të ofertave për realizim të ekskursioneve të nxënësve dhe aktiviteteve tjera të lira për nxënësit e SHMEJQSH "Vasil Antevski-Dren" - Shkup për vitin shkollor 2018/2019

Kërkues: SHMEJQSH "Vasil Antevski-Dren" - Shkup

Ofertues: Çdo subjekt juridik dhe fizik i regjistruar për kryerjen e veprimtarisë sipas lëndës së shpalljes.

Lënda: Organizim të ekskursioneve dhe aktiviteteve tjera të lira për nxënësit në pajtim me programin e shkollës në pajtim me Programet për ekskursione të nxënësve të shkollës për vitin shkollor 2018/2019, për nxënësit e vitit të parë, dytë, tretë dhe të katërt:

- Ekskursion përfundimtar për nxënësit e vitit të tretë në relacionin Shkup-Pragë-Dresden-Vjenë-Shkup, 6 ditë 3 fjetje në Pragë me hotel me minimum 4*, në bazë të gjysmë pansionit.
- Ekskursion profesional-hulumtues për nxënësit e vitit të dytë në Maqedoninë Perëndimore, 2 ditë 1 fjetje në Ohër në hotel me minimum 4*, në bazë të gjysmë pansionit.
- Ekskursion profesional-hulumtues për nxënësit e vitit të parë në Maqedoninë Perëndimore, 2 ditë 1 fjetje në Ohër në hotel me minimum 4*, në bazë të gjysmë pansionit.
- Ekskursion profesional-hulumtues për nxënësit nga viti i parë deri në vitin e katërt në relacionin Shkup - Strumicë - Koleshinë - Ujëvarat e Smollarit - Shkup, 1 ditë.

Ofertuesit e interesuar për pjesëmarrje në procedurën me kërkesë për grumbullim të ofertave, informacione më të hollësishme për lëndën e kërkesës, kriteret minimale, kërkesat dhe mënyra e dorëzimit të ofertave, mund të marrin në dokumentacionin shtesë i cili mund të tërhiqet çdo ditë pune nga ora 10:00 deri 13:00 në arkivin e SHMEJQSH "Vasil Antevski-Dren" rr. Vera Jociq pn, Shkup.

Sipas nenit 21 të Rregullores për mënyrën e realizimit të ekskursioneve shkollore nga shkollat e mesme, subjektet juridike duhet t'i plotësojnë kushtet minimale të shpjeguara në të njëjtin nen. Oferta e ofertuesit e cila nuk i plotëson kushtet minimale do të refuzohet nga ana e komisionit si e papranueshme. Kriter për dhënie të marrëveshjes për realizim të ekskursioneve të nxënësve dhe aktiviteteve tjera të lira është: çmimi më i ultë.

Ekskursionet do të realizohen vetëm nëse ka numër të mjaftueshëm të nxënësve të paraqitur.

Ofertat e pakompletuara nuk do të shqyrtohen. Hapja e ofertave bëhet pa prezencën e ofertuesve.

Ofertat me dokumentet e duhura të parashtrihen deri te Komisioni për realizim të procedurës për ekskursione të nxënësve, në arkivin e shkollës ose përmes postës në adresën SHMEJQSH "Vasil Antevski-Dren", rr.Vera Jociq pn, Shkup. Shpallja zgjat 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit të tij. Ofertat është e nevojshme që të arrijnë në arkivin e shkollës në afatin e dhënë. Çdo ofertë e arritur pas afatit përfundimtar gjegjësisht pas skadimit të pesë ditëve të punës do të llogaritet si e vonuar dhe nuk do të jetë lëndë e shqyrtimit.

Komisioni për zbatim të procedurës për realizim të ekskursioneve të nxënësve dhe aktiviteteve tjera të lira

HP Inc.
1501 Page Mill Road
Palo Alto, CA 94304
SAD
hp.com

Njoftim sigurie me rëndësi

Programi i kthimit dhe ndërrimit të baterive të laptop-kompjuterëve HP për shkaqe sigurie

Të nderuar klientë që blini produktet HP,

Më datë 17.01.2019, kompania HP ka publikuar zgjerimin e programit të saj momental global për kthimin dhe ndërrimin e baterive të caktuara për laptop-kompjuterët HP dhe stacionet operative mobile. Bateritë me mundësi për të pasur defekt janë lëshuar në përdorim bashkë me një pjesë të HP ProBook (seritë 4xx G4, 64x G2, 65x G2), HP x360, laptop-kompjuterët HP 11 dhe stacionet operative mobile HP ZBook Studio G3 dhe janë shitur në mbarë botën gjatë periudhës maj 2016 - prill 2018. Bateritë objekt i këtij programi gjithashtu janë shitur si pjesë këmbimi ose pjesë ndërrimi nga ana e HP ose servisesit të autorizuar të HP.

Bateritë objekt i këtij programi mund të ngrohen shumë, duke qenë rrezik për shkaktim zjarri dhe për djegien e përdoruesit. Për këtë arsye, me rëndësi të madhe është të kontrolloni nëse bateria juaj ka defektin në fjalë.

Vizitoni ueb faqen HP Battery Recall në adresë në vazhdim <http://www.hp.com/go/batteryprogram2018>, në të cilën mund të kontrolloni baterinë tuaj. HP do të sigurojë shërbimin e nevojshëm për ndërrimin e baterive, për të gjitha bateritë që do të verifikohen me këtë thirrje si bateri me defekt, pa asnjë lloj pagese.

Kujdes: Procesi i konfirmimit mund të vërtetojë nëse bateria është me defekt. Më pak se 3% të produkteve me mundësi për të pasur defekt gjatë periudhës përkatëse kanë bateri që janë paraparë me këtë tërheqje produkteve për shkaqe sigurie.

Kërkojmë ndjesë për të gjitha problemet që i keni pasur dhe që janë shkaktuar me këtë defekt.

Me respekt,
HP.

NJOFTIM

Njoftohen qytetarët dhe subjektet juridike që hapësira e përfshirë me Propozim PDU për pjesë të Nj.U "Pero Çiço" pjesë nga Blloku urban 16, përfshirje planore mes rr. "Veselin Maslesha", rr. "Mihajlo Pupin", rr."Gjorçe Petrov", PK 12928, PK 12927, rr. "Budimir Dimkovski" dhe rrugës së këmbësorëve - Komuna e Kumanovës, që Kryetari i komunës së Kumanovës sollë Vendim për organizim të:

ANKETË PUBLIKE E SËRISHME

Njoftohen qytetarët dhe subjektet juridike të Komunës së Kumanovës që në periudhën prej 28.02.2019 deri më 15.03.2019 organizohet anketë publike e serishme për hapësirën e përfshirë me PDU për pjesë të Nj.U "Pero Çiço" pjesë nga Blloku urban 16, përfshirje planore mes rr. "Veselin Maslesha", rr. "Mihajlo Pupin", rr."Gjorçe Petrov", PK 12928, PK 12927, rr. "Budimir Dimkovski" dhe rrugës së këmbësorëve - Komuna e Kumanovës.

Shtojcat grafike dhe tekstuale nga Propozim plani i PDU do të prezantohen në Sirtarët komunal në Sheshin e qytetit, që gjenden tek ish "Tutun" – Kumanovë.

1. Anketa publike organizohet në propozim PDU për pjesë të Nj.U "Pero Çiço" pjesë nga Blloku urban 16, përfshirje planore mes rr. "Veselin Maslesha", rr. "Mihajlo Pupin", rr."Gjorçe Petrov", PK 12928, PK 12927, rr. "Budimir Dimkovski" dhe rrugës së këmbësorëve.

Për kohëzgjatjen e anketës së serishme publike, subjektet fizike dhe juridike të interesuar informacione më të hollësishme mund të marrin në Komunën e Kumanovës, Sektori për urbanizëm dhe veprimtari komunale dhe mbrojtje të mjedisit jetësor dhe natyrës.

Gjatë anketës së serishme publike propozime dhe vërejtje mund të parashtrijnë të gjithë subjektet fizike dhe juridike të interesuar në fletat anketuese. Fletat anketuese mund të merren dhe të dorëzohen në Arkivin e Njësisë së vetëqeverisjes lokale të Komunës së Kumanovës.

PREZANTIM PUBLIK

Më datë 06.03.2019 në ora 12⁰⁰, në sallën për takime në Komunën e Kumanovës organizohet Prezantim publik të PDU për pjesë të Nj.U "Pero Çiço" pjesë nga Blloku urban 16, përfshirje planore mes rr. "Veselin Maslesha", rr. "Mihajlo Pupin", rr."Gjorçe Petrov", PK 12928, PK 12927, rr. "Budimir Dimkovski" dhe rrugës së këmbësorëve - Komuna e Kumanovës, KK Kumanovë.

Komuna e Kumanovës
Kryetari i Komunës
Maksim Dimitrievski

Koha
<http://www.koha.mk>

www.koha.mk
koha@koha.com.mk
marketing@koha.com.mk
Tel: 02 3179 - 904; Fax: 02 3118 - 060;
Adresa e kontaktit dhe reklamimit: Bld. Goca Delçev nr.11, I.Q.T. Marovcizaqja ka.14 - prillorci, Shkup

Shesim tokë ndërtimi - 9000m2
Në Komunën kadastrale Zllokuqani, në afërsi të vendit të paraparë për ndërtimin e Qendrës së re klinike, shesim tokë ndërtimi me sipërfaqe prej 9.000 m2.
Tel. 071/372-215 & 078/243-583

Janë gjashtë trajnerë për të cilët e ardhmja mbetet ende mister edhe pse jemi në fund të muajit shkurt. Emra të mëdhenj të futbollit botërorë që kanë fituar trofe me skuadrat e tyre, por që pritet të ndryshojnë skuadër ose edhe të fitojnë një punë të re, pasi aktualisht janë pa një të tillë.

Allegri - Trajneri aktual i Joves pritet të largohet nga Torino në fund të këtij sezoni. Edhe pse titullin e ka të sigurt, eliminimi në Kupë dhe disavantazhi prej dy golave në Champions ndaj Atelticos kanë lënë shije të keqe tek drejtuesit e klubit bardhezi. Real Madrid është duke monitoruar situatën e tij, ndërsa edhe Chelsea mund të jetë në kërkim të një trajneri këtë verë.

Conte - Duket se Antonio Conte ka pushuar mjaftueshëm dhe këtë verë pritet të rikthehet në drejtim të ndonjë klubi. Edhe pse kontesti i tij me skuadrën e Chelsea ende nuk është zgjidhur dhe do të përfundojë në gjykatë, italianin preferon që të gjejë një skuadër. Inter është destinacioni i tij më i mundshëm me Marottan

GJASHTË TRAJNERË ME TË ARDHME TË PAQARTË



që është zgjedhur drejtor sportiv e të dy e njohin shumë mirë njëri-tjetrin.

Mourinho - Ka dy vite që Mourinho nuk ka fituar asnjë trofe dhe për një trajner të kalbrit siç është portugezi kjo është një kohë e gjatë. Së fundmi ai është angazhuar si komentator sportiv në disa televizione, por e ka pranuar

se po i mungon fusha dhe është në kërkim të një skuadre. Mediat e kanë lidhur me Real Madrid, por edhe me PSG, në rast se francezët nuk arrijnë ndonjë sukses në Europë këtë sezon.

Sarri - Pak kush e beson se Sarri do të jetë tek Chelsea pas këtij sezoni. Ai është vënë në qendër të kritikave pas humbjeve radhazi.

Edhe lojtarët duket se nuk po i bindën më trajnerit italian. Ekipi i Romës është shumë i interesuar të risjellë Sarrin në Itali dhe kanë një projekt që mund të bindë trajnerin aktual të bluve të Londrës.

Spalletti - Drejtuesit kinezë i dhanë mbështetje në periudhën më të errët në të cilën kaloi skuadra, por Spalletti duket se nuk do të vazhdojë me Interin. Klubi dhe tifozët kërkojnë një trofe dhe Europa League është e vetmja mundësi. Po ashtu, minimumi që kërkohet nga Spalletti është një vend që dërgon në Champions sezonin e ardhshëm.

Zidane - Që prej largimit nga Real Madrid, Zidane ka pasur shumë oferta. Mirëpo, francezi vendosi që të kalonte disa muaj relaksi para se të niste një projekt të ri. Juventus mund të jetë ekipi i tij i ri, por nuk mungojnë as ofertat nga Anglia. Chelsea është e interesuar të sjellë francezin dhe të rikthejë lavdinë, por mund të ketë konkurrencë nga Manchester United. Gjithsesi, pas rezultateve pozitive, "djajtë" mund t'i japin kontratë legjendës së tyre, Solskjaer.




Napoli kërkon Icardin

Napoli e kanë bërë një ofertë mjaft mbresëlënëse për Mauro Icardin, për ta bindur argentinasi të transferohet te ta nga Interi. E ardhmja e 26-vjeçarit me Interin është vënë në dyshim gjatë kohës së fundit, pas dështimit të negociatave për rinovimin e kontratës, si dhe vendimit të klubit për t'ia marrë shiritin e kapitenit. Sipas Tuttomercato, Napoli ia ka ofruar një kontratë mjaft tunduese Icardit. Sipas kësaj kontratë, Icardi do t'i fitonte nëntë milionë euro me klubin e ri, si dhe dy milionë euro të tjera mund t'i fitojë përmes bonuseve. Nëse Icardi e pranon këtë ofertë, dhe i refuzon ofertat e klubeve të tjera të mëdha të interesuara për të, atëherë ai do të bëhej lojtari i dytë me pagën më të lartë në Serie A, pas Cristiano Ronaldos. Megjithatë, BeIN Sports raporton se zikaltrit dëshirojnë ta shesin ish-kapitenin e tyre në Juventus. "Zonja e Vjetër" e kishte shprehur interesimin për argentinasiin edhe më herët, pasi i kishte bërë ofertë gjatë verës së kaluar, para se ta blinin Ronaldon. Kontrata e Icardit me Interin është e vlefshme deri në vitin 2021, mirëpo në këtë kontratë gjendet një klauzolë për shkëputjen e kontratës, sipas së cilës klubet jashtë Italisë mund ta blejnë Icardin për 110 milionë euro, nga 1 deri më 15 korrik.

Bayerni siguron Lucas Hernandezin

Bajerni i Mynihut po përgatitet për një revolucion në merkaton e verës, ku disa "yje" kanë përgatitur valixhet si Arjen Robben, por ndoshta edhe Lewandowski, ndërsa pritet të afrohen futbollistë të tjerë të motivuar për të fituar trofe të rëndësishëm. Në këtë mënyrë, pasi siguroi shërbimet e Benjamin Pavard klubi bavarez duket se ka mbyllur një tjetër marrëveshje. Lucas Hernandez nga Korriku do të jetë një futbollist i "Die Roten", të paktën këtë raporton e përditshmja e njohur



gjermane "Bild". Francezi aktualisht është pjesë e Atleticos së Madridit, klub ku u formua profesionalisht. Kampionët e Gjermanisë

provuan ta afronin futbollistin që në merkaton dimërore, por klauzola e kontratës së tij prej 80 milionë eurosh u konsiderua e ek-

zagjeruar nga drejtuesit gjermanë, në një kohë që edhe 23-vjeçari dëshironte ta mbyllte këtë edicion tek "rojiblançot". Gjithnjë sipas "Bild", në merkaton e verës operacioni do të mbyllet dhe Hernandez do të veshë fanellën e klubit më të titulluar në Gjermani. Ndërkohë që Bayerni kërkon të konkretizojë edhe afrime të tjera, ku në listë janë Timo Werner i Leipzigut, talenti 19-vjeçar i Leverkusen Kai Havertz dhe 18-vjeçari i Chelsea-t Callum Hudson-Obi.

Pas Chelseat, edhe City nën hetime

Federata e Futbollit të Anglisë është duke e hetuar Manchester Cityn për shkak të pretendimeve se klubi anglez ia kishte paguar agentit të Jadon Sanchos 230 mijë euro, kur futbollisti ishte vetëm 14-vjeçar. Këto pretendime u bënë në disa dokumente të publikuara nga gazeta gjermane Der Spiegel, "Football Leaks". Për ta blerë Sanchon nga Watfordi, në mars të vitit 2015, ata ia kishin pa-

guar 230 mijë euro agentit të Sanchos, i cili tani luan për Dortmundin. Futbollistët e rinj nuk mund të përfaqësohen nga një agent deri në moshën 16-vjeçare. Për më tepër, rregullat e Federatës së Futbollit të Anglisë theksojnë se klubet nuk mund të bëjnë oferta financiare për lojtarë nën moshën 16-vjeçare. Sancho, që tani është 18-vjeçar, iu bashkua Chelsea si 14-vjeçar, kur kampioni në

fuqi i Premierligës i pagoi 77 mijë euro si dëmshpërblim për Watfordit. Manchester City ishte njëra ndër klubet me më së shumti akuza nga "Football Leaks", mirëpo klubi anglez i ka mohuar këto akuza qysh në fillim e tani ka reaguar edhe ndaj hetimeve të Federatës së Anglisë. "Tentimet për ta shkatërruar reputacionin e klubit janë të organizuara dhe të qarta. Ne nuk do të ofrojmë asnjë ko-



ment tjetër për këto materiale që janë nxjerrë nga konteksti", shk-

ruhet në reagimin e publikuar nga Manchester City.



DASHI 21. mars - 20. prill

Qetësia do mbizotërojë gjate gjithë kësaj dite për ju qe jeni ne një lidhje. Me partnerin do dini te komunikoni dhe nuk do kërkoni gjera te tepruara. Beqaret do fiksohen keq pas dikujt dhe nuk do rreshtin se e joshuri me çdo lloj mënyrë. Me mire le te bëjnë pak durim sepse ai do shkoje tek ta ne një moment tjetër. Me financat duhet te bëni pak me shume ekonomi



DEMI 21. prill - 21. maj

Dite e shkëlqyer ka për te qene kjo për te gjithë ata qe janë ne një lidhje. Debatet do shterojnë dhe reflektimi i gjate do ju beje te kërkoni falje te dy palët. Beqaret nuk do kenë nevojte ta kërkojnë shpirtin binjak sepse ai do ju shfaqet vete ne mënyrë te papritur. Ne planin financiar tregohuni pak te kursyer me shpenzimet ne mënyrë qe as me vone te mos ju lindin probleme.



BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Do ndodhin gjera te jashtëzakonshme sot ne jetën tuaj ne çift te cilat do ua shtojnë dëshirën për te hedhur hapa me tej. Për beqaret gjithashtu do jene te favorizuara takimet. Dilni me sa me shume persona dhe me vone bëni përzgjedhje. Ne planin financiar gjendja do përmirësohet me shume se asnjëherë me pare. E gjithë kjo fale perkujdesit te treguar se fundmi.



GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Gjate kësaj dite do jetoni ne një ambient shume te qete dhe euforik, Partneri do mundohet t'ua plotësojë dëshirat dhe do ju beje te ndiheni përherë te dashuruar. Beqaret do kenë aq shume njohje gjate kësaj dite saqë do e kenë vete ne dore zgjedhjen qe do bëjnë. Ne planin financiar keni për te kryer investime sepse situata ne te cilën ndodheni ua lejon një gjë te tille.



LUANI 23. korrik - 22. gusht

Gjate kësaj dite do keni mbështetjen e planetëve dhe do ndiheni me te gëzuar nga me pare. Nuk do ju mungoje as frymëzimi për te bere surpriza here pas here. Beqaret nuk do kenë me dyshime pe rate qe duan te bëjnë dhe do tentojnë me shume se asnjëherë. Gjendja financiare ka për te qene e mire dhe nuk do gjendeni ne situata te vështira. Mund t'iu shlyhen edhe disa borxhe.



VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Ju qe jeni ne një lidhje do jeni shume kërkues ndaj atij qe keni ne krah dhe ndonjëherë mund te bëheni edhe posesive. Kujdes sepse edhe durimi i tij e ka një kufi dhe mund ta humbni përgjithmonë nëse e teproni. Financat do jene shume te paqëndrueshme. Kujdes me çdo shpenzim sepse po filluan problemet zor se mund te përmirësohen me.



PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Sot do bëni te pamundurën ju dhe partneri për t'i zgjidhur njëherë e mire disa probleme qe ju kishin dale ne çift. Mbrëmja ka për te qene shume me e qete. Beqaret duhet te tregohen gjithmonë dyshues ne fillim ne mënyrë qe te mos lëndohen. Plutoni do ju ndihmoje me financat dhe gjendja do vije duke u përmirësuar shume shpejt.



AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Sot duhet te mbyllni një sy e një vesh ju te dashuruarit ne mënyrë qe te kaloni një dite te qete me partnerin. Po u fiksuat edhe pas detajeve me te vogla mund te keni debate te vazhdueshme. Beqaret nuk do kenë aspak dëshirë te sakrifikojnë lirinë e tyre për te filluar një lidhje. Financat do dini si t'i menaxhoni gjithë kohës dhe gjendja ka për te mbetur goxha e mire.



SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Dite jo e mire do jete kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Debatet do jene te forta dhe mund te ketë edhe ndonjë ndarje te përkohshme. Beqaret do kërkojnë gjera te pamundra dhe asnjë prej dëshirave nuk do mund t'iu realizohet. Ne planin financiar do vazhdoje te mbizotërojë ekuilibri gjate gjithë kohës. Do jeni te vetëdijshëm qe duhet pasur tejet kujdes me shpenzimet.



BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Sot do gjeni mënyra shume origjinale për t'i shprehur ndjenjat ju te dashuruarit dhe marrëdhënia me partnerin do ngrohet me tepër. Beqaret gjithashtu do marrin deklarata te forta dashurie dhe do fillojnë lidhje te qëndrueshme. Ja ka vlejtur durimi deri me sot. Ne planin financiar do ndihmoheni mjaft nga familjaret dhe do e kaloni pa probleme ditën.



UJORI 21. janar - 19. shkurt

Dite me shume fat do jete kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Nuk do keni as debate me te vogël me partnerin dhe gjithë kohës do jeni te qete. Beqaret nuk do mundin dot t'i shpëtojnë dashurisë edhe sikur te mos duan. Për ta kane për te ndryshuar shume gjera. Për financat do jete një dite e qete dhe pa probleme serioze.



PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Do jeni shume kapricoze ju te dashuruarit dhe nuk do kënaqeni lehtësisht gjate kësaj dite. partnerit tuaj do i duhet durim qe gjerat te ecin mire. Beqaret do kenë një dite shume normale dhe pa ndonjë takim te veçantë. D ju duhet ende te presin pak kohe. Ne planin financiar nuk do përballeni me surpriza te këqija, pasi keni ditur t'i bëni mire llogarite kohet e fundit.



KOHA	AKTORI EGJIPTIANO-AMERIKAN NE FOTO	KROKODILI AMERIKAN, KAJMANI	BUKË E VOGËL, KULAÇ I PJEKUR NE FURRË	BANORI I SAIRESET (FRANCE)	ENERGJIA SHPËRBLIMI, TE CILIN E FITOI AKTORI NE FOTO	NEAR-DEATH EXPERIENCE IMPULSI	RUMANIA NE RREGULL	DREJTIM NE MUZIKË REVISTË KOMIKE SPANJOLLE	SHOKU, JARANI TAUTOLOGJIA	REOMIRI PJESE E FLETORES	AKTORJA FRENGE, MARSO ISMAIL XHEMALI	LUKSEMBURGU 51 ROMAK	TRA MBAJTËS I TAVANIT
FILMI I NOMINUAR PER SHPËRBLIMIN OSKAR 2019, "...BOHEMIAN"													
PSEUDONIMI													
QË I PËRKET MITIT													
QË MBËSHETETET A BAZOHET NE FIGURA													
F													
DITA E GJYKIMIT													
ASTATI			SULFURI RRJETË PESHKIMI ME BISHT		ITRIUMI SHEGË								
QYTETI I LINDJES SE AKT. NE FOTO													
VENDI I PJERRËT, I MBULLUAR ME GURË TE RENE NGAMALI													
L													
BIMË BARISHTORE NËVJECARE, ME DY-TRI KOKRRA BRENDA												AGIM POSHKA	

ZGJIDHET: HARE, BINAR, ETJE, ANAND, ANAI, TARM, E, NDE, RAPSODIA, R, ALIASI, ROK, MITIK, MIKU, FIGURATIV, R, MASHER, SOFI, AT, S, IT, L, LOS ANXHELES, LERANA, RITA, KIKIRIK, AP

Shumë i lehtë **Sudokun** **mesatar**

2						4			2	3	1			8	
				5	3		1			7		8		6	
				3	8	9			4			5			1
		3		1			5			4					8
5	7								8	3				4	9
			9		7				9					7	
6		9							7			4			6
			5			2	7			9		7		2	
			8		9		3			6		5	1		7

Shumë i lehtë: 321798645, 968425371, 754163892, 893214756, 572386419, 146957238, 639572184, 485631927, 217849563. Mesatar: 625319487, 197284635, 483765921, 274196358, 836527149, 951843762, 718432596, 549678213, 362951874.

HEDH MONEDHA NË MOTORIN E AVIONIT, I KUSHTOI 21 MIJË DOLLARË

Një kompani ajrore kineze ka paditur një pasagjeri, i cili shkaktoi më shumë se 21 mijë dollarë dëme, pasi hodhi monedha në motorin e një avioni për "fat të mirë". Stafi i linjës ajrore, i quajtur ironikisht "Lucky Air", mori në pyetje pasagjerët pasi gjetën dy monedha 1-juanë në asfalt pranë motorit të majtë të avionit para se të niseshin në fluturim më 17 shkurt. Një pasagjer 28 vjeçar, i identifikuar vetëm si 'Lu', pranoi hedhjen e monedhave në motor për "fat të mirë" dhe është paditur për anulimin e fluturimit. Të paktën 162 pasagjerë në bord do udhëtonin nga Anqing, në provincën Anhui të Kinës Lindore, në Kunming në provincën e Yunnanit. Linja ajrore tha se kontrolli i plotë i motorit dhe kalimi i pasagjerëve në një aeroplan tjetër një ditë



më pasi kushtoi kompanisë 21 mijë dollarë. Lu u arrestua nga policia e aeroportit dhe u ndalua për shtatë ditë. Lucky

Air pësoi një incident të ngjashëm në 2017, kur një pasagjer i moshuar hodhi dy monedha drejt një avioni.



Ndotja e ambientit, Vanuatu ndalon përdorimin e pelenave

Vanuatun, një shtet të vogël në Paqësor pakkush e njihet. Emrin e tij e kemi dëgjuar për shkak të njohjes, e më pas tërheqjes së njohjes, së Kosovës si shtet të pavarur, por sot vendi është shfaqur në lajme, pasi ka vendosur të ndalojë përdorimin e pelenave, me qëllim që të reduktojë ndotjen. Zyrtarët njoftuan masën këtë javë, duke thënë gjithashtu se pjatat, gotat, paketimet apo produktet e tjera plastike njëpërdorimshe do të nxirreshin jashtë ligjit. "Mendoj se është mirë për ambientin, por besoj se është pak e vështirë të kthehemi te mënyrat e vjetra", tha një grua. Vanuatu është në fakt një nga disa vende të Paqësorit që janë prekur shumë nga ndryshimet klimatike, e krenohet me faktin që po tregon leadership në planin ambiental. Vitin e shkuar, ai u bë një nga të parat vende të botës që ndaloi qeset plastike njëpërdorimshe. Ndalimi i pelenave, që duhet të marrë edhe një miratim përfundimtar, pritet të hyjë në fuqi më 1 dhjetor të këtij viti. Pelenat përbëjnë një ndotës kryesor ambiental, pasi bëhen me plastikë jo të biodegradueshme dhe kanë edhe sodium poliakrilik, një kimikat ky, si përbërës.

Pasagjeri harron në tren një vazo të... Pikasos!

Policia gjermane po përpaket të ndihmojë një burrë, i cili harroi në tren një vazo të pikturuar nga Pablo Pikaso. "Ne jemi 100% të sigurt se kjo është një vazo e punuar nga Pikaso", theksuan në një raport autoritetet. I moshuari 76-vjeçar udhëtonte me tren nga Kaseli në Dyseldorf dhe harroi çantën që mbante vazon, kur ai ndryshoi tren për në qytetin Ham. Vazoja e qeramikes është e lartë 26 centimetra dhe daton që nga viti 1953 dhe përmban një imazh të serisë Pikaso "Owl". Pronari thotë se vlen të paktën 10 000 euro (11 370 dollarë). Raporti nuk theksoi pse i moshua-



ri po udhëtonte me vazon ose si e kishte zotëruar atë.

Porsche Macan SUV do të jetë krejtësisht elektrik

Porsche ka zbuluar se pasardhësi i Macanit SUV të tanishëm do të jetë krejtësisht elektrik. Gjëja më interesante është ajo se modeli i ri i Macan SUV nuk do të ofrohet as si hibrid e as si plug-in e as në ndonjë version tjetër, do të jetë ekskluzivisht elektrik. Detajet e Macanit të ri ende nuk janë zbuluar, por Porsche ka konfirmuar se ai do të vijë në platformën Premium Electric, e cila

është zhvilluar në bashkëpunim me Audin. SUV Macan i ri do të prodhohet në fabrikën e Porsches në Leipzig, ku prodhohen edhe modelet e tanishme Macan, Cayenne e Panamera.

Nuk është zbuluar ndonjë datë specifike e lansimit të Porsche Macanit të ri, por prodhimi i tij pritet të fillojë në fillim të dekadës së ardhshme.



1066 - Hapet Westminster Abbey
1730 - Carina Anna Ivanovna udhëheqë autokracinë.

1922 - Egjipti rifiton pavarësinë nga Britania, por trupat britanik mbesin.

1924 - SHBA nisin intervenimet në Honduras.

1933 - Hitleri ndalon Partinë Komuniste të Gjermanisë (KPD).

1939 - Britania e Madhe njeht regjimin e Frankos në Spanjë.

1941 - Luftë ajrore mes Britanisë dhe Italisë mbi Shqipëri.

1961 - JFK emëron Henry Kissinger për këshilltar special.

1974 - SHBA dhe Egjipti rivendosin marrëdhëniet diplomatike pas 7 viteve.

1976 - Spanja tërhiqet nga Sahara Perëndimore.

PËRSE GËRHASIN MACET?



Kur macja shtrihet pranë jush apo kur jeni duke e përkëdhelur ajo i shpreh ndjenjat e saj duke gërritur. Megjithatë, gërritja nuk është gjithmonë një shenjë lumturie. Ndonjëherë ajo është një përgjigje emocionale që tregon dhimbje apo stres. Në fakt macet mund të gërhasin teksa janë duke lindur, prandaj gërritja ka më shumë të ngjarë të jetë një lloj mekanizmi që i ndihmon macet të qetësohen. Gërritja mund të jetë gjithashtu një sjellje vetë-ngushëlluese. Fillimisht ajo shprehet kur kotelet janë vetëm disa ditëshe, ndoshta për t'i sinjalizuar prezencën e tyre mamasë e për ta inkurajuar atë që t'i ushqejë. Kjo mënyrë komunikimi vazhdon më tej me rritjen e tyre.

DASHNORJA DHE MAMI

Goca: O mami pse qielli është blu?!

Mami: Hiç.

Goca: O mami pse breshka nuk vrapon?!

Mami: Hiç.

Goca: O mami pse babi ka dashnore?!

Mami: Çaaa thuuu moj..?!

Goca: Hiç.



Arma më e fuqishme në tokë është shpirti i njeriut që digjet.

(Ferdinand Foch)

KALENDARI 28 SHKURT



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS